

PARKALESITË

TË TË

KRËSHTERËVET

TË

VËRTETË

---

Hora e t'Arbëreshëvet  
1975

PARKALESIA E MENATËS

NË embër të Jatit të Birit e të Shpirtit Shejt. Amin.

Shejt Perëndi, Shejt i fukjishëm, Shejt i pavdekshëm, kij lipisi për ne. (3 herë)

Lëvdi past Ati, Biri edhe Shpirti Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

Trini gjithë e shejte, kij lipisi për ne; ndëjena, o Zot, mëkatët t'ona; mos kujtò, o i Madh' in' Zot, ftesat t'ona; vërrej, o i Shejt, e kij kujdes për sëmundat t'ona e paj embrit t'ënt jipna shëndet.

Lipisi, lipisi, lipisi, o i Madh' in' Zot.

Lëvdi... nani...

Ati i jinë që je në kjiell, shejtëruar kloft embri i jit, arthët Rregjëria jote, u bëft vullimi i jit, si ndë kjiell ashtu ndë dhe. Bukën t'ënë të përditçemen ëna

neve sot;ndëjena dëtirët t'ona,si  
na ja ndëjejem të dëtëruamëvet  
t'anë,e mos na le të biem ndë nga-  
rie,po lirona nga i ligu.

Se jotia isht rregjëria e fukjia  
e lëvdia:e Atit,e Birit,e Shpirtit  
Shejt,nani e për gjithëmonë e për  
jetë të jetëvet. Amin.

I larti Perëndi,Ti çë na grëjte  
nga gjumi,na të biem përmist e du-  
am të të lutemi e të të thërresiëm  
me lëvdin e Ëngjëjëvet:i shejt,i  
shejt,i shejt je,o Perëndi,paj të  
Zonjës Mëmë e shën Mëri,paçe lipi-  
si për ne.

Lëvdi...

Tue më sgjuar nga gjumi e ngrëjtur  
nga shtrati,ndritëmë,o i Madh'in'  
Zot,mendien,sbillëm zëmbren e buzët  
sa të të lëvdonjë,o Trini e Shejte:  
i shejt,i shejt,i shejt je Ti,o  
Perëndi,Paj të Mëmës t't'in'Zoti  
kijna lipisi për ne.

Nani...

Gjikëtari ka t'vinjë njësiherie e  
veprat e nganjeriu kanë të jenë  
sbëluarë.Me dre në mes të natës po  
thërresiëm:i shejt,i shejt,i shejt  
je Ti,o Perëndi,për parkalesitë e

Mëmës të t'in'Zoti, kij lipisi  
për ne. Lipisi, i Madh'in'Zot. (12)

I sgjuar nga gjumi të haristis,  
o Shejtia Trini, pse paj të madh-  
es mirësi t'ënde e dërim, ngë u  
zëmërove me mua përtats e i mëka-  
truam ngë më dënove për paligjë-  
sit t'ime, po ke pasur lipisi për  
mua e mua i kjëlluam gjumi çë ngë  
ndienj më gjë, më sgjove e më grë-  
jte sa t'i jipia lëvdi Pushteties  
t'ëne. E nani ndritëmë sit e me-  
ndien, sbillëm gojën, lemë të men-  
donjë fialët t'pte e të ndëlgonj  
urdhurimet t'atë e të bënëj vull-  
imin t'ënt e të msal Tij me të u  
shmalur zëmbrie e të lëvdonj të  
gjithë shejtin embër t'ënt: të  
Atit, të Birit e të Shpirtit Shejt  
nani e për gjithëmonë e për jetë  
të jetëvet. amin.

Lëvdi Tij, Rrekj, Perëndi i gjith-  
mëndëm, se te kujdesi i jit i hji-  
nushëm dhe njeridashës më bëre të  
mirë mua shërbëtuar jiti i pavëje  
fshim e i mëkatruam, të më sgjoje  
nga gjumi e të hija te shpia jote  
e shejte.

Përit mirë, o i Madh'in'zot, edhe  
 zërin e parkalesis t'ime si atë të  
 Shejtravet Fukji të mendçeme, të  
 pëlqjeft se u t-t'fal me zëmërë  
 të pastrë e me shpirt përunjësie  
 lutien t'ime megjithëse bërë me  
 buzë të fëllikjura; sa edhe u të  
 marrë pjesë te numeri i Virgjëre...  
 shavet të urta me të shkëlqierit  
 gazmor të shpirtit t'imë e të lë-  
 vdonj te Ati e Te Shpirti Shejt  
 të lëvduamin Perëndi Fialë. Amin.

---

O e lëvduashme Povirgjërë Mëmë  
 e t'in'Zoti, ndej Parkalesin t'ënë  
 Birit t'ënt e Perëndis t'ënë e  
 lipi të na shpëtonjë, paj t'ënt,  
 shpirtat t'anë.

Shpresa jime ë Ati, pështrimi jim  
 ë Biri, mbrojtia jime Shpirti i  
 Shejt: o Trini Shejte lëvdi Tij.

Gjithë shpresën t'ime e vura  
 tek Ti, o Mëma e dritës, ruajëm Ti  
 nën pështrimin të shpagarit t'...

NGA MENGJESORI (mattutino) i  
TË DIELLIËS

Bekuar kloft Perëndia jinë kur-  
doherë, nani e për gjithëmonë e  
për jetë të jetëvet.

P. -Amin. Në embër të t'in'Zoti  
bekona, o Zot.

Z. -Lëvdi past Trinia e shejte e  
njëtëklënëshme, e pandarshme e  
gjellëdhënëse, nani e për gji-  
thëmonë e për jetë të jetëvet

P. -Amin.

.....

Perëndi isht in'Zot e na u dëf-  
tua neve, i bekuar kush vien në  
embër të t'in'Zoti.

-Lëvdoni t'ën'Zonë, edhe thër-  
rini embrin e'Tij të shejt.

-Gjithë popujit më kanë rreth-  
uar e në embër të t'in'Zoti u  
kam ruajtur nga ata.

Kjo punë u bë për anë të t'in'  
Zoti, e isht e famasëshme për-  
para sivet t'anë.

APOLITIKJET E TË DIALLIAVET

## I

Kur guri kle vulosur nga Judhe-  
njët\* e si ushtarët të ruajën kur-  
min të pangar,\* u ngreve tri ditë-  
sh,\* o Shelbues,\* gjellën jetës tue  
dhënë,\* Prandai e kjielliavet fuk-  
jit\* 'lurijën Tij, Gjellëdhënës:\*  
lëvdi Ngjallies t'ënde,\* o Krisht,\*  
lëvdi Rregjëris t'ënde,\* lëvdi ku-  
jdesit t'ënt,\* o i vetmi njeridashës.

## II

Kur u sdripe nga vdekjia,\* o gje-  
llë e pavdekshme,\* atëherë Pisës  
vdekjien i dhe\* me të shkëlqierit  
e Hjnys,\* Atëherë nga nënshtresat  
e dheut të vdekurit ngjalle.\* Gji-  
thë fukjit të larta ëngjëllore  
po thërresien:\* o Gjellëdhënës Kri-  
sht, Perëndia jinë, lëvdi Tij,

## III

Le të dëfrenën kjielliat,\* le të  
gëzonet dheu,\* se punë të mëdha  
bëri me krahun e 'Tij in'Zot;\* Ai  
edhe shkeli vdekjien me vdekjien;  
\*u bë i paralinduri i të vdekur-  
vet.\* Nga gropa e Pisës neve na

liroi,\*e jetës i dha të madhen  
lipisi.

## IV

Të gzuamen e Ngjallies nduhtë\*  
si nga Ëngjëlli dsun\*e t'in'Zo-  
ti dsënësëvet\*e prindravet mah-  
kimin të helkjur Apostojvet me  
gzim i than:\*kle mundur vdekjia  
\*u ngre Krishti Perëndi\*tue dhë-  
në jetës të madhen lipisi.

## V

Të panisëshmen Fialë me Atin e  
me Shpirtin\*çë leu nga Virgjëra  
për shëndetën t'ënë\*lëvdojëm të  
besmë e proskjimisiëm;\*se deshi  
me kurm\*të hipej në krikj\*e mo-  
rtien të duroj;\*e të vdekurit  
të ngjallëj\*me ngjallien të lëv-  
duashme e'Tij.

## VI

Fukjiti ëngjellore mbi varrin  
t'ënt e si të vdekurë ran ata  
ç'e ruajën\*e mbeti Mëria tue  
kërkuar mbi varrin \* të pangaz-  
rin Kurmin t'ënt.\* Plakose ti  
Pisën \* pa klënë ngar nga ajo



përpokje Ti Virgjëreshën \* e  
 gjellën i dhe; \*o i ngjalluri  
 së vdekurish, o Zot, paçe lëvdi!

## VII

E prishe me krikjen Ti vdekjen  
 \* i sbille kusarit Parraisin \* të  
 Miroforëvet vajin i prore \* e  
 Apostojvet t'atë urdhurove të  
 leçitiën: \* se u ngjalle, o Krisht  
 Perëndi, tue i dhënë jetës të  
 madhen lipisi.

## VIII

S'larti u sdripe, o i përball-  
 shëm \* te varri tri ditësh Ti  
 hire, \* nga epshet t'ona t'na  
 lirosh, o Gjella e Ngjallia jonë  
 \* lëvdi Tij, o i Madh'in'Zot.

P O L I E L E O S (ms.135)

Lartësoni t'ënë Zonë se isht i  
 mirë!

Allilua. Se e pasosme isht lipi-  
 sia e'Tij .Allilua.

- Lartësoni Perëndin e Perëndiravet,
- Lartësoni Zotin e Zotravet.
- Lartësoni Atë që bënë famasmë të mbëdha i vetëm;Atë që bëri kjielliat me mendie;Atë që shtroi dheun mbi ujërat.
- Lartësoni Atë që bëri dritarë të mbëdhenjë i vetëm:diellin për urdhur të ditës,hënzën e izet për urdhur të natës.
- Lartësoni Atë që rahu Egjiptin bashk me paralindësit e'tireve,e që ndsori Israelin ndër mes t' atireve,me dorë të fortë e me krah të glatë.
- Lartësoni Atë që ndajti dejtin e kukj ndish:Atë që bëri të shk-oj Israeli ndër mes t'atij;Atë që shtu Faraonin e ushtrin e'tij te dejti i kukj.
- Lartësoni Atë që kjelli popullin e'Tij për në shkretirë;Atë që mundi rregjëra të mbëdhenjë;Atë që vrau rregjëra të fortë.
- Sionin rregjin e Amorrenjëvet; e Ogin rregjin e Basanit;e që

dha dheun e'tire për trashgim...

-TRASHGIM Israelit popullit e'Tij.

-Se te mjerësia jonë u kujtua  
për ne in'Zot, e liroi neve nga  
armikjët t'anë; Ai që jep të ngrë-  
në gjithënjeriu.

-Lartësoni Perëndin e kjielliës.

EVLOJITARIA ANASTASIMA  
(Këndonen vetëm tek e diellia)

I bekuar je, o Zot, mësomë Ti të  
drejtat t'otë.

-Lusma e Ëngjëjvet \* u famas tue  
par Ti \* ndër të vdekurit nëmë-  
ruar, \* Tij o Shelbues, që të vde-  
kjes \* fukjin sose e jose, \* e që  
bashk me Tij Adhamin sgjove \* e  
nga Pisa gjithënjeri lirove.

I bekuar je, o Zot, ...

-Përçë mirrat \* përziëni me lotët  
\* për lipisi, o Dsënëse? \* Ëngjëlli  
që llambarisëj mbi varrin: \* Mir-

rëprurësëvet i thoshëj: \*shihni  
ju varrin e vërreni,\* se Shelbu-  
esi u ngre nga varri.

I bekuar je, o Zot...

-Menatnet njize \* Mirrëprurëset  
rrodhën në varrin t'ënt \* tue  
vajtuar; \* po përpara i dolli En-  
gjëlli e i tha: \* kjëroi i vajti-  
mit sosi, mos klani më; \* po Ngja-  
llien e Krishtit Apostojvet  
thoniji.

I bekuar je, o Zot,...

-Grat Mirrëprurëse \* tuke ardhur  
me murrë \* te varri jit, o Shelbu-  
es, \* gjegjën zërin e Engjëllit që  
thoshëj atireve: \* si ndër të vde-  
kurë \* në mëroni të Gjallin? \* se si  
Perëndi \* Ai nga varri u ngre.

Lëvdi...

-Adhurojëm Atin, \* edhe Birin e 'Tij  
\* edhe Shpirtin Shejt; \* Shejten tr-  
ini, \* në një klënie, \* tuke thirrur  
bashk me Serafimt: \* I Shejt, I  
Shejt, I Shejt je, o Zot.

Nani...

-Tuke lindur Gjellëdhënësin\*shpë-  
tove, o Virgjëreshë, \*Adhamin nga  
mëkata; e i dhe Evës \* gzim në  
vent të helmit; \* atë që ra nga  
gjella \* e ngrëfshit tek ajo pa-  
meta \* Ai që ngak Ti u mishërua  
Perëndi edhe Njeri.

Allilulia. Lëvdi Tij, o Perëndi. (3 he.)

.....

Që nga dialëria jime kam luftë  
me trazime t' Shpirtit; po Ti vet  
eja e më dihmë e shpëtomë, o Shel-  
buesi jim.

Ju që mbani mbri Sionit, ka t'  
jini të dhunuarm nga in'Zot, si  
bari pra në ziarr jini ju të  
djegur e bër shkrimp.

Lëvdi...

Paj të Shpirtit Shejt çilido Shp-  
irt vien në jetë, e e pastrë lar-  
tësonet e ndritësonet fort nga e  
Trinishmia Njëni fshehurith shej-  
tëruar.

Nani...

Paj të Shpirtit Shejt \*po buro-  
jën të gjithë hirevet kronjet\* e  
potisiën gjithë e tërë kriesën \*  
për të lerit e gjellës.

E sa të na bënjë të mirë të gje-  
gjemi Vangjejin Shejt, parkalesi-  
ëm t'ën'Zonë Perëndin t'ënë.

Lipisi, lipisi, lipisi, i Madh'in'  
Zot.

-Dieja! Ngrëhemi shtuara sa të gje-  
gjemi Vangjejin Shejt.  
Pakje të gjithëve.

-Edhe shpirtit t'ënt.

-Piesë të Vangjejit Shejt si  
shkruan Shën...

-Lëvdi Tij, o i Madh'in'Zot lëvdi  
Tij.

### VANGJEJI

(Një nga 12 të mëngjësorit)

.....

Nani çë pam të Ngjallurit e Kri-  
shtit, le t'i përmisemi t'in'Zoti,  
Isuthit të vetmit të pamëkatë.  
Proskjinisiëm Krikjen t'ënde, o  
Krisht, e Ngjallien t'ënde të she-  
jte himnojëm e lëvdojëm. Se Ti je

Perëndia jinë, ngë njohiëm na t'ja-  
tër veçë Teje e embrin t'ënt na  
thrresiëm. Ejani ju gjithë të bes-  
më, le t'i përmisemi Ngjallies s-  
shejte të Krishtit. Pse pr'anë të  
Krikjes erdhi hareja te gjithë je-  
ta. Tue bekuar gjithëmonë t'ën'Zonë  
lëvdojëm Ngjallien e 'Tij. Pse, tue  
duruar Krikjen për ne me vdekjien  
e 'Tij shkeli mortien.

Lëvdi...

Ti me ndërmjetimet e Mëmës s'ate,  
o i Dhimbëshëm, \*Ti shuajëm shumizën  
e mëkatëve t'ime.

Nani...

Kijmë lipisi, o i Madh'in'Zot, paj  
të madhes lipisi s'ate, e paj shu-  
mizës të dhëmshurivët t'ote shuaj  
paligjësin t'ime.

(Si gjindia vete të puthënj  
Vangjejin thuhet ms.50)

K E N K A E N E N D E

Tij, o Mëma e t'in'Zoti e Mëma e  
Dritës, me himne madhërojëm na.

-Madhëron Shpirti jim t'ënë  
Zonë, e frima jime u gzua te  
Perëndia, Shelbuesi jim.

-Tij më të nderoshme se Hje-  
ruvint e pa të përkrahur më të  
lëvdoshme se Serafimt, çë pa  
farë u ndotur të lartën Fialë  
linde, vërteta Mëma t'Zotit,  
po madhërojëm na.

-Se Ai shturi sit mbi ujtësin  
e shërbëtores s'tij: e shi se  
çë nani kanë të më lumërojnë  
gjithë jinit. Se më bë mua  
shërbise të mëdha i Mëndëmi  
e shejt isht embri i Tij.

-Tij më të nderoshme...

-E lipisia e'Tij jini pas jinie  
mbi ata ç'i trëmben Atij. Ai  
bëri fukji me krahun e'Tij,  
shprishi madhështorët te  
mendimi i zëmbres s'tire.



Tij më të nderoshme....

Ka gorromisur të fukjishmit nga thronet, e ka lartësuar të përunjurit; ka tsitur me të mira ata që kanë ur, e të pasurit i ka dërguar të mbrazët.

Tij më të nderoshme....

I ka ndihur Israelit shërbëtorit t' Tij, të kujtoj lipisin e' Tij, ashtu si i foli Atëravet t' anë, Abramit e farës s' Tij për gjithë jetë.

Tij më të nderoshme....

### L E V D I T

Ç' do frimë le t' lëvdonjë t' en' Zonë. Lëvdoni t' en' Zonë ju nga kjielliat, lëvdonie atë nga më i larti kjiell: Tij, o Perëndi, të r' get lëvdia.

Lëvdoni t' en' Zonë ju nga kjielliat; lëvdonie Atë në të lartit. Lëvdoni Atë, o ju gjithë Engjëjit e' Tij; lëvdoni Atë, o ju gjithë Fukjit e' Tija.

Lëvdoni Atë, o diellë e hënzë;  
 lëvdoni atë, ju gjithë izet e ti  
 drita.

Lëvdonie kjiellia e kjielliav-  
 et, se Ai foli e ata u bënë. Ai  
 urdhuroi e ata klenë stisurë.

Kloft lëvduar në kjiell e në  
 dhe Ai që jep fukji popullit  
 e'tij.

Lëvdi...nani...

Ti je shumë e bekuame, o Virgjë-  
 rë, Mëma e t'in'Zoti: pr'anë të  
 Atij që mori mishë ngah Ti Adhi  
 kle liruar, Adhami thërritur pra-  
 pa, mhkimi kle shlier, Eva kle li-  
 ruar, vrrar vdekjia e na pameta  
 patëm gjellën. Prandai tue kënd-  
 uar po thërresiëm: I bekuar Zoti  
 Krisht Perëndia jinë se kështu  
 i pëlkuje! Lëvdi Tij!

DOXOLOJIA

+Lëvdi Tij që dritën na dëfton  
e që jetën dritëson.

-Lëvdi në të lartit Perëndis,  
e mbi dhe pakje, ndër njerëzit  
vullnes e mirë.

-Imnojëm Tij, bekojëm Tij, adhu-  
rojëm Tij, lavdërojëm Tij, fal-  
nderojëm Tij për lëvdin t'ënde  
të madhe.

-O Zot, o Mbret, i kjiellit Pe-  
rëndi, At i gjithë mëndëshim:  
o Zot, Bir i Vetëm, Iisu Krisht,  
edhe Shpirt i Shejt.

-O Zot Perëndi, Kjenkji i Perë-  
ndis, i Atit Bir, që ndsier më-  
katën e jetës. <sup>lipisi për ne</sup>  
o Ti që ndsier mëkatët e jetës.

-Pritë mirë lutien t'ënë, Ti që  
rri ujur tek e drejta e Atit,  
e kijna lipisi.

-Se Ti vetëm je i Shejt, Ti ve-  
tëm je Zot, Iisu Krishti, në lë-  
di të Perëndis Atit. Amin.

-Ditë për ditë do t'bekonj Tij,  
do t'lavdëronj embrin t'ënt për  
jetë, e mbë jetë të jetës.

-Bën-na të mirë, o Zot, te kjo  
ditë të ruhem na të pamëkatë.

-I bekuar je, o Zot, Perëndia i  
Atëravet t'anë, dhe embri jit  
isht i kënduar e i lavdëruar  
më jetë të jetëvet. Amin.

-Klofshit, o Zot, lipisia jote  
mbi ne, ashtu si kemi shpresuar  
tek Ti.

-I bekuar je, o Zot, mësomë Ti  
të drejtat t'ote. (3 herë)

-O Zot, Ti pështrimi ke klënë  
për ne bres pas brezi. U thash:  
o Zot, lipisi për mua, shëndoshëm  
shpirtin, se përpara Teje mëka-  
trova.

-O Zot, tek Ti u kam gjetur pë-  
shtrim; mësomë të bënj vullimin  
t'ënt, se Ti je Perëndia jim.

-Se tek Ti isht burimi i gjel-  
lës; te drita jote do t' shohim  
na dritë.

-Sgjerò lipisin t' ende mbi ata  
çë të njohim.

Shejt Perëndi, Shejt i Fokjish-  
ëm, Shejt i pavdekshim, kij li-  
pisi për ne. (3 herë)

Lëvdi past... nani...

Shejt i pavdekshim, kij lipisi  
për ne.

Sot i jerdhi jetës shëndeta:  
lëvdojmë Atë që u ngrë nga varri  
e Atë që na dha gjellën; se tue  
shkelur vdekjen me vdekjen, na  
dha neve mundësin e të madhen  
lipisi.

Rregji i kjielliës që na përgë-  
zon, Shpirti i së Vërtetësisë që  
je gjithëasajtën e që gjithkujsh  
mbëlon; o tërsori i së miravet  
që gjellë dhuron, eja e rri me në  
e pastronë nga çëdo mëkatë, e ru-  
ana, o i Mirth, shpirtrat t'anë.

M E S H A

Zoti: Bekuarë rregjëria e Atit,  
Birit edhe e Shpirtit She-  
jt, nani e gjithëmonë e  
për jetë të jetëvet.

Pop.: Amin.

Z.: -Në pakje parkalesiëm t'ën'Zonë.

P.: Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Z.: -Për pakjen s'larti e për shën-  
detën e shpitravet t'anë,  
parkalesiëm t'ën'Zonë.

" -Për pakjen e gjithë jetës të-  
rë, e për kjëndresën e Klishë-  
vet shejte të Perëndis e sa  
gjithë një të jenë, parkales-  
iëm t'ën'Zonë.

" -Për këtë shpi shejte e për  
gjithë atà që këtù hijën me  
besë, me ponë e me trëmbësi të  
Perëndis, parkalesiëm t'ën'Zo-  
në.

" -Për Episkopin t'ënë (...), për  
të ndershëmen priftëri e dia-

këri te Krishti, për gjithë  
klerin e popullin, parkalesi-  
ëm t'ën'Zonë.

- " -Për të Parët t'anë, për gjithë  
shpin e ushtrin e'tire,  
parkalesiëm t'ën'Zonë.
- " -Për Horën t'ënë e për nha kji-  
tet edhe horë e për ata që i  
jesiën me besë, parkalesiëm  
t'ën'Zonë.
- " -Për motin e mirë, për burimin  
e pemëvet të dheut e për kjë-  
ronje të pakjëshme, parkale-  
siëm t'ën'Zonë.
- " -Për ata që janë mbi dejt, për  
në dhromë, të sëmure, që janë e  
riejën, për ata që janë në  
fulakji e për shëndetën e'ti-  
re, parkalesiëm t'ën'Zonë.
- " -Sa të na ruanjë nga çedò hel-  
me, mbri, rrëzikje e miçri,  
parkalesiëm t'ën'Zonë.
- " -Ndhëna, shpëtona, kijna lipisi  
dhe ruana, o Perëndi, me hirin  
t'ënt.

" -Tue kujtuar Zonjën t'ënë po Virgjërë, Mëmën e Perëndis, Shën Mërin, gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame, bashkë me gjithë shejtrat, e na njeri me t'jetrin e gjithë gjellën t'ënë i truajëm Zotit Krisht Perëndi.

P.-Tij , o i Madh'in'Zot.

Z.-Se Tij të nget nga lëvdi, nder e të përmisur: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

P.-Amin.

### I ANTIFONË O TYPIKA

Bukur isht të lëvdojmë t'ën'Zonë e të këndojmë embrin t'ënt, o i larti Ferëndi.

-Për parkalesitë të Mëmës t'ënde, o i Madh'in'Zot, shpëtona.

Lëvdi past Ati, Biri edhe Shpirti Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

-Për parkalesitë të Mëmës t'ënde, o i Madh'in'Zot, shpëtona.



Z.-Pamëta në pakje parkalesiëm  
t'ën'Zonë.

" -Ndihëna,shëtona,kijna lipisi  
dhe ruana,o Perëndi,me Hirin  
t'ënt.

P.-Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Z.-Tue kujtuar Zonjën t'ënë po  
Virgjërë,Mëmën e Perëndis,  
Shën Mërin,gjithë shejte,të  
dëlirë,të bekuame dhe të  
lëvduame,bashkë me gjithë  
shejtrat,e na njeri me t'je-  
trin e gjithë gjellën t'ënë  
i truajëm Zotit Krisht  
Perëndi.

P.- Tij , o i Madh'in'Zot.

Z.-Se jotia ë pushtetia,si edhe  
rregjëria e fukjia e lëvdia:e  
Atit,e Birit edhe e Shpirtit  
Shejt,nani e për gjithëmonë  
e për jetë të jetëvet.

P.- Amin.

## II ANTIFONË O TYPIKA

In'Zot rregjëron e pështronet me  
nder të math;in'Zot Vishet e me  
fukji rrethonet.

Për parkalesitë të Shejtravet  
t'atë, o i Madh'In'Zot, shpëtona.

Lëvdi...nani...

O i vetëmi Bir e Fialë e Perëndis \*  
Ti që je i pavdekshim, \*  
deshe të njerëzoeshe \* e të  
mirrie kurm për shëndetën e  
shpirtit t'ënë \* në gji të Shejtes  
Mëmë \* e po Virgjërë e Shën Mëri.

Ti që pandëruar njeri u bëre \*  
e vunë n'krikj, \* o Krisht o Perëndi,  
\* me mortien t'ënde mortien shkele,  
\* Ti që je \* një nga Trinia Shejte  
i bashkëlëvduar \* me Atin e me Shpirtin  
Shejt, \* jipëna gjellë të pasosme.

Z.-Pameta në pakje parkalesiëm  
t'ën'Zonë.

" -Ndihëna, shpëtona, kijna lipisi,  
dhe ruana, o Perëndi, me Hirin  
t'ënt.

" -Tue kujtua Zonjën t'ënë po  
Virgjërë, Mëmën e Perëndis,  
Shën Mërin, gjithë shejte, të  
dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame,  
bashkë me gjithë Shejtrat, e na e njeri me t'jetrin

e gjithë gjellën t'ënë i  
trujtëm Zotit Krisht Perëndi.

P.- Tij , o i Madh'in'Zot.

Z.-Se Ti je Perëndi i mirë e që  
do mirë gjithënjeri e na të  
japiëm lëvdi Tij:Atit,Birit ,  
e Shpirtit Shejt,nani e për  
gjithëmonë e për jetë të  
jetëvet.

P.-Amin.

### III ANTIFONË O MAKARISMI

Ejani të gëzonemi tek in'Zot;  
ngrëjëm zërin me hajdi,Perëndis,  
Shëndeta jonë.

P.-Shpëtona,o i Biri i Perëndis,  
i ngjalluri së vdekurish,  
(i famasëshëm ndër shejtrat)  
neve që të këndojm:Aliluia.

### HIRIA E VOGËLË

Z.- Dieja! Shtuara.

P.-Ejani t'i falemi e t'i përmi-  
semi Zotit Krisht.

-Shpëtona,o i Biri i Perëndis,

-ingjalluri së vdekurish,  
 (i famasëshmë ndër Shejtrat)  
 neve çë të këndojëm: Aliluia.

Z.-Parkalesiëm t'ën'Zonë.

P.-Lipsi, o i Madh'in'Zot.

Z.-Se Ti je i Shejt, o Perëndia  
 jinë, e na të japiëm lëvdi Tij:  
 Atit, Birit e Shpirtit Shejt,  
 nani e për gjithëmonë e për  
 jetë të jetëvet.

P.- Amin. Shejt Perëndi, Shejt i  
 Fukjishëm, Shejt i Pavdekshim:  
 kij lipisi për ne. (3 herë)

Lëvdi past Ati, Biri e Shpirti  
 Shejt, nani e për gjithëmonë  
 e për jetë të jetëvet. Amin,  
 Shejt i Pavdekshim, kij lipisi  
 për ne.

Z.-Fukji!

P.-Shejt Perëndi, Shejt i Fukji-  
 shëm, Shejt i Pavdekshim, kij  
 lipisi për ne.

-Oh! Sa në Krisht u pagëzuatë,  
me Krishtin ju veshët. Alliluia.

-Krikjen t'ënde proskjinisiëm,  
o i Madh'in'Zot, e Ngjallien  
t'ënde të shejte lëvdojëm.

Z.-Vumëji're!...DIEJA!!..Gjegjemi!

P.-Alliluia. (3 herë)

V A N G J E J I

Z.-DIEJA! Shtuara, gjegjemi Van-  
gjejin shejt. Pakje të gjithëve.

B.-Edhe shpirtit t'ënt.

Z.-Piesë të Vangjejit Shejt si  
shkruan Shën... (Luk. Mat. Mar. Ja.)

P.-Lëvdi Tij, o i Madh'in'Zot,  
lëvdi Tij.

P.-Lëvdi Tij, o i Madh'im'Zot,  
Lëvdi Tij. Për shumë vietë, o Zot.

Z.-Të gjithë po thomi me gjithë zëmbër e me gjithë mendien t'ënë, po thomi.

P.-Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Z.-O Zot i gjithëmëndëm, Perëndia i Ateravet t'anë, na të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijna lipisi.

" -Kijna lipisi, O Perëndi, për sa e madhe isht lipisia jote, na të parkalesiëm, Ti gjrgjëna e kijna lipisi.

" -Parkalesiëm edhe për Episkopin t'ënë (...) e për të ndershëmen priftëri.

" -Parkalesiëm edhe për vëllezërit t'anë: priftra, kallogjerë, diakëra e për gjithë vëllezërin t'ënë në Krisht.

" -Pärkalesiëm edhe për lipisi, pakje, shëndet, shpëtim, kujdes, falie e ndëjes të mëkatëvet të shërbëtorëvet të Perëndis, që rrojën te kjo horë.

Z.-Parkalesiëm edhe për ata të lumë e të paharruashëmë që stisën këtë Klishë shejte e për gjithë Prindrat e Vëllezërit t'anë që vdikjën me besë e që flën varrëzuar këtu e ku do ndodhen.

" Parkalesiëm edhe për të besmit që ndihiën e shërbejën mirë këtë e ndershëmë Klishë shejte, për ata që i sbiren e i këndojën e për gjithë popullin që këtu ndodhet e pret nga Ti të mëdha e të shuma lipisi t'ote.

P. Për shumë vietë, o Zot.

Z.-Se Ti je Perëndia i lipisis me njeriun që do mirë e na të japiëm lëvdi Tij: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nanë e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

P.- Amin. Na këtu Hjeruvimt mistkjisht tue shfakjurith edhe na Trinis Shejte gjallësore trishejten kënkë tue kënduarith, po lëmë mbë njanë e gjellës qëdo kujdes, sa të presiëm Rregjin....

Z.-U kujtoft Perëndia i Madh'in'  
Zot për ne të gjithë te rregjë-  
ria e Tij, nga herë nani e për  
gjithëmpnë e për jetë të jetë-  
vet.

P.-Amin. . . .sa të presiëm Rregjin  
e gjithësis, çë rrethuar vienë  
pa parë tufa tufa Engjëjish. Al.

Z.-Le të mbarojëm parkalesin  
t'ënë t'in'Zoti.

P.-Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Z.-Për të shtrejta dhurata këtu  
paravuna, parkalesiëm t'ën'Zonë

" -Për këtë shpi shejte e për  
gjithë ata çë këtu hijën me  
besë, me poni e me trëmbësi të  
Perëndis, parkalesiëm t'ën'Zonë.

" -Sa të na ruanjë nga çëdo helme  
mbri, rrëzikje e mlieri,  
parkalesiëm t'ën'Zonë.

" -Ndihëna, shpëtona, kijna lipisi  
dhe ruana, o Perëndi, me Hirin  
t'ënt.



- Z.-Të na shkonjë gjithë dita e mbaruame më se më, e shejte, me pakjen, e pamëkatë, lipëmia t'in'Zoti.
- P.- Gjegjëna, o i Madh'in'Zot.
- Z.- Ëngjëllin e pakjes, që i besmë na kjellë te dhromi i drejt e që ruanë shpirtrat e kurmet t'anë, lipëmia t'in'Zoti.
- " -Ndëjesën e falien e mëkatëvet e të fajevet t'anë, lipëmia t'in'Zoti.
- " -Të mirat e çëdo i duhet shpirtravet t'anë e pakjen për jetën, lipëmia t'in'Zoti.
- " -Kjëroin që na vietet të gjellës t'ënë të e sosiëm me pakje e me pendës, lipëmia t'in'Zoti.
- " -Si të krështerë të sosurit e gjellës t'ënë, pa dhëmbie, pa të kjërtuamë, në pakje e me mbrojtje të mirë përpara gjikjit të drëruashëm të Krishtit, lipëmia t'in'zoti.

Z.-Tue kujtuar Zonjën t'ënë po Virgjërë, Mëmën e Perëndis, Shë Merin, gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame, bashkë me gjithë Shejtrat, e na e njeri me t'jetrin e gjithë gjellën t'ënë i Truajëm Zotit Krisht Perëndi.

P.-Tij, o i Madh'in'Zot.

Z.-Për lipisit e të vetëmit ler t'it Biri, me të çilin je i bekuar, bashkë me të gjithëshejtin, të mirë e gjellëdhënës Shpirt t'ënt, nani e për gjithë monë e për jetë të jetëvet.

P.- Amin.

Z.- Pakje të gjithëve.

P.- Edhe shpirtit t'ënt.

Z.-Të duhemi mirë njeri me t'jetrin sa njëi mendie të ligjërojëm:

P.-Amin, Birin e Shpirtin Shejt, Trinin me një të klënët e të pandarshme.

Z.-Dierte!Dierte!Me urtësi.Vum're.

P.- U kam besë te Perëndia,Ati i gjithëmëndëmi,çë bëri kjielliën e dheun,edhe te Jisu Krishti i Biri i'Tij i vetëmi Zot i jinë, i çili zuri paj të Shpirtit Shejt e leu nga Virgjëra e Shën Mëri. Duroi non Ponts Pilatit,kle vënë ngrikj,vdikj e kle varrëzuar. U sdrip te Pisa,të tretën ditë u ngjall së vdekurish.U ngjip te kjiellia e rri te ana e drejt e të Jatit të gjithëmëndëmi Perëndi.Andai ka të vinjë pameta të bënë ligjë mbi të gjallit e mbi të vdekurit.U kam besë te Shpirti Shejt,te Klisha shejte katolike, te shokjëria e shejtravet,te të ngjallurit e kurmit e te gjella e pasosme. Amin .

A N A F O R A

Z.-Rrim me lutësi!Rrim me trëmbësi! Vum're të faliëm shejten Dhuratë në pakje.

P.-Lipisi pakje,flijë lëvdimi.

Z.-Hiri i t'in'Zoti Jisu Krishti,  
e Dashuria e Perëndis e At,e  
të Marrit pjesë të Shpirtit  
Shejt,kloft me ju të gjithë.

P.- Edhe me shpirtin t'ënt.

Z.-Ngrëjëm në të lartit zëmbnat  
t'ona.

P.- I kemi tek in'Zot.

Z.- Haristisiëm t'ën'zonë.

P.-Mirë isht e drejt t'i përmis-  
emi Atit,Birit e Shpirtit  
Shejt:Trinis me një të klënët  
e të pandarshme

Z.-E kënkën e mundësis tue kënd-  
uar,tue 'luritur,tue thërritur  
e tue thënë:

P.-I Shejt,I Shejt,I Shejt,Zoti  
Savaoth.Kjielli e dheu janë  
plotë me lëvdin t'ënde.Osannà  
te m'i larti kjiell.I bekuar  
ai që vien në embër të t'in'  
Zoti.Osannà te m'i larti kjiell

Z.-Mirrni,hani:Ki isht Kurmi i  
jim,çë çahet për ju për

për ndëjesë të mëkatëvet.

P.- Amin.

Z.- Pini prej këtij të gjithë:  
Ki është Gjaku i jime, të Dhi-  
atës së re, që derdhet për ju  
e për shumë për ndëjesë të  
mëkatëvet.

P.- Amin.

Z.- Na Tij të faliëm t'otet nga  
t'otet ndër të gjitha e mbi  
të gjitha.

P.- Të lëvdojëm, të bekojëm, të  
haristisiëm, o i Madh'in'Zot,  
të parkalesiëm, o Perëndia jinë.

Z.- Më se më për Mëmën e Perëndis  
të gjithë shejte, të dëlirë, të  
bekuame edhe të lëvduame, Zonj-  
ën t'ënë po Virgjërë Shën Mëri.

P.- I math është embri i Trinis  
Shejte.

Shumë mirë është me të vërtetë  
sa të thomi Tij të lume Zonjë  
për gjithëmonë t'lumëshme dhe  
të papërlieme edhe Mëmë të të  
Madhit Zot.

Tij më të nderoshme se Hjeruvimt e pa të përkrahur  
 më të lëvdoshme se Serafimt,  
 çë pa fare u ndotur  
 të lartën Fialë linde,  
 vërteta Mëma t'Zotit,  
 po madhërojëm na.

Madhëro, o shpirti jim, më të  
 nderoshmen e më të lëvdoshmen  
 ndër gjithë ushtrit e kjiellit.

Mister të math u shoh e të  
 humbët: për kjiell shpellën;  
 për thëon ndër Hjeruvimt  
 Virgjëreshën; grazhdin për vend  
 tekun kle ngulur i pasosmi  
 Krisht Perëndia, të Çilin tue  
 kënduar madhërojëm na.

Engjëlli i thërrisëj Hir-  
 plotës e Shën Mëri: -Moj Virgj-  
 ërë e dëlirë, po gëzou, u të  
 thomë, gëzou. -Se jit Bir u ngre  
 tri ditësh nga varri edhe  
 ngrëjti të vdekuritë. -E ju po-  
 pujuj harë të bëni.

Ndritu!Ndritu! Ti Jerusolim e re,  
po ndritu,psë lëvdia e t'in'Zoti  
mbi Tij u dëftua.-Bëj harë e na-  
ni gëzou,Sion.- E Ti e dëlirë,  
Mëma e Perëndis,bëj haidhî te  
të Ngjallurit e Dialit t'ënt.

---

Z.-Ndër të parët kujtou,o i Ma-  
dh'in'Zot,për Papën t'ënë (..) e për Episkopin t'ënë (..),kuj  
jipi të jenë për klishët t'ote  
shejte,të ruajtur,të ndërmë,  
me pakje,me shëndetë e me di-  
të të glata,sa të ligjërojën  
drejt Fialën e s'vërteties  
s'ate. Edhe kujtou për gji-  
thë ata që nga njeri neshë  
ka në mendie.

P.-Për të gjithë e për të gjitha.

Z.-E jipëna sa me një gojë e me  
një zëmbër të lëvdojmë e të  
këndojmë të gjithëndershmin  
e të madhëruashmin embër t'ënt  
të Atit,të Birit e të Shpirtit  
Shejt,nani e për gjithëmonë e  
e për jetë të jetëvet.

P.Amin.

Z.-E lipisit e të Madhit Perëndi e Shpëtuesi jinë Iisu Krishti, k'lofshin me ju të gjith.

P.-Edhe me shpirtin t'ënt.

Z.-Posa kemi kujtuar gjithë Shejttrat, pameta në pakje parkalesiëm t-En'Zonë.

P.-Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Z.-Për të shtrejtat Dhurata paravuna e të shejtëruame, parkalesiëm t'ën'Zonë.

" -Sa Perëndia jinë çë njeriun do mirë e çë i mori me-hirë mbi shejten therore të'Tij të kjiellshmë e të mendëshëm si bukur erë shpirtullore, nani na dhëfshit Hirin të perëndishëm e Dhuratën e Shpirtit Shejt, parkalesiëm t'ën'Zonë.

"--Sa të na ruanjë nga çëdo helme, mbri, rrëzikje e mieri, parkalesiëm t'ën'Zonë.

" -Ndi hna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o Perëndi, me Hirin t'ënt.



Z.-Posa lipëm njënin e besës e të Marrit pjesë të Shpirtit Shejt,na e njeri me t'jtrin e gjithë gjellën t'ënë i truajëm Zotit Krisht Perëndi.

P.- Tij , o i Madh'in'Zot.

Z.-E bëna të mirë,o i Madh'in' Zot,sa me besë e pa ftesë të kudsojëm të të thërresiëm Tij si Tate,Perëndi i Kjiellëshëm, e të të thomi:

Ati i jinë çë je në kjiell,shejtëruar kloft Embri jít,arthët rregjëria jote,u bëft vullimi i jít,si në kjiell ashtù në dhe.

Bukën t'ënë të përditçënen ëna neve sot,ndëjena dëtirët t'ona,ashtù si edhe na ja ndëjejem të dëtëruamëvet t'anë,e mos na le të biem ndë ngarie,po lirona nga i ligu.

Z.-Se jotia isht rregjëria,fukjia e lëvdia:e Atit,e Birit edhe e Shpirtit Shejt,nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet

P.-Amin.

Z.-Pakje të gjithëve.

P.-Edhe shpirtit t'ënt.

Z.-Ujëni kriet t'ajë t'in'Zoti!

P.-Tij , o i Madh'in'Zot.

Z.-Me Hirin e me lipisit e me mirësin që ka me në jiti Bir i vetëmi ler, me të çilin je i bekuar bashkë me gjithë shejt in, të mirë e gjellëdhënës Shpirtin t'ënt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

P.- Amin.

Z.-Vumji 're.

P.-Për ndihmë të gjithë të besmëvet të krështerë t'vërtetë.

Z.-Të Shejtëtë Shejtravet.

P.-Një i Shejti, një i Zoti: Iisu Krishti, në lëvdi të Atit Përrëndi. Amin.

### KJINONIKON

Tek e Diellia: Lëvdoni t'ën'Zonë ju nga kjiellia; lëvdonie Atë te m'i larti kjiell. Aliluia-3h-

Tek e Hënia: Ai që bëri frima En-  
gjëjitë t' Tij e shërbëtorë t' Tij  
flaka ziarri. Alilua (3 herë)

Tek e Martia: Në kujtim të pasosmë  
ka t' jet i drejti e ngë ka t' trë-  
mbet për zër të kekjë. Alilua (3h)

Tek e Mërkuria: Kjelkjin e shën-  
deties u dua të marrë, e embri e  
t' in' Zoti u dua të thërres. Alil.

Tek e Intia: Te gjithë jeta dolli  
zëri i 'tire; te gjithë anët e  
bptës fialët e 'tire. Alilua (3 h)

Tek e Prëmtia: U dëftua mbi ne  
drita e fakjes s' ate, o i Madh'  
in' zot. Alilua (3 herë)

Tek e Shtunia: Të lumë ata që Ti  
ke sgledhur, o i Madh' in' Zot, Kuj-  
timi i 'tire bres pas brezi. Alil.

### KUNGIMI

Z.-Me trëmbësi të Perëndis, me be-  
së e me dashuri: të kjasij.

P.-Amin. Amin. I bekuar ai që vien  
në embër të t' in' Zoti: Perëndia  
Zot edhe na u dëftua nëve.

Të Darkës t'ënde mistike, o i Biri i Perëndis, vur sot në pjesë edhe mua; se u armikjëvet t'atë Misterin t'ënt u ngë i thomë, e ngë të puth si të puthi Judha po si Kusari i mirë u të thomë: për mua kujtoui, o Zot, o Krisht, o i Shejt te rregjëria jote.

Z.-Shpëtò, o Perëndi, pòpullin t'ënt, edhe bekò trazhgimin t'ënt.

P.-Për shumë vietë o Zot.

-Pamë dritën e vërtetë, muatëm Shpirtin të Kjielliës, gjetëm besën e vërtetë, tue u falur prëmist Trinis të pandarshme, se kjò neve na shpëtòi.

Z.-Bekuar kloft Perëndia jonë, nga herë, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

P. Amin.-Për ndëjesë të mëkatëvet e për gjellë të pasosme. Alilua, Alilua, Alilua.

Z.-Na çë u kemi kunguar me misteret të Krishtit, të perën-

dishëm, të shejtë, të dëlirë, të  
pavdekhëm, të kjiellëshëm, gje-  
llëdhënësë, të dreruashëm, si  
ngjet haristisiëm t'ën'Zonë.

P.-Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Z.-Ndihëna, shpëtona, kijna lipisi  
dhe ruana, o Perëndi, me Hirin  
t'ënt.

P.-Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Z.-Tue lipur të na shkonjë gjithë  
dita e mbaruame më se më, e she-  
jte, me pakjen e pamëkatë, na  
njeri me t'jetrin e gjithë gje-  
llën t'ënë i truajëm Zotit  
Krisht Perëndi.

P.-Tij , o i Madh'in'Zot.

Z.-Se Ti je të shejtëruamit t'anë  
e na të japiëm lëvdi Tij: Atit,  
Birit e Shpirtit Shejt, nani e  
për gjithëmonë e për jetë të  
jetëvet.

P.-Amin.

Z.-Le të vemi me pakjen.

P.-Me embrin e t'in'Zoti.

Z.-Parkalesiëm t'ën'Zonë.

P.-Lipisi, lipisi, lipisi, o i Madh'iq'Zot. Bekona, o Zot.

Z.-O i Madh'in'Zot, që bekon ata që të bekojnë e shejtëron ata që tek Ti kanë besë: Shpëtò popullin t'ënt e bekò trazhgimin t'ënt.

Ruaj plotësin e Klishës s'ate, shejtërò ata që duan hjen e shpis s'ate.

Ti këthei lëvdin me fukjin t'ënde të perëndishëme, e mos na le neve që kemi shpresën tek Ti.

Ti dhurò pakjen jetës s'ate, Klishëvet t'ote, priftëris, të Parëvet t'anë, ushtris e gjithë popullit t'ënt; se çëdo të dhënë të mirë e çëdo dhuratë e përsosurë vien s'larti, sdripet ngak Ti: Ati i dritëvet, e na të japëjëm lëvdin, të haristisurit e të përmisurit Tij: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

P.- Amin. Embri i t'in'Zoti kloft i bekuar nani e për gjithëmonë. (3 herë)

Z.-Parkalesiëm t'ën'Zonë.

P.-Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Z!-Bekimi i t'in'Zoti e lipisia e'Tij arthët mbi ju me Hirin e'Tij e me mirësin,nga herë,nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. P.- Amin.

Z.-Lëvdi Tij,o Perëndia jinë,  
shpresa jonë,lëvdi Tij.

P.-Lëvdi...nani...Amin.Lipisi,  
lipisi,lipisi,o i Madh'in'Zot,  
bekona,o Zot.

Krishti,Perëndia jinë i vërtetë,  
i ngjalluri së vdekurish,për parkalesit të Mëmës s'Tij,e dëlirë e e pamëkatë,me fukjin e Krikjes shejte e gjellëdhënëse,me mbrojtje të të ndershmëvet pushtetie të poshpirtëshme të kjielliës, për lutiet e të ndershmit e të lëvduashmit Profet e paradhromë Shën'Jani Pagëzor,paj të vëlduashmëvet shejtra Apostoj të përmendëshim e të shejtravet desh-orë,paj të shejtravet Atëra t'anë e të Atit t'ënë ndër shejtrat S.Jani Gojart,paj të shejtravet

të drejtë Gjishëra të Perëndis  
 Shën Jakini e S. Ana, të Shejtit  
 (...) që sot kujtojmë edhe të  
 gjithë shejtravet, na paçit li-  
 pisi e na shpëtoft si i mirë e  
 që njeriun do mirë. P.-Amin.

---

Eja, o Zot e Perëndi,  
 në këtë zëmbër e në këtë gjë;  
 u të pres me lotë ndër s'f  
 me gëzim e trëmbësi,  
 me tërbim e me harë  
 te ki shpirt që mua më dhe.

Për këtë shpirt te jeta jerdhe  
 e për mua gjithë gjakun derdhe,  
 për atë Gjak të parkales  
 - Ipme Hir sa mos të t'ftes  
 Perëndi tri herë Shejt;  
 te kjo zëmbër eja shpejt,  
 - eja shpejt e mos mëno,  
 e këtë shpirt më shejtëro.  
 Mos t'vërresh, o i Madh'in'Zot,  
 se u jam një grushtëth botë  
 po t'kujtos se Ti je At  
 eja njize somenat.



jo për gjithëmonë do t'jet i zëmëruar, jo për jetë të jetëvet do të mbanjë mbrî.

Ngë ka bërë pas ftesavet t'ona; ngë ka paguar pas mëkatëvet t'ona.

Se sa e lartë isht Kjiellia nga dheu, akjë të madhe e ka bër in'Zot lipisin e'Tij mbi ata që i trëmben.

Sa mban të lerit e diellit nga perëndimi, akjë ka mbajtur lla-rgu nesh ftesat t'ona.

Sa isht i lipisiar një print për bijët, ashtu ka klënë i lipisiar in'Zot për ata që i trëmben; se Ai njih si jemi të gjeshur e kujton se jemi plëh.

Njeriu: si bari janë ditët e'tija; si lulëja e fushës ai lulëzon

Sa shkon era mbi Atë e ai ngë isht më e mosnjeri njih më vendin e'tij.

Po lipisia e T'in'Zoti nglatet mbë jetë të jetëvet mbi ata që i trëmben.

E drejtësia e'Tij mbi të bijët  
e të bijëvet për ata që ruajën  
dhiatën e'Tij e që kujtojnë  
urdhurimet e'Tij sa t'i ruajën.

In'zot te kjiellia dërtoi thronin  
e'Tij e rregjëria e'Tij mbi  
gjithëkjish zotëron.

Bekoni t'ën'Zonë gjithë ju  
Ëngjëjit e'Tij, të fortë me fukji,  
ju që bëni fialën e'Tij, që mir-  
rëni veshë zërin e fialëvet etija.

Bekoni t'ën'Zonë ju gjithë fu-  
kjit e'Tija, ju shërbëtorët e'Tij  
që bëni vullimin e'Tij.

Bekoni t'ën'Zonë ju të gjitha  
sa jini punët e'Tija në çëdo  
vend të zotëris s'Tij: Bekò, o  
shpirti jim, t'ën'Zonë.

Lëvdi Atit...nani...Amin.

Bekò, o shpirti jim, t'ën'Zonë,  
e gjithë të brëndëshit e mia  
embrin e'Tij të shejt.

I bekuar je Ti, o Zot.

II) Lëvdi Atit e Birit e Shpirtit Shejt.

(Ms.145) Lëvdò, o shpirti jim,  
t'ën'Zonë:ka t'lëvdonjë t'ën'  
Zonë te gjella jime;ka t'këndonjë  
Perëndin t'im njer që të jem.

Mos besoni në të Parët,në të  
bijët e njerëzëvet te të çilët  
ngë isht shëndetë.

Ka t'i danjë shpirti i'tij e  
do të priret te dheu i'tij.

Tek ajo ditë të gjithë ka të  
prishen të gjithë mendimet e'  
tij.

Lumë ai kuj Perëndia i Jakobit  
ë ndihma;e shpresa e'tij në të  
ën'Zonë,Perëndia i'tij.

I çili bëri kjielliën e dheun  
e dëjtin e gjithëkjish sa janë  
tek ata.

I çili ruan të vërtetën për  
gjithëmonë e bën ligjë atireve  
që durojnë të paligjë e jep të  
ngrënë atireve që kanë urë.

In'Zot sglith të lidhurit; in'Zot  
ndrit të verbërit; in'Zot ndrekj  
të kurrusmit; in'Zot do të drejtit;  
in'Zot ruan të huajit.

Të varfërin e të ven Ai mburon  
e dhromin e të likjëvet shkatarron.

Ka t'rregjëronjë in'zot mbë jetë  
të jetëvet, Perëndia jit, o Sion,  
jini pas jinie.

Nani...Amin.

O i vetmi Bir e Fialë e Perëndis,  
Ti që je i pavdekëshim, dehe të  
njerëzoeshe e të mirrie kurmë  
për shëndetën e shpirtit t'ënë  
në gji të Shejtes Mëmë e Povirgjë-  
rë e Shën Mëri.

Ti që pandërruar Njeri u bëre e  
vunë n'krikj, o Krisht o Perëndi,  
me mortien t'ënde mortien shkele,  
Ti që je një nga Trinia Shejte i  
bashkëlëvduar me Atin e me Shpir-  
tin Shejt, jipëna gjellë të paso-  
sme.

### L U M E R I T

(Në vent të të tretës. Antifonë.)

Te Rregjëria jote kujtou për ne, o Zot, kur të veç te rregjëria jote.

Të lumë të vapkjit në shpirt, se e'tiria isht rregjëria e kjielliavet.

Të lumë ata që klanë, se ata ka t'jenë ngushëlluar.

Të lumë të butit, se ata ka të trazhgojën jetën.

Të lumë ata që kanë uri e etë ligje, se ata ka t'jenë tsitur.

Të lumë lipisiarët, se ata ka t'gjejën lipisi.

Të lumë ata që kanë zëmbren e pastërë, se ata ka t'shohjën Perëndin.

Të lumë pakjësorët, se ata ka të thritën bij të Perëndis.

Të lumë ata që janë të përzën për drejtësin, se isht e'tiria rregjëria e kjielliavet.

Të lumë jinë ju kur ju shajën e kur jë përzën, e kur ju thonë çëdo fialë të liga me të rreme paj t'meje.

Gëzonij e bëni harë, se e madhe do t'jet rroga juaj te kjiellia.

Lëvdi...nani...

TETË ZËRET TË LUMËRIVET

## I

Për të ngrënit armiku \* jashta Parraisit shtu Adhamin;\* po për krikjen Krishti \* atie këlliti Kusarin,\* i çili thrisëj: kujtoui për mua \* kur të veç \* te Rregjëria jote.

U i falem Pesimevet t'atë,\* e lavdëronj t'Ngallurit t'atë,\* bashk me Adhamin e me Kusarin \* me zër të mathë u thërres:\* kujtoui për mua,o Zot,\* kur të veç\* te Rregjëria jote.

Lëvdi...

Adhurojëm Atin \* e lëvdojëm Birin \* e bashk tërëshejtin Shpirt të gjithë imnojëm \* tue luritur e tue thënë:\* O Tërëshejtia Trini,\* shpëtona të gjithëve.

Nani...

Mëmën t'ënde t'vu përpara \* për lutie populli jit,o Krisht;\* me ndërmetimet e'saj,o i Mirë,\* sana t'lëvdojëm \* Tij çë nga varri na u duke.

## II

Zërin e Kusarit \* tek Ti ngrë-  
jëm e thrresiëm: \* Kujtou për ne,  
o Shelbues, \* te Rregjëria jote.

Për ndjesë të mëkatëve \* na  
Krikjen t'vum përpara \* çë ngl-  
akove për ne. \* Ti çë do mirë  
njerëzin.

Lëvdi...

Atin lëndërojëm, \* Birin adhuro-  
jëm, \* të gjithë edhe Shpirtin  
Shejt \* me besë imnojëm.

Nanë...

Falem, o thrn, fitërë-ziarri, falem  
o Nuse e panusërte, falem, o Vir-  
gjërë, ç'Perëndin për njerëzit  
linde.

## III

Kur shkeli, o Krisht, \* urdhuri-  
min t'ënt, \* shtërgjishin Adham  
\* nga Parraisi e përzëre; \* po  
Kusarin, o i lipisiar, \* e bëre të  
hij atje, \* kur mbi Krikjen të  
njohu tue thirrur: \* për mua ku-  
jtou, o Shelbues, te rregjëria  
jote.

Kur na mëkatruam \* Ti na dëno-  
 vë \* me mallkimin e morties,\*o  
 Gjellëdhënës e Zot,\* na dhe gje-  
 llë neve të vdekurë që thrresiëm:  
 \* Kujtoui edhe për ne\*te rregjë-  
 ria jote.

Lëvdi...

Atin edhe Birin,\* e Shpirtin  
 Shejt\*imnojëm,o të besmë,\* një  
 Perëndi,një Zot,\* si nga një  
 Diell;\*se ntrish-driçme ê Trinia,  
 \* e ndritson gjithë ata që thër-  
 resiën:\* kujtoui edhe për ne \*te  
 Rregjëria jote.

Nani...

Falemi,o dera e Perëndis,\*nga  
 e çila shkoi \* kur u bë njeri  
 Kriuesi \* tue ruajtur Tij të  
 pangarë;\* falemi,mjegullë e hol-  
 lë \* që na bie Krishtin,shi të  
 huinushëm;\* falemi,shkallë e  
 thron i kjiellëshëm;\* falemi,  
 mal i perëndeshëm,\* i majëmë,  
 i paprerë.

#### IV

Për një drû Adhami \* nga Par-



rajsi kle përzënë; \* po për drurin e Krikjes \* te Parraisi hiri Kusari. \* Se ai tue ngjepsur pemën \* urdhurimin shkeli të Kriussit; \* po ki i vunë bashk n'krikj, \* njohu Ferëndin të fshehur: \* kujtou për mua, tue thirrur, \* te Rregjëria jote.

O T ç'i vunë n'krikj, \* e çë fukjin e vdekjes sglidhe, \* e çë shuajte si Perëndi \* të shkruamen kundra nesh, o Zot, \* pëndimin e Kusarit, o Ti ç'i vetëm do njerëzit, \* jip neve ç'me besë t'lutëjëm, \* o Krisht o Ferëndia jinë, e t'theresiëm: \* kujtou edhe për ne \* te Rregjëria jote.

Lëvdi...

Me një mendje të gjithë \* po të lutëjëm, o të besmë, \* sa të lëvdojëm si na nget \* Atin, Birin e Shpirtin Shejt, \* të çilët në tre vetë \* janë një i vetëm Perëndi, \* njëësi e papërzieme \* e thjesht e pandarshme e pa-afuashme, \* për të çilën na shpëtonemi \* nga ziarri i Pisës.

Nani...

Mëmën t'ënde, o Krisht, \*çë prej Shpirtit Shejt të lindi \* e pas lindies vërtetani \* mbeti Virgjërë e dëlirë, \* Atë biem përpara Teje \* për ndërmietim, o Rrekgj mëshirplot, \*ndëjesen e mëkazëvet \* të japësh kurdoherë kuj tek Ti thërret: kujtou edhe për ne \* te Rregjëria jote.

V

Kusari mbi Krikjen \* tue besuar se Ti je Perëndi, o Krisht, të njo-hu \* me thjeshtësi nga thelpi i zëmbres, \* kujtou për mua, tue thirrur, o Zot, te Rregjëria jpte.

Me mortien t'ënde, o Krisht, \* fukjin e morties sglidhe \* e ngjalle bashk të vdekurit të motçëmë \* të çilët imnojën Tij, i vërtetë \* Perëndi e Shelbuesi jin.

Lëvdi...

Trini e pandarshme Njëësi, \* e gjithësis kriuese e tërëfukjishme, Ati edhe Biri \* e Shpirti Shejt, \*Tij imnojëm çë je i vër-

tetë \* Perëndi e Shelbuesi  
jinë.

Nani...

Falemi, o Faltore e shpirtë-  
suame \* të Perëndis, e derë e  
pashkuarshme; \* falemi, o Thron  
i padhezur e si ziarre; \* falemi,  
o Mëma e Emanuelit, \* Krishtit  
Perëndis t'ënë.

## VI

Kujtou për mua, o Perëndi,  
Shelbuesi jim, \* kur të veç  
te Rregjëria jote \* e shpëtomë,  
si i vetëmi që do njerëzin.

Për një dru Adhami kle gënji-  
er, \* për drurin e Krikjes pame-  
ta shpëtove \* Kusarin që thërr  
isëj: kujtou për mua, o Zot te  
Rregjëria jote.

Lëvdi...

Atin e Birin lavdërojëm \* edhe  
Shpirtin Shejt tue thënë: \* Shej-  
tia Trini \* shpëto shpirtrat  
t'anë. Nani....

O Ti që paj të Shpirtit Shejt,\*  
linde Krijuesin t'ent,\*o Virgjë-  
rë,shpëtò\* neve që të madhërojëm.

## VII

E búr'isht\*e e bukurë për të  
ngrënë \* pema që më pru mortien.  
\*Krishti ë druri i gjellës,\*se  
në hëngrësja nga ai ngë vdes;\*  
po thres bashk me Kusarin:\* ku-  
jtou për mua,o Zot\*te Rregjéria  
jote.

Mbi Krikjen \* lartësuar,o i li-  
pisiar,\*dorëshkrimin shkjorre \*  
të mëkatës s'vjetrë të Adhamit\*  
e shpëtove nga gënjimi \* gjithë  
jinit e njerëzëvet;\*andaj imno-  
jëm Tij,\*o Zot mirëbërës.

Lëvdi...

Dritë isht Ati,\*Dritë isht Biri  
e Fialë,\*Dritë isht Shpirti Shejt  
\*po të tria janë një Dritë,\* se  
një Perëndi isht në tre vetë \*  
e në një naturë e në të zënë fil-  
lë,\*i pandarshëm e i papërziem.

Nani...

Ti linde \* Birin e Fialë \* të  
 Atit në mish mbi dhet, \* si Ai  
 vet, o Mëma e Perëndis, e llo-  
 jasi; \* andai, o Virgjërë e Më-  
 më, \* të sivasurë me Perëndin  
 për Tij, \* na thrresiëm: të fa-  
 lemi, \* shpresa e të Krështe-  
 rëvet.

## VIII

Kujtoui për ne, o Krisht Shel-  
 buesi i jetës, \* si u kujtove \*  
 mbi Krikjen për Kusarin, e bën  
 na t'gjithëve t'mirë, o i ve-  
 tëm i lipisiar, \* për rregjërin  
 t'ënde të kjiellëshme.

Mirr vesh, o Adham, \* e gzou  
 bashk me Evën, \* se ai që ju  
 zveshi \* të dive kjëmoti \* e  
 që me gënjim ju bu shkleftë  
 të 'tij \* në Krikjen e Krishtit  
 kle shtipur.

Lëvdi...

O Trini e panisurë, \* klënie e  
 pandarshëme, \* Njëësi në një  
 thron, \* e bashknderuashme në  
 lëvdi, \* Naturë mbi të nisurat

e Rregjiti,\* shpëtò ata që me  
besë t'imnojën.

Nani...

Të falemi, o vent \* i gjerë i  
Perëndis,\*Të falemi, o arkë e Dhi-  
atës s're,\*Të falemi, shtamnë e  
artë nga e çila të gjithëve \*  
kle dhënë manna e kjiellëshme.

Zot, të falem me hare  
se për Tij u dijta gjallë;  
të të shërbenj si i Zot që je;  
të të kem besë e mall.  
Te kjò jetë të të bekonj,  
pran te kjielli të të trazhgnj.

Perëndi i lart'in'Zot  
bashkë me ne të jesh Ti sot,  
ku të rrim e ku të vemi,  
se po Tij për ndihmë kemi.  
Zot i lart e Perëndi,  
kijna të gjithëve lipisi ,  
e si të truhemi me besë,  
mos na le të biem në ftesë.

PARKALESI PËR TË VDEKURITË

Bekuar kloft i Madh'in Zot për herë, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Amin. Trisajon. (v.tek 1 fle.)

Se jotia isht regjëria, fukjia e lëvdia e Atit, e Birit e Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Amin. Troparietë

O Ti që me të me të thellë urtësie për njerëzit \* gjithëkjish zotëron, \* e nga njeriu i jep atë që i vlen, \* i vetmi Stisor, \* prëj, o i Madh'in'Zot, \* shpirtrat e shërbëtorëvet t'atë; \* se tek Ti vun ata shpresën e'tireve, \* tek Ti bëresi e krijuesi e Perëndia jinë.

Lëvdi...

Bashk me Shejtrat prëj, o Krisht, \* shpirtrat e shërbëtorëvet t'atë \* te ku ngë isht helm, \* jo lip, jo psherëtim, po gjellë e pasosme.

Nani...

Tij për mburonjë e pëstrim na kemi,  
 \* e fiala jote isht e pritur mirë  
 \* nga Perëndia që ngak Ti leu,\*o  
 Mëma e Perëndis e pa-nusërte,  
 shpëtimi i të besmëvet.

I - Të lumë të drejtisë për në  
 dhrom. Allilulia.

-I bekuar je, o Zot, mëspme Ti të  
 drejtat t'ote. Allilulia.

-Shpirti jim ka dishiruar me mall  
 \*gjikimet t'atë kurdoherë. Allilulia

-Shpirti jim kle kjëlluar nga hi  
 dhërimi; jipëm Ti fukji, o Zot,  
 mbas fialës. Allilulia.

-Uj zëmbren t'ime te dishirimet  
 t'atë e jo në lakmi. Allilulia.

-U i trëmbem fort të mëkatruamëvet  
 që harruan ligjën t'ënde. Allilulia

-U jam një nga ata që të trëmben  
 e e ruanj urdhurimet t'atë. Allil.

-Lëvdi...nani...Allilulia.

II - Duartë t'ote më bën e më gje-  
 shën; ëm ndëlgjim dhe urdhurimet  
 t'atë dot mësonjë.



Kij lipisi për shërbëtorët t'atë.

- Jiti jam u:shpëtom Ti, se vetëm të drejtat t'ote kam kërkuar.

- Jashta gjikimevet t'atë ngë kam dalë u, pse mua Ti më ke mësuar.

- Kij lipisi për mua. Allilua.

III - Ti mbaj siun t'ënt mbi mua e kijëm lipisi \* mbas gjikimet t'atire që duan mirë emberrin t'ënt. Allilua.

-Mirr vesh zërin t'im mbas lipisis s'ate, e mbas gjikimit t'ënt ëm gjellë, o Zot. Allilua.

-Shpirti jim kat rronjë, e kat t'lëvdonjë, gjikjimet t'atë ka t'më ndihën.

-U kam vatur tue rrahur si dele e sbierrë. Kërkò Ti shërbëtorin t'ënt, pse u ngë harronj urdhurimet t'atë.

E V L O J I T A R I A

I bekuar je, o Zot, mësomë Ti të drejtat t'ote.

-Shokjëria e Shejtravet \* gjeti burimin e gjellës \* edhe derën e Parraisit; gjetësja edhe u dhromin me pendimin; \* deleja \* e sbierrë u jam; \* thirrëmë, o Shelbues, e shpëtomë.

I bekuar...

- O ju çë kjenkji \* e Perëndis ligjiruatë, \* e çë kletë thertur si kjenkje \* e çë te gjella e pamblakëshme e pasosme \* o Shejtra kletë kallur, \* Atij pa u lodhurë, \* o Martra, ju të lutij \* të na ndëjenjë dëtëret t'ona.

I bekuar...

-O ju të gjithë \* çë muerët dhromin e ngusht \* e plot-mjerime të jeta; \* e çë krikjen si zigua e nglakuatë, \* e prapa meje jerdhët me besë, \* ejani të trazhgoni \* ata shpërblime e kurorët \* çë ju taksa në kjiell.

I bekuar...

-Fitira u jam \* të lëvdis s'ate të parrëfieshme, edhe në kam dserkjet e ftesavet; kij lipisi\* për të bëmën t'ënde, o Zot, e pastroje me dhëmbësirën t'ënde\* e ëm Atdheun të dishiruam \* e te Parraisi bëjmë pameta të vinjë.

I bekuar...

-Ti çë më gjeshe çë moti nga mos të klënitë \* e me fitirën t'ënde të perëndishme më nderove, \* e se shkela urdhurimin, përhapë te dheu më prore ngaha kleva marrë \* bën Ti të të glas pameta \* e të marrë bukurin e motçëme.

I bekuar...

-Prëji \* shërbëtorët t'atë, o Perëndi, e vëri në Parrais \* ku shokjëritë \* e shejtravet, o Zot e të drejtitë llambarisiën si dritarë; \* prej shërbëtorët të ndëjemitë \* e mos vërrej gjithë kekjëbëmat e'tire.

Lëvdi...

-Të trishkëlkjierit e të vetmes  
Hjyini \* le t'imnojëm tue thirrur:  
Shejt je Ti, o At i pa-zënë fill,\*  
o Biri bashkë i pa fillim e Shpirt  
i hjiyushëm;\* ndritësò neve,\*çë  
me besë të falemi prëmist,nga  
ziarri i përjetëshëm,shpëtona.

Nani...

-Të falemi, o e ndershme \* se Pe-  
rëndin njeri leve \*për shpëtimin  
të të gjithëve,\* se për Tij nje-  
rëzia \* gjeti shpëtimin;\* për Tij  
gjetëshim na Parraisin, o Mëma e  
Perëndis e bekuame dhe e kulluame.

Allilua. (3 herë) Lëvdi Tij, o  
Perëndi.

Klanj e vajtonj kur më vien në tru  
vdekia e shoh te varret bukurin  
e hjen e njeriut që kle gjeshur  
në fitirë të Perëndis, e nani të  
shëntuam, të pa-lëvdi, të pa-hje.

Ah! Që thamë! E që mister kle  
ki për ne? Përçë kat shkatarrone  
mi tue kalburë?

Vërteta kështu kle shkruar nga Perëndia, i çili prën ata që shkojnë te jatëra jetë.

L U M È R I T (v. fletën 52)

O Ti që je i Zoti i shpirtravet e i kurmëvet \* e që te dora jote mban gjellën t'ënë \* Ti që je ngushllimi i atireve që janë ndër helme, \* jipi prëhie te vendi i të drejtëvet \* shërbëtorëvet t'atë \* që ndërruan jetë.

Krisht ju dhëfshit prëhie në vent të të gjallëvet \* e ju sbillëshit diert e Parraisit, \* e ju pritëshit mirë te Kregjëria e 'Tij, \* e ju dhëfshit ndëjesën e mëkatëvet \* që bët te kjò jetë \* o të dashurit e Krishtit.

Lëvdi...

-Lëvdi Atij që ngë ka të zënë fill, \* që ngë ka të ler, \* që ngë njeri përpara vetëhes s' 'Tij \* Atin u proskjinis që lindin Birin, \* Birin u lëvdonj që u le

nga Ati,\* me Atin e me Birin u  
këndonj,\* të bashkëshkëlkjiemin  
Shpirtin Shejt.

Nani...

Si të buron sisa, o Virgjëreshë?  
Si tagjis Ti Atë që jep të ngrë-  
në gjithë jetës?\* Si e pa Ai që  
mënd'e buroi ujët nga guri \* për  
popullin e Tij i vdekur etiet \*  
ashtu si sgledhiëm te të Shkru-  
met shejte.

### APOSTOLOS

Shpirtrat e 'tire ka t'jesiën  
në të mira, o Zot.

Tij ka të thërres, o i Madh'in'  
Zot, Perëndia jëm.

-Piesë nga litra e S.Palit Thes.  
saloniçensëvet. (IV, 1218)

Vëllezër, ngë dua të jini të pa-  
dijtur mbi ata që u kjëlluan: mos  
vuhij në lip, ashtu si t'jerët që  
ngë kanë shpresën.

Përçë në na kemi besë se Isuthi  
vdikj e u ngall, kështu edhe Pe-  
rëndia dot marrënjë të ndëjemitë  
me atë për anë të Isuthit.

Përçë mbi Fialën e t'in'Zoti ju thomi:se na çë jemi lënë të gjallë njera çë vien in'Zot,ngë ka të vemi të përpiëkiëm Atë më para se ata çë u kjëlluan. Se in'Zot,mbas urdhurit e Arkëngjëllit me trumbetën e Perëndis,ka t'sdripet nga kjiellia e ata çë vdi-kjën në Krisht ka të ngjallen të parët. Pran na të gjallët çë kemi kjëndruarë,ka t'jemi rrëmbier bashkë me ata te mjekullat sa t'përesiëm t'ën'Zonë në erë e kështu do t'jemi gjithëmonë bashkë me t'ën'Zonë.

Prandai ngushllonij njeri me t'jatrën me këtë fialë.

Të lumë ata çë Ti ke sgledhur e çë ke pritur mirë,o Zot;ka t'rrinë te shpia jote.

E kujtimi itire bres pas brezi.

E sa të na bënj të mirë të gje-gjemi Vangjejin shejt,parkalesiëm t'ën'Zonë Perëndin t'ënë.

-Lipisi,lipisi,lipisi,o i Madh' in'Zot.

Dieja!Ngrëhemi shtuara të gjegje-  
mi Vangjejin shejt.Pakje të gji-  
thëve.

-Edhe shpirtit t'ënt.

Piesë të Vangjejit shejt si shkran  
Shën Jani.

-Lëvdi Tij,o i Madh'in'Zot,lëvdi  
Tij.

Gjegjemi!

In'Zot i tha Judhenjëvet që u  
kishën kjasur:me të vërtetë,me të  
vërtetë ju thomë se kush gjegjet  
fialën t'ime edhe ka besë tek Ai  
që më ka dërguar,ka gjellën e pa-  
sosme edhe ngë bie në gjikim,po  
nga mortia ka shkuar të gjella.

Me të vërtetë,me të vërtetë u  
ju thomë,se ka të vinjë hera e  
isht kjò nani,që të vdekurit ka  
të gjegjen zërin e t'Birit t-Pe-  
rëndis e ata që e gjegjen kat  
rrojën. Përse si Ati ka gjellë në  
vetëhe,kështu i dha edhe të Birit  
të ket gjellë në vetëhë.E i dha  
zotëri atij të bëj ligjë,se isht  
Bir njeriu.Mos famasij për këtë,



përse ka të vinjë një herë që gjithë ata që janë te varret kat gjegjen zërin e t' Birit të Perëndis e kat dajën ata që bën të mirë ndë të gjallur gjellie; por ata që bën të keq, ndë të ngjallur gjikimi. U ngë mëndë ngak u të bën gjë; ashtu si gjegjem u gjikonj; e gjikimi i jim isht i drejt, se u ngë kërkonj vullimin t'im, po vullimin e Tatës që më dërgoi.

-Lëvdi Tij, o i Madh' in' Zot,  
Lëvdi Tij. Për shumë vietë, o Zot.

Kijna lipisi, o Perëndi, për sa e madhe isht lipisia jote, na të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijna lipisi.

-Lipisi, lipisi, lipisi, o i Mad.

Parkalesiëm edhe për Episkopin t'ënë (...) e për gjithë vëllezërin t'ënë në Krisht.

Parkalesiëm edhe për ata të lumë e të paharruashëm që stisen këtë klishë shejtë e për gjithë prindrat e vëllezëritë

t'anë që vdiqjën me besën e që flën varrëzuar këtë e ku do ndodhen.

Se Ti je Perëndia i lipsis me njeriun që do mirë e na të japiëm lëvdi Tij: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

### TRISAJON

-Bashkë me Shpirtrat të drejtë e të mbaruarë prej shpirtrat e shërbëtorëvet t'atë, o Shelbues, e ruaj ata te jeta e lume që isht pranë Teje, Ti qëdo mirë njerëzin.

-Te prëhia jote, o Zot, te ku gjithë shejtrat t'atë prëhen, prej Ti edhe shpirtrat e shërbëtorëvet t'atë, se Ti vetëm je i ppavdekëshim.

Lëvdi...

-Ti je Perëndia jinë që u sdripe te Pisa, e që sglidhe dhëmbimet e të lidhurvet, prej Ti edhe shpirtrat e shërbëtorëvet t'atë, o Shelbues.

Nani...

-E vetmia e kulluame e e pangara Virgjëreshë, çë Perëndin paj të Shpirtit Shejt linde, ndërmet të sa të shpëtonen shpirtrat e shërbëtorëvet t'atë.

-Kijna lipisi, o i Madh'inë'Zot, paj të madhes lipisi s'ate, na të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijna lipisi.

Lipisi, o i Madh'in'Zot.

-Pameta parkalesiëm për prëhien e shpirtravet të të vdekurvet shërbëtorë të Perëndis (...), e sa t'i ndienen atireve gjithë ftesat të dashura e të padashura. \*Lipisi, oi Madh'in'Zot.

-Sa i Madh'in'Zot, Perëndia jinë t'i ja pënj vent shpirtravet të atireve te ku prëhen të drejtit; lipisit e Perëndis, rregjërin e kjielliavet e ndëjesën e mëkatëvet të atireve nga Krisht i padekëshim Rrekj e Perënia jinë lipëjëm.

Gjegjëna, o i Madh'in'Zot.

Parkalesiëm t'ën'Zonë.

-Lipisi, o i Madh'in'Zot.

O Perëndia i shpirttravet e i gjithë kurmevet, çë shkele mortien e munde e shtipe diallin e i dhe gjellë jetës s'ate; Ti, o i Madh' in'Zot, jip prëhie shpirttravet të të vdekurvet shërbëtorë t'atë... në vent të dritës, në vent të gzi- mit, në vent të dhrosis, te ku ngë isht dhëmbim, lip, e psherëtim; çëdo mëkatë çë'ata kanë bër me të fola, me të bëma, me tru, Ti çë je i mirë o Perëndi, e çë do mirë njerëzin, ndëjeja; se ngë isht njeri çë rron te jeta e ngë mëkatron, se Ti vetëm je i pamëkatë; drejtësia jote isht drejtësi për gjithëmpnë, e Fiala jote isht e vërteta:

se Ti je ngjallia, gjella e prëhia e shërbëtorëvet t'atë të vdekurë (...), o Krisht Perëndia jinë, e na Tij të japiëm lëvdi bashk me Atin t'ënt të pazënë fill e bashk me gjithëshejtin Shpirtin t'ënt, nani e për gjithëmonë e mbë jetë të jetëvet.

Amin.

-Jipi prëhie, o Zot, shpirtravet të të vdekurëvet të krësherë orthodoxë, në vent shejt e në horë të të drejtëvet, prit ata shpirtra, o Shelbues, e jipi prëhie.

(Në i vdekuri ë Prift thuhet):

-Të haristisiëm, o i Madh'in' Zot, përçë vetëm jiti isht të rruarut pa vdekje, përçë lëvdia jote isht e pandëlguashme, e dashuria jote për njeriun e parrëfieshme e rregjëria jote ngë i shkon njeriu e Ti ngë i merr anëh njeriu.

Ti urdhurove se, kur të mbarojën kjëroin e gjellës s'tire, gjithë njerëzit të vdesiën. Andai të parkalesiëm o Zot e i Zot, sa ki shërbëtor i jiti e vëllau i jinë, i çili na kle shokë te priftëria e pati besën t tek Ti e e rrëfiejti gjithëmonë e drejt dhe e pakjërtuashme e u kjëllua gjumi me shpresën e të ngjallurit e jetës të pasosme, të prëhet në gji të Abramit, të Isakut edhe të Jakobit.

Esi mbi dhe te Klisha jote e vure  
 Prift te shërbesa e shejte, kështu  
 la të marrënj pjesë te Theroria  
 s'hejte e kjiellit. Mbi njerëzit  
 Ti e stolise me një stoli shpir-  
 tulore, mbi Engjëjit e lëvdis s'ate  
 Ti përrite mirë i padënuam. Ti i  
 dhe lëvdi gjellës s'tij mbi dhe,  
 Ti nani bëj sa Ai të hinj e uje  
 në mes të Shejtavet t'atë tue e  
 nëmëruar shpirtin e 'Tij me gjith  
 ata që moti Tij pëlkjieshmë,  
 Se Ti je ngjallia.....

Te dita e gjithë të vdekurvet:

Edhe të lutemi për të lumen kuj-  
 tesë dhe të përjetëshmen prëhie  
 të gjithë të ndëjemëvet të krë-  
 shterë orthodoxë Rregjere, të Parë,  
 Patriarkëra, Jerarhë, Priftra, Jero-  
 kallogjerë, Diakrë, e Jerokiakrë,  
 Kallogjerë, e Kalogjëresha, Atëra,  
 Propatorë, Gjishëra, Shtërgjishëra,  
 që nga të parët njera te të spra-  
 smitë e sa t'i ndëjnenen atireve  
 gjithë ftesat të bëma tue dashur  
 e pa dashur.

---

Ditur! - Bekona, o Zot.

Ju bekoft Krishti Perëndia jinë  
i vërtetë nani.... -Amin.

Lëvdi Tij, o Perëndia jinë, shpre-  
e gjithë neve, lëvdi Tij.

-Lëvdi....nani...Bekona, o Zot.

Zoti Krisht, i ngjalluri së vde-  
kurish, i vërteti Perëndia jinë,  
paj të Povirgjërës e Shën Mëri e  
paj të Apostijvet të lëvdushëm e  
embërshtëkëlqierë e t'Atëravet t'  
anë të ndershmë e theoforë, vuf-  
shit në vent të të drejtëvet  
edhe shpirtrat e shërbëtorëvet  
t'atë që ngak na u ndajtën tue  
ndërruar jetë. I dhëfshit prëhie  
në gjë t'Abramit, i nëmërofshit  
ndër të drejtitë e neve pa paçit  
lipisi si i mirë e që njeriun  
do mirë. -Amin. -

Kloft kujtimi i'tire i përjetë-  
shëm. - Edhe ndëjeja, o Zot.

Ashtë kloft.

MBRËMËSORIA = VESPRO

Bekuar kloft Perëndia jinë kurë-  
doherë, nani e për gjithëmonë e për  
jetë të jetëvet. - amin -

Ejani t'i falemi e t'i përmisemi  
Mbretit t'ënë Perëndi.

Ejani t'i falemi e t'i përmisemi  
Krishtit Perëndi e Mbreti jinë.

Ejani t'i falemi e t'i përmisemi  
Atij vet, Krisht Mbret e Perëndia  
jinë.

(Ms. 103) Beko, Shpirti jim, t'ën!  
Zonë! O Zot, Perëndia i jim, sa je  
i Mathë!

Je veshur me nder e madhëri, i  
rrethuar nga një mënt dritie.

Dora jote shtron kjielliën si një  
tendë, e dërton dhomën t'ënde mbi  
ujërat.

Ti ke për kjerr mjekullat e jets  
mbi krahët e erës.

Ti je Ai që bën frima Engjëjite  
t'Tij e shërbëtorë t'Tij flaka  
ziarri.



Ai që stise jetën mbi themel-  
et e saj sa mos të tundet mot  
pas mōti.

Ti e pēshtrove me okjeanin si  
me një mēnt, e ujërat kjëndruan  
mbi malet.

Si kjërton, ata jikiēn; si gjē-  
gjen zërin e bubullimēs, ata  
shduken.

U hipën mbi malet e u sdripën  
mbi fushat në atë vent që Ti  
i dēftove.

I vure atireve një kufi që  
ngē ka të shkojēn; ngē ka të  
prirën prapa të pēshtrojēn dheun.

Ti që dērgon në përronje kronje,  
e ujërat do t' shkojēn në mes  
të malevet.

Potise gjithē shtazat e dhera-  
vet e gomarēt të egērē i shua-  
jēn etien e 'tire.

Ndē'ta zogat e kjielliēs bëjēn  
folet, ndër gurēt atō këndojēn.

Nga ndenja jote Ti i dērgon  
atireve shiun e ushkjenet dheu  
me pemēt e vepravet t'ote.

Ti Ai që bēn të rritet bari  
për shtazat e barishtet t'i  
shërbejēn njeriut.

Sa të ket bukën nga dheu e verën  
 që i gëzon zëmberën.

Vajët që i jep dritë fitirës s'tij  
 e bukën që fortëson zëmërën e  
 njeriut.

Ti ushkjen drunjet e fushës e dël-  
 linjat e Libanit që Ti mbolle.

Atië folen e'tire bëjën zogat;sa  
 për sterkun bredhat janë ndenja  
 e'tij.

Malet të lertë për dhitë të egë-  
 ra;gurët janë pështetie për  
 ljepuritë.

E bëre hënzën për të matur kjëroin  
 e dielli njeh herën e të perëndu-  
 arit t'tij.

Lëshon të më t'errëtitë e vien  
 naça,e gjithë shtazat të egëra  
 mbëjidhen ndë'ta.

Të vegjitë e luanëvet 'lurijën  
 për të rrëmbier,e Tij,o Perëndi,  
 lipiën ushkjimin e'tire.

Lehet dielli e ata ngulen e bien  
 e flënë te gavërat e'tire,

Atëherë del njeriu për punën e  
 'tij e në mundim t'tij njera,që  
 ngriset.

Sa janë të mëdha veprat t'ote,  
o i Madh'in'Zot,të gjitha i ke  
bër me dituri.

U mbëlua dheu me kriesat t'ote.  
Sa dejti isht i mathë edhe i  
gjerë.

Atie janë shtërpinjë pa numer;  
shtazë të vogla bashkë me të  
mëdha.

Atie shkojnë lundra;atie i vu-  
re të lozënjë edhe balenën.

Gjithë ata shpresojnë tek Ti  
t'i japësh ushkimin në kohë.

Kur Ti ja jep,ata e mbëjedhë-  
iën;kur Ti sbill dorën,të gji-  
thë tsiten me dhuratën t'ënde.

Kur Ti prier mbë nj'anë fakjen  
t'ënde,trazonen;i ndsier frimën  
e shuhen e priren te bota etire.

Po kur Ti dërgon Shpirtin  
t'ënt,prapë krionen,e përtërin  
fakjen e dheut.

Kloft lëvdia e t'in'Zoti për  
gjithëmonë;u gëzoft in'Zot te  
veprat e'Tij.

Ai çë si vërren dheun,ki dri-  
dhet:çë nget malet e këtë  
shtien kamnua.

Do t'i kënonjë t'in'Zoti për gjithë gjellën t'ime;do t'i msal Perëndis njera çë rronj.

Kloft këndimi i jim i mirëpritur nga Ai;u gjithëmonë do t'kërkonj gëzimin t'im tek in'Zot.

Le të shduken të mëkatruamitë nga fakjia e dheut,sa mos të jenë më të paligjë. Beko,o Shpirti jim t'ën'Zonë!

Dielli njuh herën e të humburit t'tij.Lë të më t'errëtitë e vien nata.

Sa janë të mëdha veprat t'ote, o i Madh'in'Zot,të gjitha i ke bër me dituri!

Lëvdi...nani...Aliluia(3) Lëvdi Tij,o Perëndi.O shpresa e gjithë neve,lëvdi Tij.

Zoti: Në pakje parkalesiëm t'ënë Zonë.

.....  
 Se Tij të nget nga lëvdi, nder e të përmissur:Atit,Birit e Shpirtit Shejt,nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet . Amin.

(Ms.140) O Zot,u të thërrita  
Tij,gjegjëm;gjegjëm,o Zot,u  
të thërrita Tij gjegjëm;vër're  
zërit e luties t'ime si u të  
thërres Tij.Gjegjëmë,o Zot.

Si livan le t'gjipet përpara  
Teje lutia jime;të ngrëjturit  
e duarvet t'ime flijë e mbrë-  
mëshme. Gjegjëmë,o Zot.

Vëj,o Zot,një ruajtje gojës  
t'ime e një derë rreth buzëvet  
t'ime.

Mos lësh zëmbren t'ime të lë-  
shonet të folave të kekjia;të  
të kërkonjë arsye për të mbro-  
jtur mëkatën t'ime.

Bashkë me njerëzit që bëjnë  
të kekjen,ngë dua të përzihem  
me të sgledhurit e 'tire.

Më kjërtoft njeriu i drejt me  
lipisi;po kurr lieshit kriet  
t'im vajtë e të mëkatruamit.

Se ende lutia jime i pëlqjen  
atireve;nëpër gurë klenë gor-  
romisur gjikëtarët t'tire.

Në janë të zotët,le t'gjegjen  
fialët t'ime.

Si grumbuj botie janë hapur për  
në dhe; ashtu klenë shprishur  
eshtrat t'anë për në varre.

Pse sit t'im janë gjithëmonë  
tek Ti; tek Ti isht shpresa jime.  
Mos le shpirtin t'im të shkret.

Ruajëmë nga kurthi që ngrëjtën  
për mua; e nga skëndajit e atire-  
ve që bëjën paligjësi.

Ka t'bien te rrieta e'tire të  
mekatruamitë vetë; u do t'kjëndro-  
një mbë nj'anë njera që shkonjë.

(Ms.141) Me zërin t'im u thërres  
t'ën'Zonë; me zërin t'im u i lutem.

Di t' ndenj përpara Atij parka-  
lesin t'ime; hjidhërimin t'im për-  
para Atij do të 'ftonjë.

Si vete tue më lipsur frima,  
atëherë Ti ruan dhromin t'im.

Te udha për të çilën u ka të  
shkonj, kanë fshehur kurthë për  
mua sa të bie.

Tek e drejta u veja tue vërrej-  
tur, e ngë gjeta njeri të më.

njihëj.

S'ka njeri me kë të jik e mos-  
njeri ka kujdes të më shpëtonj.

Tij të thërrita, o i Madh'in'  
Zot, u thash: Ti je shpresa jime  
në dhe të të gjallëvet.

Mirr veshë, o Zot, lutien t'ime,  
se u përvoja fort shumë.

Shpëtomë nga ata që më ndjek-  
iën, se ata janë më të fortë seu

Liromë nga fulakjia e shpirtit  
sa mëndë të lëvdonj embrin t'  
ënt.

10.....

Do t'më presiën të drejtisë  
njer që Ti ngë më ke shpëguar.

9.....

Nga vendet të humbët u të thë-  
rrita Tij, o i Madh'in'zot;  
gjekj zërin t'im.

8.....

Le veshët t'atë të marriën ve-  
shë zërin e luties t'ime.

7.....

Në Ti i vë're paligjësivët

t'ona, kush mënd't'kjëndronjë?  
vetëm tek Ti isht ndëjesë.

6.....

Paj t'embrit t'ënt të prita, o  
Zot, shpirti jim pret fialën të  
ënde, shpirti jim shpreson tek Ti.

5.....

Çë kur hën ndrtçullë në mëngjes  
njera çë ngriset; çë nga ruajtëja  
e menatës le të shpresonjë Israe-  
li tek in'Zot.

4.....

Se ka lipisi tek in'Zot e buri  
shpërblimi, Ai do t'shpërëlenjë  
Israelin nga gjithë paligjësitë  
e'tija.

3.....

Lëvdoni t'ën'Zonë, o ju kombe të  
gjithë, lavdëronie gjithë popujitë.

2.....

Se u shumëtua lipisia e'Tij mbi  
ne e vërteta e'Tij gjëndron për  
gjithë.

1.....

Lëvdi...nani....

**DIEJA! NGËHEMI SHTUARA!**



O Drita gazmore e lëvdis s'  
shejte të Atit të pavdekshëm,  
të kjiellit, të shejt e të lum  
Iisu' Krisht!

Posa arrum te hera ç'ishtë e  
humpë dielli e shohiëm dritën  
e mbrëmies, lëvdojëm Perëndin  
Atin e Birin e Shpirtin Shejt.

Pse të ka hje të jesh lëvduar  
në çëdo herë e me zërë të vë-  
jefshëm, o i Biri i Perëndis që  
jep gjellë.

Prandaj jeta të lëvdon!

Prokujmenon.

Tek e Shtunia mbrëma

In'zot ishtë krekj e vishet me  
nder të mathë.

In'Zot vishet e me fukji rreth-  
onet.

Se mban akjë fort gjithë jetën  
se ngë mëndë të tundet.

Tek e Diellia mbrëma

Bekoni nani ju të gjithë shër-  
bëtorë të t'in'Zoti t'ën'Zonë.

Ju çë rrini te shpia e t'in'Zo-  
TI, te oborret e shpis s'Tij.

Tek e hënia mbrëma

In'Zot do t'më gjegjet, kur u t'  
e thërres.

Kur të thërrita, Ti më gjegje,  
o Perëndi i drejtësis.

Tek e Martia mbrëma

Lipisia jote ngë më ka lënë  
gjithë ditët e gjellës t'ime.

Perëndia isht Delmeri jim; mua  
ngë ka më lipset gjë.

Tek e Mërkuria mbrëma

O i Madh'in'Zot paj t'embrit  
t'ënt shpëtomë e gjikomë me  
fukjin t'ënde.

O Perëndi, gjekjë parkalesin time

Tek e Intia mbrëma

Ndihma më vien mua nga in'Zot,  
çë bëri kjielliën e dheun.

Ngrëjta sit t'imë mbi malet  
ngaha ka t'më vinjë ndihma.

Tek e Prëmptia mbrëma

Perëndia isht mberonjësi jim;  
më para do t'më vinjë lipisia  
e'Tij.

Shpëtomë, o i Madh'in'Zot, nga  
armikjët.

### KATAXIOSON

Bën-na të mirë, o Zot, te kjo  
mbrëma të ruhemi na të pamëkatë.

I bekuar je, o Zot, Perëndia i  
Atëravet t'anë edhe embri jit  
isht i kënduar e i lavdëruar ne  
jetë të jetëvet. Amin.

Kloft, o Zot lipisia jote mbi  
ne, ashtu si kemi shpresuar  
tek Ti.

I bekuar je, o Zot, mësomë Ti  
të drejtat t'ote.

I bekuar je, o i Zoti, le t'nj-  
oh u të drejtat t'ote.

I bekuar je, o i Shejt, ndritë-  
më Ti me të drejtat t'otë.

O i Madh'in'Zot, lipisia jote  
isht për gjithëmonë; veprat e  
duarvet t'ote Ti mos harrò.

Tij të nget çëdo nderim, himn  
e lëvdi Atit, Birit e Shpirtit  
Shejt, nani e për gjithëmonë  
mbë jetë të jetëvet. Amin.

Z. Le të mbarojëm parkalesin e  
mbrëmies t'im'Zoti,

.....  
-Se Ti je Perëndi i mirë e çë do  
mirë gjithënjeri e na të japiëm  
lëvdi Tij: Atit, Birit e Shpirtit  
Shejt, nani e për gjithëmonë e  
për jetë të jetëvet.

P. Amin.

Z. Pakje të gjithëve.

P. edhe shpirtit t'ënt.

Z. Ujëni kriet t'ajë t'in'Zoti.

P. Tij, o i Madh'in'Zot.

Z. ....Kloft fukjia e rregjë-  
ris s'ate lëvduar e bekuarë: e  
Atit, e Birit edhe e Shpirtit  
Shejt, nani e për gjithëmonë e  
për jetë të jetëvet.

P. Amin

.....  
In'Zot rregjëron e vishet me nder  
të mathë

.....  
In'Zot vishet e me fukji rrethonet  
.....

Se mban akjë fort gjithë jetën se  
ngë mëndë të tundet.

Le nani, o i Zoti, shërbëtorin  
 t'ënt, sa të vë në pakje mbi fi-  
 alën t'ënde, pse e pan sit t'im  
 shëndetien t'ënde, që shtrove  
 përpara fakjes ë gjithë popu-  
 jëvet: dritë për të ndriturit  
 e kombëvet: lëvdi t'Israelit  
 popullit t'ënt.

TRISAJON! (v. te fleta e 2)

Z. Se jotia isht rregjëria, fukj-  
 ia e lëvdia: E Atit, e birit edhe  
 e Shpirtit Shejt, nani ë për  
 gjithëmonë e për jetë të jetëv-  
 et.

P. Amin.

Tropariet

Z. Dituri!

P. Bekona, o Zot .

Z. Ju bekoft Ai që ë gjithëmonë.

" Gjithë shejtia Mëma.....

P. Tij më të nderëshme.....

Z. Lëvdi Tij, o Perëndi,.....

P. Lëvdi...nani,..Bekona, o Zot.

Z. Zoti Krisht Perëndia jinë...

na paçit lipisi e na shpëtoft  
 si i mirë e që njeriun do mi-  
 rë.

Amin.

PARKALESI ÇË MËNDË THOMI  
MË PARË SË SA TË VEMI Ë FLËM:

O i Madh'in'Zot i gjithëmëndëm,  
 Perëndi i Atëravet t'anë, Perën-  
 di i Abramit, i Isakut, i Jakobit  
 e e fârës e bekuame e'tire, Ti  
 që bëre kjielliën e dheun me gji-  
 thë stolin e'tire; që kufizove  
 dejtën me fialën e urdhurit t'  
 ënt, që mbille abusin dhe e vufo-  
 se me embrin t'ënt të lëvduashëm  
 e të dreruashëm; përpara fukjis  
 t'ënde gjithkujsh trëmben e dri-  
 dhen se ngjë mëndë të fshihet  
 madhështia e lëvdis t'ënde dhe e  
 paduruashme ë mbëria e kanosies  
 t'ënde të mëkatruamëvet dhe e  
 pamasë dhe e pallojasma ë lipisia  
 e urdhurimevet t'atë.

Përçë Ti je një Zot i lart, i  
 mëshiruashëm, zëmbërëgjerë, i plot  
 me lipisi e u ke dishpëlkjier  
 për të kekjet e njerëzëvet. Ti  
 o i Madh'in'Zot, për sa e madhe  
 isht butësia jote, ke ligjëruar  
 pendes e ndëjesë për ata që të  
 mëkatruan e paj të përdiesavet  
 t'ote ke vënë pendesën për shpë-

timin e të mëkatruamëvet.

Andai T, o i Madh'in'Zot, Perëndi i fukjivet, ngë vure pendesë të drejtëvet Abram, Isak e Jakb që kundra Tij ngë mëkatruan, pom'e vure mua të mëkatruam pse u kam bër mëkatë më shumë se rëra e dejtë.

U shumësuan paligjësit t'ime e u ngë jam i mirë të ngrënjësit e të vërrenjë lartësin e kjielliës për shumëzën e mëkatëvet t'ime, i lidhur këbëshit më shumë vargje hekuri akjë sa ngë mëndë të tund kriet t'imë e për mua ngë ka ndëjesë përçë kam egërsuar mbrin t'ënde e bëra të ligën përpara Teje, pa mbaruar vullimin t'ënt, pa ruajtur urdhurimet t'atë.

Po nani u uj glurin e zëmbres t'ime tue u lutur butësis s'ate për mua. Mëkatrova, o i Madh'in'zot, mëkatrova e u i njoh paligjësit t'ime, po të lip tue parkalesur: Ndëjemë, o i Madh'in'Zot ndëjemë e mos më sbierësh për mëkatët t'ime e mos më keshë

mbri tue mbajtur gjithëmonë për,  
 para sivet të ligën t'ime; as më  
 dënò te fulakjit të nëndheshme;  
 përçë Ti je Perëndia, Perëndia e  
 atireve që pëndonen e mua do të  
 më 'ftosh gjithë mirësin t'ënde,  
 përçë paj të shumëvet lipisi  
 t'ote, megjithëse ngë jam i mirë  
 për shpëtim, Ti më shpëton e u ka  
 t't'lëvdonj përherë te gjithë di-  
 tët e gjellës t'ime.

Pse Tij të lëvdonj gjithë fukj-  
 it e kjielliës e jotia isht lëv-  
 dia për jetë të jetëvet. Amin.

---

O Ti që në çëdo kjërò e herë jë  
 i përmisur e i lëvduar në kjiell  
 e në dhë, o Krisht Perëndia jinë,  
 shumë i lipisiar, i mirë e i zëm-  
 bërënjomë; Ti që do mirë të drej-  
 tit e ke lipisi për të mëkatrua-  
 mit, Ti që thërret gjithënjeri të  
 shpëtonen tue taksur të mirat të  
 ardhëshme, Ti, o i Madh'in'Zot,  
 prit mirë këtë parkalesi t'ona  
 te kjo herë e ndrekjë gjellën  
 t'ënë si duan urdhurimet t'atë:



Shejtëro shpirtat t'anë, pastro  
 na kurmet, ndritëna mendien, ndr-  
 ekjë kjëllimet t'anë e lirona  
 nga çë do helme, të kekje e dhë-  
 bëje; rethona pra me shejtit  
 Engjëjë t'atë, sa kështu të rua-  
 jtur dhe të udhëhelkjur nga ata  
 të bashkuar te njënia e besës  
 të vemi të përpiekëjëm të pa-  
 kjaseshmen lëvdi t'ënde, përçë  
 Ti je i bekuar për jetë të je-  
 tëvet. Amin.

---

Bekuar Ti je, o i Madh'in'Zot,  
 çë ndrit ditën e dritën e die-  
 llit e natën e gëzon me të sh-  
 këlkjierit e ziarrit; çë na bëre  
 të mirë të shkojëm për gjithë  
 ditën e tërë e t'arrëjëm te të  
 zënit e natës, kjekj parkalesin  
 t'ënë e të gjithë popullit  
 t'ënt e tue ndëjer gjithë neve  
 ftesat të bëma tue dashur e pa  
 dashur, për it mirë lutiet t'ona  
 të mbrëmëshme e dërgo kjosmët  
 e lipisis s'ate e të përdiesavet  
 t'ote mbi trazhimin t'ënt;

rrethona me Ëngjëjitë t'atë të shejtë; pështrona me armët e drejtësis t'ënde;mbana te dhromet e Vërteties;mbrona me fukjin t'ënde, ruajna nga çëdo kekjëndodhie e çëdo sulm t'armikut. Ëna sa kjo mbrëma me natën çë kjaset e me gjithë ditët e gjellës t'ënë të jetë e mbaruame,më se më,e mirë, e shejte,me pakje,e pamëkatë,pa skëdall,pa fantasi e kekjie,paj të shejtës Mëmë të t'in'Zoti e të gjithë shejtravet çë moti Tij pëlkjeshmë.Amin.

---

Zot i mathë u bie të flë,  
e ngë di në u ngrëfsha më;  
shpirtin t'im u Tij t'e lë.(2 h.)

Jam e ngulem te ki shtrat  
e më ruan in'Zot si At.  
Po në vdeksha te kjo natë,  
falmë,o Zot,çëdo mëkatë.

Ëm uratën,Zoti Krisht;  
ëm uratën,o Mëri;  
Ti bekomë,o Perëndi.(2 h.)

ANTIFONËT TË FESTAVET TË MËDHA.

Ditën 8 të Shtatorit: Të lerit  
e Shën Mëris.

I

I - Kujtò, o i Madh' in' Zot, Davidhin e gjithë butësin e 'tij.

-Për parkalesitë.....

- Lëvdi...nani.....

II-Bëri be in'Zot Davidhit mbi të vërtetën; e do t' mbanjë ben e 'tij.

-Shpëtona, o i Biri i Perëndis, i famasëshëm ndër Shej...

-Lëvdi...nani...O i vetmi...

III-Këtu do t'jes se më ka pëlqier vendi.

-Të Lerit t'at, o Mëma e Perëndis, gzim \* përhapí në tërë jetën; \* se ngak Ti shkrepí Dielli \* i drejtësis, Krishti Perëndia jinë; \* e tue sglidhur nëmën, \* dha bekimin, \* e tue prishur vdekjen, \* na dh uroin gjellën e pasosme.

Kont. - Me të lerit t'atë, o e pa-  
përlieme, u liruana Jakini e Ana  
nga turpi i shtërpëris e Adhami  
e Eva nga prishëria e mortie.

Populli jit e kremton se kle li-  
ruar nga ftesa e mëkatëvet. E  
shterpa lind Mëmën e Perëndis e  
Atë që ushkjen gjellën t'ënë.

Në vend të Axion estin:

Një gjë e huaj për mëmat ë vir-  
gjëria; e pa njohurë nga virgjëre-  
shat birlindia!

Tek Ti, Mëm'e t'in'Zoti të dia  
u përzien.

Andai na gjithë jinit e jetës,  
pa sosur, t'lumërojëm.

Kjinonikon.

Kjekjin e shëndeties u dua të  
marr; e embrin e t'in'Zoti u dua  
të thërres. Allilulia. (3 herë)

Ditën 14 të Sh tatorit  
Lartësimi i Shejtes Krikje.

Ant. I-O Perëndi, Perëndia jim,  
gjegjëm, përse më lë?  
-Për parkalesitë....

-Lëvdi...nani...

II-Perçë, o Perëndi, na ke mbajtur llargu Teje për gjithëmonë.

-Shpëtona, o i Biri i Perëndis, o Ti që në kurm kleve vunë ngrikj, neve.....

-Lëvdi...nani...o i vetmi...

III-Perëndia, Rregji jinë, që mot e jetë ka prur shëndetë në mes të dheut.

Apol.: Shpëtò, o Zot, popullin të ënt \* e beko trazhgimin t'ënt, \* bën të mujën të besmit \* mbi të mahkuamin, \* e me Krikjen t'ënde \* ruaj Ti Klishën t'ënde.

TE HIRIA: Lartësoni t'ën'Zonë Perëndin t'ënë e përmisij nën këmbies e këmbëvet t'Tij, se Ai isht Shejt. Shpëtona, o i Biri...

Kond.: O i lartësuar në krikje tue dashur, \* rregjëris s're që ka embrin t'ënt \* lipisit t'ote dhuroi Ti, o Krisht Perëndi; \* dëfrë me fukjin t'ënde \* të besmit kjiverritarë t'anë, tue dhënë atireve mundësi kundra

armikjëvet; \*patçin ata ndihmën  
t'ënde, si armë pakjëje, \* trofë  
të pamundur.

Në vent të Shejt Perëndi thuhet:

-Krikjen t'ënde proskjinisiëm,  
o i Madh'in'Zot, e Ngjallien  
t'ënde të shejte lëvdojëm. (3 h.)

Në vent të "Axion estin..."

Ti, o Mëme e t'in'Zoti je një  
lulishte mistike që pa klënë pu-  
nuar ka dhënë Krishtin paj të çil-  
lit kle vënë në dhe druri gjallë-  
sor i Krikjes, të çilin, sot lartë-  
sojëm, e tue proskjinisur na lëv-  
dojëm Tij.

Kjinonnikon:

U dëftua mbi ne, o i Madh'in'Zot,  
drita e fakjes s'ate. Allilulia. 3h

Ditën 26 të tetorit

Shën Miçri Deshmor i Mathë

Apol.: Përluftar të math \* ndër  
rrëzikje \* të ka gjetur \* gjithë  
jeta, \* o Athlofor, që paganët ke-  
mundur. \* Si andai shkele Krielr-

tësin e Lieut,\* e te stadhi i  
dhe zëmbër Nestorit,\* ashtu, o  
Shën Mitre Deshmor i Mathë,\*  
Krishtit Perëndi-lutu \* tëna  
dhuronjë të madhen lipisi.

Kond.: Me burimin e gjakut të  
ënt, o i Shën Mitër, Klishën  
stolisi më të Kukj Perëndia,  
Ai çë të dha fukji të pamun-  
dëshme, e çë ruan Horën t'ënde  
nga rrëzikjet; se. Ti je ndihma  
e asaj.

Kjinon.: Në kujtim të pasosmë  
ka të jet i drejti. Allilulia.

Ditën 21 të Nëndorit  
Të hijturit e Shën Mëris në  
Faltore.

Ant. I-I Math isht' in' Zot, te  
kjiteti i Perëndis t'ënë,  
te mali shejt t'Tij.

" II-Shejtëroi tendën e'Tij  
i Larti Perëndi.

"III-Përpara fakjes s'ate ka  
t'ujëjën Kriet të Kjosmit e  
popullit.

Sot na parathuhet pëlqjimi i t' in'Zoti e na paralaçitet shpëtimi i njerëzëvet. Te Faltoria e t'in'Zoti Virgjëresha na ftonet e gjithëve na paralajmëron Krishtin. Asaj me zër të mathë t'i thomi na: Falemi, o Ti që je mbarimi i urdhurimit të Stiscrit.

Kont.: Më e pastruara Faltore e Shelbuesit, \* shum'e shtrëjta nusërore e Virgjëreshë, \* shejti thesar i lëvdisë së Perëndisë \* sot ishtë kallur \* në shpi t't'in'Zoti, \* tue bashkëllitur Hirin \* e Shpirtit të huinushëm; \* atë që përinnojën Engjëjrit e Perëndisë: \* kjo ishtë tenda e kjiellëshme.

Kjinon.: Kjelkjin e shëndeties...

Ditën 6 të Dhjetorit

Shën Kolli.

Apol.: Paskjirë besie \* e shembullbutësie, \* mësonjës përkorie \* të dëftoi vathit t'ent \* e vërteta e pënëvet; \* përandai Ti patë \* me përunjësin të lartat, \* me vapkësin kjosmët, \* o At Krieprift Shën



Koll:\* lut Ti Krishtin Perëndi, të shpëtonen shpirtrat t'anë.

Kont.: Në Mirë, o Shejt, u dëftove si Prift, pse i Krishtit tue mbaruar Vangjejin, vure gjellën t'ënde për popullin t'ënt, e shpëtove të pafajshmitë nga mortia. Prandaj u shejtërove si njohësi i math i Hirit të Krishtit.

Ditën 9 të Dhjetorit  
Të Zënit e Shën ' Anës

Apol.: Sot sglidhen lidhiet e shtërpëris se in'Zot gjegjet Jakinin e Anën e, kundra çëdo shpresie të leri, atireve i taks një vajzë e hjieshme. Nga kjo leu i Papërshekruashmi bër njeri. Prandaj për anë të Engjëllit urdhuroi t'i thëshëjën. Asaj: "T'falemi, o e Hir-plota, in'Zot ë me Tij."

Kont.: Sot jeta kremton \* të Zënit e Shejtes Aën \* çë kle nga in'Zot. \*Pse nga kjo leu \* Ajò çë me viershë i pangëlguashëm, lindi Fialën.

Ditën 13 të Dhietorit  
Shejtia Lluçi.

Apol.:Kjenkja jote,o Isuth,\*Tij të thot me zër të math:\*Tij,o Dhëndërri jim,u dishironj,\*e tue kërkuar Tij u luftonj,\*e bashk n' krikj bashk varrëzonem\*me pagëzimin t'ënt;\*e duronj për Tij,\* sa t'rregjëronj me'Tij,\*e vdes për Tij,\*sa të rronj tek Ti;\*po këtë flijë t'dëlirë\*çë për Tij isht thertur prit mirë.\*Për lutiet e 'saja,\*si i lipislar,\*shpëto shpitrtrat t'anë.

Kont.:Si nuse e lëvduashme e Krishtit Rrekj,Deshmore e pamundëshme e Virgjërë e ponisëshme,o Shejtia Lluçi,Ti fitove një lëvdi e pasosme dhe e hjynushme.Me parkalesitë t'ote kijna ndëjesën e mëkatëvet neve çë me mall të nderojëm kujtimin.

Ditën 20 të Dhietorit  
Parakremptia e Krisht-lindjes.

Përgatitu Vithlëm, sbillet gjithëve Edhemi. Stolisu Efrathà, se druri i gjellës të shpella lulëzoi nga Virgjëra. Pse Parra- is' gjiri i 'Saj u 'ftua shpirtu- lor tëku pema e hjynushmë nga e çila tue ngrënë rrojëm; ngë do të vdesiëm si Adhemi. Krisht lehet atë më parë e rarë sa të ngjallënjë fitirë.

Kont.: Virgjëresha sot\* në shpel- lë vien\* për lindien\* e pathënë- shme\* të t'paramotëshmes Fialë.\* Bën harë,\* o jëta e gjithë, ashtu si e gjegjë;\* lavdëro\* bashkë me Engjëjit\* e me delmerët\* të para- motëshin Perëndi,\* çë deshi t'ish par\* si Dialë i ri.

### DITËN 25 TË DHJETORIT

Të Lerit e t'in'Zoti I. Krishti

Ant. I - Dua të t' lëvdonjë, o i Madh' in'Zot, me gjithë zë- mbrën t'ime; dua të rrëfi- enjë të gjitha famasmët t'ote.

-Për parkalesitë....

-Lëvdi...nani...

II -I lumë njeriu ç'i trëmbet t'  
in'Zoti, e që ja k'ënda shumë  
te urdhurimetë e Tij.

-Shpëtona, o i Biri i Perëndis,  
i ler nga Virgjëresha, neve,  
çë të këndojm: Alliluia.

-Lëvdi...nani...Oi vetmi...

III-In'Zot i tha Zotit t'im:uju  
tek e drejta jime njer çë të  
vu armikjët t'atë nën këmbëvet  
t'otë.

-Të lerit t'atë, o Krisht Perë-  
ndia jinë, jerdhi e shkrepit në  
jetë dritën e dituris; se për  
atë adhuresit e izëvet nga  
një ill klenë mësuar të adhu-  
rojnë Tij si dielli i drejtë-  
sis e të të njihen së larti  
si Lindie, o Zot, lëvdi Tij.

### ISODHOS

Nga gjiri jim më para se illi  
menatës U të leva. Bëri bë in'Zot  
e ngë do të ket pendim: Si je

Prift për gjithëmonë i rradhës  
s'Melkjisedhekt:Shpëtona, o i  
Biri i Perëndis,.....(\*)

NË vent të Shejt Perëndi:

Oh! Sa në Krisht u pagëzuatë,  
me Krishtin u veshët.Allilulia

Në vent të Axion eshtin:

Madhëro, o Shpirti jim,.....

Kjinon.:Shëndetë i dërgoi in'  
Zot popullit e'tij.  
Allilulia.

Në vent të "Embri i t'in'Zoti:

Shi ,lehet Krishti:lëvdonie;\*  
shi,vien ka kjiellia:ju t'e  
pritëni;\*shi,Krishti mbi dhet:  
ju ngrëhuni;\* Zotit po t'i kë-  
ndonj,jata e gjithë,\* edhe ndë  
gëzime \* zëni kënka,popuj ju,\*  
se u lavdërua Ai.

---

(\*) Kont.:Virgjëresha sot \*të  
përbiklënëshim lint,\* e dheu  
shpellën \* të pa-arrënëshëmit  
dhuron.\* Engjëjit \* me Delme-  
rët lavdërojnë;\*Magjinjët pra

bashkë me illin udhëtojnë; \* se për ne jerdh'e lindi,\* si Djalë i ri,\* i paramotëshëmi Perëndi.

Tek e DIELLIA pas Krishtlindies  
kujtonet Shejti Zef.

Apol.: Thuaji me gëzim, o Shejti Zef, Davidit Shtërgjishit të Perëndis famasmët: Ti pe një Virgjërë Mëmë, lavdërove me Delmerët, proskjinise me Magjinjët, si nga Engjëlli pate thënë n'ëndërrë. Lutu Krishtit Perëndi sa t'shpëtonjë shpirtrat t'anë.

Kont.: Gzim të math sot ka i hynushmi David, e Shejti Zef lëvdi jep bashk me Jakobin; se tue marrë kurorën e gjëris s'Krishtit ata bëjnë harë, e atë që jerdri në dhe, me lindie të parrëfieshme lavdërojnë tue thënë: o i lipisiar, shpëtò ata që të nderojën.

Ditën e parë të Jinarit

Rrethëpresia e Zotit Krisht

E Shën Vasiji i Math.

Ant. I -Ngrëni zërin të lëvdoni  
t'ën'Zonë, o gjithë dheu.

-Për parkalesitë....

-Lëvdi...nani.....

" II -U gëzofshin kjielliat  
e bëft harë dheu.

-Shpëtona....Ti çë te  
misht kleve i rrethëprer,

-Lëvdi...nani...O i vetmi.

" III-Lipisit t'ote, o i Madh'  
in'Zot, u dua të këndonjë  
për gjithëmonë.

Fitirë njeriu\*pa u ndërruar mo-  
re\*Ti çë je Perëndi në klënie\*  
o Zot shumë i Lipisiar;\*e tue  
mbaruar ligjën, rrethëpresien\*  
deshe të riejë në kurm,\*sa të  
shprisie errësiat,\*e të ndsi-  
rie pështrimin e pesimevet t'  
anë.\*Lëvdi mirësis s'ate, lëvdi  
lipisis s'ate, lëvdi të parrë-  
fieshmes, o Fialë, zëmbrenjomë-  
sis s'ate.

I-Zoti i gjithësis duron rrethpresien e i mirë si ë pret mëkatët e njerëzëvet. Edhe bënë hare Ai që isht i Stisorit Jerarhë e dritarë i hjynushëm i hijtur te Misteret e Krishtit, Vasiji.

Në vent të axion estin

† Mbi Tij gzonet, \* o e Hir-plota, jeta e tërë, = mbëjedhia e Engjëjvet, \* e jinit e njerëzëvet, \* o Faltore e shejtëruame, e Parrais i mentëshëm, \* i Virgjëreshavet lëvdim, \* nga e çila in'Zot mori kurm \* e u bë Djalë, \* Ai që isht i paramotëshmi Perëndia jinë.

Se brëndà Teje \* vuri thronin e Tij, \* e gjirin t'ënt \* e bëri më të gjerë se kjielliat; Mbi Tij gzonet, \* o e Hir-plota, jeta e tërë: \* lëvdi Tij.

KJINON: Lëvdoni t'ën! Zonë nga...

---

Ditën 6 të Jinarit

DITA E UJIT TË PAGËZUAM!



Ant.I -Kur Israeli dolli nga Egjipti e të bijët e Jakobit ngë gjejën më gluhë të huaja, in'Zot mori Judhen për faltore e'Tij e Israelin për zotëri e'Tij.

-Për parkalesitë....

" II -U dua mirë t'ën'Zonë, se Ai ka t'gjegjet zërin e luties t'ime.

-Shpëtona, o i Biri i Perëndis, Ti që kleve pagëzuar nga Jani në Jordhan,.....

" III-Lartësoni t'ën'Zonë se isht i mirë, se e pasosme isht lipisia e'Tij.

Në Jordhan, kur pagëzuar kleve, o i Madh'in'Zot, u dëftua lutia e Trinis, se zëri i Prindit të bë martiri Tij, tue thërritur Tij: BIRI JIM I DASHURI e Shpirti i Shejt në fitirë pallumbi fortësoi vërtetësin e fialës. O Krisht që u dëftove Perëndi e që dritën i dhe jetës, lëvdi Tij.

ISODHOS: -I bekuar kush vien në embër të t'in'Zoti; Perëndia Zoti, e na u dëftua neve. Shpëtona, .....

Apol.: Në Jordhan.....

Kont.: U dëftove sot \* gjithë jetës, \* edhe drita jote, o Zot, \* u shënua mbi ne, \* që me ndëlgim të imnojëm; \* jerdhe, u duke, \* o Drita e pa-arrënëshme,

Në vent të "Shëjt Perëndi, .."

OH! Sa në krisht u pagëzuar, ...

Në vent të "Axion estin..."

-Madhëro, o shpirti jim, më të ndëroshmen e më të lëvdoshmen se gjithë Ushtrit e Kjiellit.

-Madhëro, o shpirti jim, Atë që jerdhi në Jordhan sa t'ish pagëzuar.

-Sot Sh'Njanji pagëzon t'en'Zonë në ujërat e Jordhanit.

-Sot i Madh'in'Zot uj krijt nën dorës të Prodhromit.

-Madhëro, o shpirti jim, pushtetit e të të pandarëshmes në tre Vetë Hjyni.

-Madhëro, o shpirti jim, Shën Mërin që na liroi nga nëma e parë.

Kjinon. :- Na u dëftua Hiri i Perëndis për shëndetë të gjithë njerëzëvet. -Alliluia. -

Ditën 17 të jinarit.

Shën Gjoni i Mathë.

Apol. : Tue i glar në zell Elis \* e në gjithë gjellën t'ënde, \* tue vatur prapa Shën Janit Pagzor \* ndër dhromet e drejtë, o Ati Shën Gjon, deshe t'rrije në shkretirë, \* e fortësove jetën me parkalesit t'ote; \* andaj lutu Krishtit Perëndi, \* të shpëtonen shpirtrat t'anë.

Kont. : Tue përbuzur zhumat e jetës, mbarovë gjellën në shkretirë tue i glar te gjithkujsh Pagzorit; bashk me atë na të nderojëm Tij, o Shën Gjon, At i prindravet t'anë.

Ditën 2 të Shkurtit. Të përpi-  
ekurit e Zotit t'ënë I. Krisht.

Ant. I -Zëmbra jime buron një  
fialë e mitë.

-Për parkalesitë....

-Lëvdi...nani...

" II -Lith shpatën t'ënde  
rreth ijës s'ate.

-Shpëtona...o Ti që kleve  
kjellur më duarë nga i  
drejti Simeon,neve që....

-Lëvdi...nani...O i Vetmi..

" III-Gjekj,o bijë,e vërrej,e  
prir veshin t'ënt,e harrë  
popullin t'ënt e shpin e  
t'it eti e Rregji do të  
dishironj bukurin t'ënde.

Apol.:Gzou,o e Hirplota,\* Mëm'e  
Perëndis Virgjëreshë:\*se ngak Ti  
leu \* Dielli i drejtësis,\*Krishti  
Perëndia jinë,që ndrit ata që  
ndodhen në t'errët.\*Bën harë edhe  
Ti,\*o Plak i drejt,që në krahë  
liruesin e shpirtravet t'anë,\*që  
jep neve \* edhe ngjallien.

ISODHOS:Bëri të njohur in'Zot  
shpëtimin e'Tij përpara gjindevet,  
shpëtona,.....

Kont. O Ti që një gji virgjëror\*  
shejtërove me të Lerit t'atë,\*  
e duart e Simeonit\*bekove, si  
kjish -hje,\*arrure edhe nani\*e  
shpëtove neve,\*o Krisht Perëndi,  
\*po pakjësò shtetin ndër lufta,  
edhe fortësò \* Rregjërat që kë  
dashur,\*o i vetmi që do mirë  
njerëzit.

Në vent të Axion estin..."

-O Mëma e t'in'Zoti shpresa e  
gjithë të krështerëvet,pështrò,  
ruaj gjithë ata që shpresojën  
tek Ti. -Na te hjeja e të shku-  
ames s'ligjës që urdhuron " që-  
do dialë që del nga gjiri i s'  
jëmës kat jet falur t'in'Zoti "  
shohiëm një fitirë. -Andai na  
madhërojëm të Paralindurin e të  
pazënit At,FIALËN,që bënëti i  
Parilinduri i njëi Mëmie Virgj-  
erë.

Kjinon.: 'Kjelkjin e shëndëties..

DITËN 25 TË MARSIT

Lajmërimi Zonjës Mëmë e t'in'Zoti,

Ant.I-O Perëndi, jip' gjikimin t'ënt  
rregjit e drejtësin t'ënde të  
birit e rregjit.

-Për parkalesitë...

-Lëvdi...nani.....

" II-Ka t'sdripet si shi mbi t  
leshët e si pikë uji që kullon  
mbi dheun.

-Shpëtona.....o Ti që nga një  
Virgjërë more kurm,neve.....

-Lëvdi...nani...O i Vetmi...

"III-Ka t'jet bekuar embri i'Tij  
për gjithëmonë.

Apol.:-Sot zë fill shpëtimi jinë,\*  
e dëftonët Misteri i përjetëshëm,\*  
i Biri i Perëndis \* bënet Bir'Vir-  
gjërëshës,\*e Gavriilli Hirin laj-  
mëron.\*Andai bashk me atë Mëmës  
s'Perëndis thomëji:\* Falem,o e  
Hirplota,\*in'Zot ishtë me Tij.

ISODHOS:Lajmëroni ditë për ditë  
shpëtimin e Perëndis t'ënë.Shpë...

Kont.:-Tij,o Kaptenjë luftare,kë-  
ka t'mundëjes,\* se më lirove prej

këkjish të fala nderëjes \*u  
 ngreh po Tij, Kjiteti jit, Em'e  
 t'Lartit. \*Pran, tue pasur Ti pu-  
 shtetin e pamundëshim, \*po shpë-  
 tomë Ti përherë prej rrëzikjëvet  
 \*të thërres tek Ti: \*Të falem, Nu-  
 se po Virgjërë.

N.V. të Axion estin

-O dhe, lajmërò gzimin të mathë,  
 këndon, kjiëj, lëvdin e Perëndis.  
 Dorë malnjohie mos të ngasënjë  
 Faltoren e gjallë Arkën e t'in'  
 Zoti! Po buzët e të besmëvet le  
 t'këndojnë pa pushim Mëmës e t'  
 in'Zoti me hare të falurit e  
 Engjëllit e të thërresiëm: Të fa-  
 lëmi, o e Hirplota, in'Zot ë meTij.

Kjinon: Sglodhi in'Zot Sionin e  
 e dishiroi për shpi t'Tij. Allil.

Ditën 24 të Kjërrshorit  
Të Lerit e Shën'Janit.

Apol:-Profet e Prodhrom \* i të  
 jardhrit t'Krishtit, \*na ngë je-  
 mi të mirë \* të t'madhështojëm  
 si nget \* na çë me dishirim të

nderojëm; \* e pafëmijësia e s'at'ëmë  
 \* e pagojësia e prindit t'ënt \*  
 klenë sglidhurë me të Lerib t'atë  
 \* të lëvdoshëm e të nderoshëm, \* e  
 gjithë jetës vien ligjëruar \* të  
 njerëzuarit, e të Birit t'Perëndis.

Cont.: -Ajo ç'ish pafëmijë \* sot \*  
 lint Prodhromin e Krishtit, \* e ai  
 vet isht plotësimi \* i gjithë pro-  
 fetsivet; \* se ai \* në Jordhan \*  
 tue vunë duart \* mbi kriet e Atij \*  
 çë ligjëruan më para \* gjithë pro-  
 fetrat, \* u dëftua Profet e Ligjë-  
 rues \* e me me një herë Prodhrom \*  
 i Perëndis Fialë.

---

Ditën 29 të Kjërrshorit  
 S. Pitri e S. Pali.

Apol.: -O Parathronësit e Apostoj-  
 vet, \* e Mësonjësit e gjithë jetës,  
 \* lutëni ju t'Madh'in'Zot të t'gji-  
 thëve \* sa t'i dhuronjë pakjen  
 jetës, \* e shpirtravet t'anë të  
 madhen lipisi.

Kont.: -Ligjëronjësit të pagabuesh-  
 ëmë \* e t'frimëzuarë nga in'Zot, \*



Korifeun \* e Apostojvet, o Zot, \* i ke priturë në trashgim \* të të miravet, t'ote e në prëhie; \* se mundimet e mortia e'tire \* të kanë pëlqier më mirë se çëdo dhuretë, \* o Ti çë i vetëm njeh brëndësin e zëmbra vet.

Ditën 6 të Gushtit

Shpërfitirimi i t'in'Zoti I.K.

Ant.: 'I Mathë isht in'Zot e i lëvduashëm shumë te mali shejt i 'Tij.

-Për parkalesitë:....

-Lëvdi...nani...për park..

" II-Themelet e 'Tij në malet të shejtë.

-Shpëtona,...., o Ti çë te mali i Thavorit u shpërfitirove, neve çë të këndonj.

-Lëvdi...nani...O i vetmi..

"III-Lipisit t'ote, o i Madh'in'Zot, ka t'këndonjë për gjith monë.

Apol.: -U shpërfitirove te mali,

o Krisht Perëndi,\* tue dëftuar  
dishipujvet t'atë lëvdin t'ënde,\*  
ashtu si mëndë.\* Shkrepe mbi ne  
të mëkatruamë \* dritën t'ënde të  
përjetëshme \* me lutiet e Mëmës  
s'Perëndis.\*O Dritëdhënës,lëvdiTij.

ISODHOS: Thabori dhe Ermani do t'  
gzonen më embrin t'ënt.Shpëtona...

Kont.:Mbi malin u shpërfitirove,\*  
e,për sa mëndë,dishipujëvet t'atë,  
\* o Krisht Perëndi,\*pan lëvdin t'  
ënde;\*sa,kur Të të shohiën \* vunë  
në Krikj,\* të ndëlgojën se pesimi  
jit \* isht i vullnetëshëm,\* e t'i  
ligjirojën jetës,\* se Ti je me të  
vërtetë \* paskjirimi i Atit.

Kjinon.:Te drita e lëvdis s'fakjes  
s'ate,o i Madh'in'Zot,do të jetsi-  
ëm,e në embrin t'ënt ka t'gzonemi  
për gjithëmonë.Allilulia.(3 herë)

---

### Ditën 15 të Gushtit

Të flëjturit e të Hipurit në  
kjiell në lëvdi të Shën Mëris.

Ant.: I-Ngrëni zërin të lëvdoni  
t'ën'Zonë, o gjithë dheu.

-Për parkalesitë.....

-Lëvdi...nani....përpar.

" II-In'zot do diert e Sionit  
më shumë se gjithë tendat  
e Jakobit.

Shpëtona,...ndër Shejtrat  
i famasëshëm,neve çë....

-Lëvdi...nani...O i vetmi.

" III -Kjekjin e shëndeties u  
dua të marr,e emërin e t'  
in'Zoti u dua të thërres.

Apol.:-Të të Lerit \* Ti e ruajte  
virgjërin;\* te të Flëjtur-  
rit \* ngë,e le jetën,\* o  
Mëma e Perëndis;\* shkove te gje-  
lla,\* Ti çë je Mëma e gjellës,me  
lutiet t'ote tue shpërblier \*  
nga vdekja shpirtrat t'anë.

Kont.:-Mëmën e Perëndis \* të pa-  
flëjturë në lutje,\* e në mburon-  
jë \* shpresë të patundurë,\* var-  
ri e vdekja ngë e mundën;\* se,si

Mëmë të Gjellës,\* e bëri të shkoj  
te gjella \* Ai që jesi në gji të  
virgjër për gjithëmonë.

Kjinon.: Kjelkjim e shëndeties...

K R E S H Ë M Ë T

Tek e para e Diellië të Kreshmëvet

Ant.: I -In'Zot rregjëron:e pësh-  
tronet me nder të mathë;in'  
Zot vishet e me fukji rreth-  
net

" II -Le të lëvdojmë t'ën'Zonë  
për lipisin e'Tij e për fama-  
smët që ka bër për bijët e  
njerëzëvet.

" III -E lëvdofshin kjiellia,  
dheu e dejti e çëdo tundet  
ndë'atë.

Apol.: -Fitirën t'ënde na ponisiëm,  
o i Mirth,tue lipur ndëjesën e më-  
katëvet t'ona,o Zoti Krisht Perë-  
ndi,pse Ti deshe Ti deshe vetëm e

vetëm të ishe me kurmin vjerrë  
mbi krikj-sa t'na liroje nga  
robëria e armikut. Andaj tue dhë-  
në Hir Tij po thërresiëm: na mbu-  
she të gjithë me harë, o Shpëtue-  
si jinë, posa jerdhe të liroje  
jetën.

Kont.:-E pakufizuashme Fiala e  
Atit u kufizua tue marrë mishë  
ngah Ti, o Mëma e t'in'Zoti, e  
fitirën e ndyeme nga mëkata e  
shpërfitiroi e e pruri si ishë  
të përzieme me bukurin e huynu-  
shme. Tue ligjëruar shëndetën çë  
Ai na pruri, me fialë e të bëma  
duam t'e vërtetojmë.

---

Tek e treta e Diellië e Kresh-  
mëvet. Të përmisurit e Krikjes  
s'Shejte.

---

Ant. I-U dëftua mbi ne drita e fa-  
kjes s'ate, o i Madh'in'Zot,  
i dhe gzim zëmbres t'ime.

.....  
" II-Gjithë anët e Botës pan  
shëndetën e Perëndis t'ënë.

" III -Lartësoni t'ën'Zonë Perëndin t'ënë e përmisij nënkëmbies e këmbëvet t'Tij, se Ai isht i shejt.

Apol. e Kont. si te dita 14 të Shtatorit.(f.101)

Në vent të Shejt Perëndi:

Krikje t'ëne proskjinisiëm....

---

O shpirti jim, o shpirti jim, \*  
 ngreu, përçë flë? \* Isht e kjaset  
 hera e sprasme, \* e ti do t'tra-  
 zonesh. \* Zgjou, \* adhà sa të t'  
 kursenjë Krishti Perëndi, \* i çili  
 ndodhet gjithë-asajtën, e mbush  
 gjithkjish.

---

Diertë e ndëjesës sbillëm, o Gje-  
 llëdhënës. Njize andai priret sh-  
 pirti jim te faltoria jote e she-  
 jte tue kjellur faltoren e kurmit  
 i plot me mëkatët: po te mirësia  
 jote pastroje me të madhen lipi-  
 si t'ënde.

Kij lipisi për mua, o i Madh' in'zot, për sa e madhe isht lipisia jote.

Si shumizën e mëkatëve t'ime u i mjeri kujtonjë, i trëmbem të dreruashëmes ditë të ligjës, po tue pasur besë te mirësia e te lipisia jote, si Dhavidi po thërres Tij: Kij lipisi për mua, o i Madh' in'Zot, për sa e madhe isht lipisia jote.

### TEK E DIELLIA E PALLMIEVET!

Ant. I -U dua t'ën'Zonë, se Ai gjegjet zërin e lutias t'ime.  
 -Për parkalesitë.....  
 -Lëvdi...nani....

E II -Pata besë, përandai fola; u kleva shumë i mjeruam.  
 -Shpëtona, ..., o Ti që u uje mbi një polistrë ghajdhrie, neve që të këndojmë. All.

" III -Lartësoni t'ën'Zonë se isht i mirë; se e pasosme isht lipisia e 'Tij.

Ngajállien e të gjithëve \* më pa-  
ra-se-pesimi jit tue vërtetuar,\*  
ngjalle Lazarin s'vdekurish,\* o  
Krisht Perëndi:\* andai edhe na si  
ata Dielmë,\* tue kjellur shëgjet  
e mundësis,\* Tij që munde vdekjen  
thresëm:\* Osanna te më t'lartit,\*  
i bekuar Ai që vien \* në embër të  
t'in'Zoti.

ISODHOS: -I bekuar Ai që vien në  
embër të t'in'Zoti. Perëndi isht  
In'Zot, e na u dëftua neve. Shpëtona,  
o i Birí i Perëndis, o Ti që u uje  
mbi një polistër ghajdhurie, neve  
që të këndojm: allilua.

Kont.: -Në kjiell mbi thronin, në  
dhe mbi gomarin ujur, o Krisht Pe-  
rëndi, pret mirë lëvdit e Ëngjëjëvet  
e himnet e fëmijës që të ulurijën:  
Bekuar Ai që vien të ngrënjë Adha-  
min.

Kjinon.: -I bekuar kush vien në  
embër të t'in'Zoti. Allilua.

---



J A V A E M A D H E

Tek e Shejta dhe e Madhe e Hënie

Shi'se Dhëndërri vien në mes të natës; e i lum shërbëtori, të çilin Ai e gjen zgjuar; po mjer ai të çilin do t' e gjenjë të kjëlluam. Ruaj pran, o Shpirti jim, mos mundesh gjumit, sa mos t' jesh dhënë vdekjes, e mos të kjëndrosh mbëllim jashta. rregjëris; po zgjoa take thirrur: I Shejt, I Shejt, I Shejt je, o Perëndi; për Mëmën t' ënde, kijna lipisi.

Kont.:-Jakobi e klaj se e kishë sbierrë e fisniku ujej mbi një thronë i nderuar si rrekjë; se ngë shërbeu pëlkjimevet e Egjiptianes kle lëvduar nga Ai që vërren zëmërat e njerëzëvet e jep kërorën e paprishëshme.

Tek e Shejta dhe e Madhe e Martie

Apol.:- Shi'se Dhëndërri vien...

Kont.:-O Shpirti jim, tue menduar herën e të sosurit e tue u trëm-

bur mos t'jesh prer si fiku;të  
 duash të shërbesh talandin që pa-  
 te dhënë tue rrijtur sgjuar e tue  
 thërritur:mos të kjëndrojëm jash-  
 ta dasmës e Krishtit.

Mbrëmënet pra këndonet: O Zot,  
 gruaja që ka rar te shumë mëkatë  
 e ndien Hjynin t'ënde! Tue ndëgu-  
 ar se ka t'jet Miroforia jotë të  
 fal me lotë Mirin e të varrëzuarit  
 t'ënt. Oh,mjera u ! Ajo thot:  
 për mua ë kjò natë pa dritë hën-  
 zie,tërbim të errët ndohtësie,  
 lakmim mëkatie. Prit mirë burimet  
 e lotëvet,Ti që rrnar te miekul-  
 laj ujërat e dejtit.Përuju rëki-  
 mevet e zëmbres t'ime,Ti që përu-  
 je kjiellin kur me të parrëfieshëm  
 vjershë mōsgjë u bëre.Dua të puth  
 ato këmbë të t'çilëvet te Parrai-  
 si Eva gjegji tingullin e hapëvet.  
 E të mëkatëvet t'ime shumësin e të  
 këkjivet t'ime honet kush do të  
 vëshgonjë,o Shpëtuesi i shpirtra-  
 vet? Oh,mos e përbuz,Ti që e pa-  
 maturshme ke lipisin,shërbëtoren  
 t'ënde.

Tek e Shejta dhe e Madhe e Mërku-  
 rie.

Apol.:- Shi'se Dhëndërri vien...

Kont.:- Kam mëkatruar më se kurva, o i Mirth, po lume lotësh ngë kam derdhur fare përpara Tij.

Nani në heshtie të shtihem premist tue puthur me dashuri të pangarët këmbë t'ote sa të më japësh ndëjesën e mëkatëve, o i Madh'in'Zot, mua, o Shpëtues, çë të thërres: nga bajtat e të bëmavet t'ime, liromë.

Tek e Shejta dhe e Madhe e Intie

Apol.: Kur Apostojitë të lëvdushmë te të lajturit e darkës ndriteshën, Judha i kekjë, i sëmur nga lakmia e rrgjëndit errësonej e jipëj te duart e gjikëtarëve të paligjë Gjikëtarin të drejt. Vërrej si dashuronjësi i haromëve për ata vate sosi se u mbi. Mbaju llargu nga i ligu çë këto kudsoi kundra Mieshtrit. O i Madh'in'Zot, çë je i mirë me gjith, paçe lëvdi.

Kont.:- Me duartë e 'Tija merrë përdhënësi bukën e ato-duar nden

Fshehurith sa t'marrënjë çmimin  
e Atij që e gjeahi me duartë e'  
tija. E mbeti i paprekëshëm Jidha  
shërbëtor e prëdhënës.

NË VENT TË: -Na këtù Hjeruvimt...  
                        ë të Kjinon.....  
                        si edhe në vent të:  
                        "Pamë dritën e vërtetë  
këndonet: -Të darkës t'ënde mi-  
                        stike, o i Biri i....

---

Tek e Shejta dhe e Madhe e Prëmp.

-Viret sot \* mbi një dru \* Ai që  
d'ujëra dheun vori; ( 3 herë )  
-Kurorë glëmbash i vun rreth kreit  
Mbretit t'Ëngjëjëvet;  
-Një tsopë t'kukje për të kjeshur  
i vun mbi krahët Atij që vesh  
kjiellin me mjekulla.  
-Shplaka duroi të kishë  
Ai që liroi Adhamin në Jordhan.  
-Me gozhda kle vierrë  
Dhëndërri i Klishës.  
-Me shtizën kle i lavosur  
i Biri i Vigjëreshës.

-Na i falemi pesimevet t'atë,  
o Krisht. ( 3 herë )  
-Dëftona të Ngjallurit t'atë  
të lëvdoshmit.

Tij që vishe\*me dritë si me një  
mënt,- si të sdripi Josifi me  
Nikodhimin + nga druri \* e të  
pa vdekur, milikurë, pa varr,\* të  
dhëmbëshëm vajtim zuri - e tue  
u hjdhëruar+po thoshëj:\* O i  
ëmbëli Isuth!\* Dielli pak më  
para,- si të pa vierrë mbi kri-  
kjen + u pështrua e u err,\* e  
dheu në dre u shkunt,\* e villi  
i faltores u shkjuarr.- E nani  
u vetë \* jam e shoh + që mort-  
ié deshe Ti të duroje - për mua\*  
Si ka'të t'varrëzonjë,\* Perë-  
ndia jim?+ Si ka'të t'pështro-  
një me pulhurë?\* Me çila duar  
ka'të: 'ngas \* të pangarin -  
Kurmin t'ënt? \* Me që këndime ka'  
të lëvdonj\* të vaturit t'atë -,  
o i Lipisiar? \* U lartësonj pe-  
simet t'atë,\* u lëvdonjë varrin  
t'ënt-e të Ngjallurit t'atë+!  
O i Madh'in'Zot, paçe lëvdi.

V A J T I M E T

Zoti Krisht, o Gjellë, edhe Ti në varr! - E gjithë Ëngjëjvet ushtrit po famaseshin, tue lëvduar sa u përueje, o i Larti Zot.

Po si vdes Ti gjella? Si ndë varr po rri? - Ngë je Ti që përfarove vdekjien, që të vdekurvet pameta gjellë i jep?

Zot' i gjithësis, - si i vdekur\* u pa, + dhe ndë një varr i rri \* po vuhet, - Ai që mbrazin varret, + nga të vdekurit.

Ti, o Krisht, o Gjellë, - Ti u vure\* ndë varr, = edhe shkëlë me vdekjien t'ënde - mortien, \* dhe i burove\* jetës gjellën.

Nga të gjithë njerëzit - më i hjieshmi \* në bukuri, \* si i vdekur i shëmtuar\* po duket, + Ai që sbukurroi - naturën e gjithësis.

O Isuth i ëmbël e dritë - Shpëtues, si po fshihe ndë një varr\* të errët, O durim i pafolur, \* i pathënë!

Kur tue dashur nën dhe+u sdrìpe, \*Shpëtimtar,\* gjellë pameta i fale njerëzëvet 'të vdekur, dhe i ngrëjte lartë-t'Atit në lëvdi.

Kush do t'më japënjë uji-dhe\* burim? = Virgjëresha Nuse e Perëndis + po thërrisëj,\* sa shumë të kla - të ëmbëlin Isù.

O Perëndi, o Fialë,- o gëzim i jim, si ka t'duronjë varrimin t'ënt\* të triditëshëm?+ Nani të Mëmës t'ënde \* i shkjiirret zëmbra.

O malë, o fusha dhe-shumiza \* e njerëzëvet, = klani dhe vajtoni ju të gjithë bashkë,- me mua\* Mëma e Perëndis.

Të imnojëm Tij, o Fialë,- i gjithëve \* Perëndi, =bashkë me Atin e me Shpirtin shejt.-dhe lëvdojëm - varrimin shejt t'ënt.

Të madhërojëm Tij,- o Mëmë e Perëndis= dhe nderojëm Varrin të triditëshëm \* e Birit t'ënt+ e Perëndis - t'ënt me besë.

Jinit të gjitha \* varrin t'ent  
me këнка + po nderiëm, o Zoti jim!

Me kujdes nga druri \* Josefi të  
sdripi + edhe të vuri në varr.

Grat e mira jerdhën \* tue prur Tij  
vaj-erësh, + me hir, o Krisht te  
zëmbra.

Ejani t'i thomi \* këнка vaji të  
Zotit, + na gjithë bij të Krietarit.

Tue par Tij e Shën Mëria \* të rar  
edhe pa frimë, + të ëmbël zë ajò  
vajtimin.

O drita e sivet t'imë, \* o i Biri,  
o zëmbra jime, + edhe Ti këtë te  
varri?

O paraverë e t'ëmbël, \* o i Bir i  
jim i t'ëmbël, + ku të vate bukuria.

Dot lëvdonj, o i Biri, \* të lartën  
lipisi, + sa gjithë këtë durove.

Durò neve ndëjesën \* që me të da-  
shur Të nderiëm + pesimet t'atë  
me dhimë.

Pa ngreu, shpejt, pa ngjallu; \* o i  
Bir më ndsië helmin, + mua Mëmës  
që të leva.



O efskimon Iosif apo tu ksilu kathelon to ahrandon su soma sindhoni, katharà - ilisas kje aromasin en mnimati kjenò kjidhefsas apeth eto:

---

-Bujari Jozef \* kurmin t'ënt të pangar \* e sdripi nga Krikjia, \* e në pulhurë të pastërë \* e pështolli, e me aromë \* të një varr i ri \* me lip të math e vuri.

=====

Tes Miroforis jineksi, parà to mnima epistà, o Anghelos evoa: Ta mira tis thnitis iparhi armodia, Kristos de diaftoràs edhihti allotrios.

---

-Gravet mirrëprurëse \* pranë varrit tue kjëndruar + Engjëlli thërrisëj: \* Mirrat i kan Hjè \* të vdekëshmëvet, \* po Krisht u dëftua \* për prishjen i huaj.

Nin e dhinamis ton uranon sin  
imin aoratos latrevusin. Idhù  
gar isporevete, o Vasilevs tis  
dhoksis.

Idhù thisia mistikji teteliomeni  
dhoriforite. Pisti kje potho pro-  
selthomen, ina metohji zois eoni  
jenometha. Allilua.

=====

-Nanith Fukjit e kjielliavet me  
ne prëmistë falen. E shi'se isht  
e vien Rregji i lëvdis.

Shi'e thiemia mistike e sosurë,  
se vien kjellur. Me besë e  
dishirim kjiasemi, sa të kemi  
piesë te gjella e pasosme. Alilua.

---

### TEK E SHTUNIA E MADHE

Si sos esperinoi këndonet:

Oh! Sa në Krisht u pagëzuat, me  
Krishtin ju veshët . Alilua. 3h

- Në vent të " Na këtë Hjeruvimt.  
këndonet

-Le të kjetet çedò kurm i vdekëshim,\* e le të kjëndronjë me dre e dridhmë,\* e të mos kujtonjë në vetëhë gjë të dheut;+se Rregji i rregjëravet \* e Zoti i zotërinjëvet \* vien sa t'jet ther-tur,\* e të jipet si të ngrënë të besmëvet; \* e i shkojën përpara\* shokjërit e Engjëjëvet \* bashkë me çedò Kriesi \* e Pushtet, Hjeruvimt me shumë si \* e Serafimt me gjashtë krahë,\* e tuke kënduar imnin:Alilua,Alilua,Alilua.

Kjinon: -U ngre skur u zgjua nga gjumi in'Zot,e u ngjall tue shpëtuar neve.Alilua (3 herë)

Në vent të:"pamë dritë e vërtetë

-Kujtou për ne,o Lipisiar,si u kujtove për kusarin,te rregjër-ia e kjielliavet.

=====

T E K E M A D H I A E S H E -  
J T I A E D I E L L I E E P A -  
S H K E V E T !

Menatnet njize

Te Klisha: Ejani e mirrëni dritën e Dritës e pangrisurë. Le të këndojmë e të lëvdojmë, o popuj, Isuin që na u ngre së vdekurish!

Si vehet jashta: Ngjallien t'ënde, o Krisht Shpëtues, Engjëjit këndojmë në kjiell e neve mbi dhe bënëna të mirë të T'lëvdojmë me zëmbren e pastërë.

T'arrënit përpara derës thuhet:

-E bënëna të mirë, o i Madh'in'Zot, të gjegjemi Vangjejin Shejt, na Të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijna lipisi.

Lipisi, lipisi, lipisi, o i Madh'in'Z.

VANGJEJI (Mc.XVI,1-8)

Edhe si shkoi e Shtunia, Marieja maddalenë e Marieja e jëma e Jakobit edhe Saloma blen aromët, sa t'vijën e liejën Iisui. E menatnet njize tek e para ditë e javës vijën te varri, si dolli dilelli. E thoshiën ndër'to: kush mëndë të na ndsierënjë gurin nga dera e verrit? E si priren të vërrejën,

shohiën se guri ishë rrogolisur,  
 pse ishë shumë i mathë. E si hir-  
 ën te varri pan një dialosh i u-  
 jur tek e drejta veshur me peth-  
 ka të bardha e u famasën. Ai i  
 thot atireve: Mos trëmbij, ju kë-  
 rkoni Iisuin Nazarenin që kle-  
 vënë ngrikjë: Ai u ngre; ngë isht  
 këtù: shi'vendi ku e kishën vën.  
 Por etsëni e thonii Dsënësëvet  
 e'Tij edhe Pietrit: se Ai vete  
 përpara juve në Galilë; atie ka  
 t'e shihëni, si Ai ju tha. Edhe  
 atò njize, si dualltin, jikën nga  
 varri, pse i kishë marrë dreja, si  
 të llavura. E mosnjeriu i thanë  
 gjë, se ishën të dreruame.

---

K.pr.: LEVDI' past Trinia Shejte  
 e një të klënëshe, gjellëdhënësë e  
 pandarshme, nani e për gjithëmo-  
 në e për jetë të jetëvet. Amin.

Krisht u ngjall! Ai tue vdekur  
 ndridhi vdekjien e shkretë,  
 e të vdekurëvet te varret  
 i dha gjellën e vërtetë. (3 h.)

U ngrëfshit Perëndia e klofshin  
shprishurë armikjët e 'Tij, e jikë-  
shin nga fakjia e 'Tij ata që i  
kanë mbëri.

Krishti u ngjall!...

Si kamnoi shduket, ashtu le t'shdu-  
ken ata, si dillët joset përpara  
ziarrit.

Krishti u ngjall!...

Ashtu kanë të humbiën të mëkatru-  
amit përpara Perëndis; e të drejtit  
le të gëzonen.

Krishti u ngjall!...

Kjò isht dita që bë in'Zot: le të  
gëzonemi e të bëjmë harë këtë ditë.

Krishti u ngjall!...

Lëvdi... nani... Krishti u ngjall!..

Zoti si sosë të thëni sinaptin:

Ngreni diert t'uaja, ju të Parë,  
dhe ngrëhij, o dier të përietshimë  
e do t'hinjë Rregji i lëvdis.

Perënda klishës një pien:

-Kush ë ki Rrekjë i lëvdis?

Zot i fort ë i mëndëshëm. Zot mundësorë te lufta. Ngreni diert t'uaja, ju të parë, dhe ngrëhi, o dier të përjetshme e do t'hinjë Rregji i lëvdis.

-Kush ë ki Rrekjë i lëvdis?

Zoti i fukjivet: Ai ë Rregji i lëvdis.

Sbillet dera e gjithë hijën tue kënduar

Krisht u ngjall!...

K A N O N I

.....

Stihjirë të Pashkëvet

U ngrëfshit Perëndia e klofshin shprishurë armikjët e 'Tij, e jikëshin nga fakjia e 'Tij ata ç' i kanë mbëri.

-Pashkë t'hjinushme na u dëftuan neve sot; = Pashkë të reja e të

shejte; \*Pashkë mistike; + Pashkë gjithë të ndershme; \* Pashkë, Krishti Shpërblenjës; + Pashkë të fjella; + Pashkë të mbëdha; + Pashë të t'besmëvet; \*Pashkë, çë na sbillën diert e Parrajsit; + Pashkë-cë shejtërojën të besmit.

-Si kamnoi shduket, ashtu le të shduken ata, si dillët joset përpara ziarrit.

Ejani, ju ç'e kini par, o Gra, + ejani të ja thoni edhe Sionit: + Prite Ti ngak na + nduhtën e hares të Ngjallies s'Krishtit; \* Gzou, bëj harë + edhe dëfreu, o Jerusalem, + tue par Krishtin Rrekj, + çë si dhëndërr \* nga varri ngrëhet.

-Ashtu kanë të humbiën të mëkatruamitë përpara Perëndis e të drejtisë le të gëzonen.

Grat mirrëprurëse + menatnet njize, tue kjëndruar nd'anëzë varrit të gjellëdhënësit gjetën Engjëllin ujur mbi gurin + e tue folë ai atireve, kështu i thoshëj: \* Si ju këroni të gjallin bashkë me të vdekurit? +



Përçë vajtoni të pavdekëshim?+  
 Jetsëni e thonëji Dishipujvet  
 e 'Tij: \*Krishti u ngjall s'vde-  
 kurish.

-Këjò isht dita që bë in'Zot;le  
 të gëzonemi e të bëjëm harë te  
 këjò ditë.

Pashkë të gëzuashme;+ Pashkë të  
 t'in'Zoti,Pashkë;+ Pashkë gjithë  
 të ndershme + na u dëftuan  
 neve sot; \* Pashkë,në gëzim +  
 të duhemi mirë njeri me t'jetr-  
 in;+ o Pashkë shpërblim helmi;+  
 se nga varri si nga gjumi u ng-  
 re tue llambarisur Krishti,\*  
 gëzoi Grat me shumë gëzim +tue  
 thënë:+jipni nduhtën Apostojvet.

- Lëvdi...nani...

Dita e Ngjallies,të jemi të ndr-  
 tur nga festa,e të duhemi mirë  
 njeri me t'jetrin;thomi,o Vëlle-  
 zërë,edhe atire që na duan lik:  
 të ndëjejem të gjitha të dita e  
 Ngjallies,e kështu të thomi:  
 Krishti u ngjall! .....

T E M E S H A

Si zë Mesha, për gjithë javën, pas  
"Bëkuarë Rregjëria..." thuhet:

Krishti u ngjall!... (3 herë)

Pran: Ungefshit Perëndia e klof-  
shin shprishurë armikjët e 'Tij;  
e jikëshën nga fakjia e 'Tij ata  
çë i kanë mbëri.

Krishti u ngjall!...

-Si kamnoi shduket, ashtu le të  
shduken ata, si dillët jonet për-  
para ziarrit...

Krishti u ngjall!...

-Ashtu kanë të humbiën të mëkatr-  
uamitë përpara Perëndis e të dre-  
jtisë le të gëzonen.

Krishti u ngjall!...

-Këjo është dita që ë bë in 'Zot;  
le të gëzonemi e të bëjmë hare  
te këjo ditë.

Krishti u ngjall!...

-Lëvdi... nani...

Krishti u ngjall!...

A N T I F O N E T

Ant.: I -Ngrëni zërin të lëvd-  
oni t'ën'Zonë;këndoni  
embrin e'Tij.

-Për parkalesitë ....

-Lëvdi...nani.....

" II -Perëndia paçit lipisi  
për ne e na bekoftshit;le  
t'ftonjë fakjen e 'Tij neve  
e na paçit mëshirë.

-Shpëtona,,...i ngjalluri..

-Lëvdi...nani...O i Vetmi..

" III -U ngrëfshit Perëndia e  
kloshin shprishur armikjët  
e'Tij;e jikëshin nga fakjia  
e 'Tij ata që i kanë mbri.

Krishti u ngjall! ...

ISODHOS:-Te mbledhiet bekoni t'  
ën'Zonë Perëndi ju që vini nga  
burimet e Israelit: Shpëtona,..

= Oh! Sa në Krisht.....

=Në vent të "Axion estin...."

-Engjëlli i thërrisëj.....

Kjin.:- Kurmin e Krishtit mirrëni,  
kroin e pavdekëshëm ngjepëseni.  
Alilua.

Në vent të "pamë dritën..." e të  
" Embri i t'in'Zoti..." këndonet:

Krishti u ngjall! ...

Si sosë Mesha:

Prif. : -Krishti u ngjall!

Gjindia:-Vërteta u ngjall! (3 h.)

Kron e rregjëron për gjithëmonë.  
Ashtu kloft!

=====

Tek e Diellia e Shën Tomait  
Kjinon.isht ki: -Lëvdò,o Jerusa-  
lim,t'ën'Zonë;këndò Perëndis  
t'ënt,o Sion.Alilua.

TË HIPURIT E T'IN'ZOTI NË KJIELL.

Ant.: I O ju gjithë popujit,ksi-  
duart:ngrëni zërin Perëndis t'ëj,  
me zër hareje.

-Për parkalesitë.....

Lëvdi...nani...

Ant.: II I math isht in'Zot e i lëvduashëm, te kjiteti i Perëndis t'ënë, te mali shejt i 'Tij.

-Shpëtona, ... çë ngak na u ngjipe në kjiell me lëvdi, neve çë...

-Lëvdi ... nani ... O i vetmi...

Ant.: III-Mirrëni veshë, o ju gjithë popujt, goja jime ka t'flasënjë dituri e mendimi i zëmbres t'ime do të jetë kuptim.

U ngrëje në lëvdi, + o Krisht Perëndia jinë, + edhe gëzove dsënesit me të taksurën e Shpirtit Shejt, + tue i vërtetuar me bekimin, + se Ti je i Biri i Perëndis, + Shpërblimtari i jetës.

ISODHOS: U ngjip Perëndia ndër thirma gëzimi; in'Zot ndër të rar trumbetie: Shpëtona, ... çë ngak na u ngjipe në kjiell me lëvdi, ....

KONT.: Kur për gjithë ne mbarove urdhurimin, e përbashkove dheun me kjielliën, u ngjipe në lëvdi,

o Krisht Perëndia jinë, pa u ndar  
 mosgjakun ngak na, po tue kjëndr-  
 uar i pandarshëm, e tue thënë ati-  
 reve që të duanë: U jam bashkë me  
 ju, e mosnjëri isht këndra jush.

KJINON.: - U ngjip Perëndia ndër  
 thirra gëzimi, in'zot ndër të rar  
 trumbetie. Allilua.

Tek e Diellia e Pendekostes

Ant. I-Kjielliat rrëfiejën lëvdin  
 e Perëndis e kjëndresa 'fton pu-  
 nën e duarvet t'Tij.

-Për parkalesitë.....

-Lëvdi...nani...për park...

Ant.: -II-Të gjegjëshit in'Zot te  
 dita e helmëvet e të ruashit em-  
 bri i Perëndis t'Jakobit.

-Shpëtona, o Ngushëllimtar  
 i Mirë, neve që të këndojëm  
 Allilua.

-Lëvdi...nani...O i vetmi...

Ant.: III-O Zot, në pushtetin t'  
 ënt ka t'ftonet Rregji e te

shëndetia jote ka të gëzonet shumë.

- I bekuar je, o Krisht \* Perëndia jinë,+ Ti që të dishëmë pishkjëtarët dëftove,+ tue dërguar mbi ata Shpirtin Shejt + e me ata gjithë jetën zure në rrietë,+ o Ti që do mirë njerëzit, lëvdi Tij.

ISODHOS:-Lartësou, o i Madh'in' Zot, në pushtetin t'ent; na do të këndojmë e të msaliëm fukjit t'ote. Shpëtona, o Ngushëllimtar, neve që të këndojmë: Allilulia.

---

Kont.:-Kur i Larti u sdrip e p përziejti gluhët, ndajti gjindet; kur dharoi gluhët ziarrri, i thërriti në bashkim e na gjithënjëzë lëvdojmë gjithëshejtin Shpirt.

- Oh! Sa në Krisht u pagëzuat me Krishtin ju veshët. Allilulia.

Në vent të Axion estin:

-Ti që pa njohur burrë Kjelle te gjiri FIALËN, që gjithëkjish bëri e misht t'atë i dhë, o

Virgjërë, Mëmë të Perëndis, o vent  
tërtë pasosmit, o shpi të të Madhit  
Zot, Tij na madhërojëm.

Kjinon.:- Shpirti jiti i mirë ka  
të më kjellënjë te dhromi i  
drejt. Alliluaia.

### KËNKA E SHPIRTIT SHEJT

Eja, o Shpirt e Perëndi  
Përvëlomë Ti këtë gjë:  
U të përes me dishirim,  
Shejtërom shpirtin t'im.

-Eja, eja, eja, o Shpirt e Perëndi.

Eja, o Shpirti Shejti i jim,  
Eja e ndrite shpirtin t'im.  
Flakë e fjalë e Shpirtit Shejt,  
Dhizëm zëmbren t'ime shpejt.

-Eja, eja, eja, o Shpirt e Perëndi.

Eja o frimë e Parakletë,  
Ngushëllomë me t'vërtetë.  
O Parrais i shpirtit t'im,  
mblomë zëmbren me gëzim.

-Eja, eja, eja, o Shpirt e Perëndi.

O Parrais i shpirtit t'im,



Mblomë zëmbren më gëzim,  
Dritën t'ënde, o Shpirt dhurona  
Dhis me ziarrin zëmbat t'onë.

-Eja, eja, eja, o Shpirt e Perëndi.

TEK E INTIA E SH. SAKRAMENT:

Ant.: I-Bukën e Ëngjëjëvet hën-  
gri njeriu; Bukën e kjielliës i  
dha atire.

-Për parkalesitë....

-Lëvdi...nani.....

Ant.: II-Kjelkjin e shëndeties  
u dua të marr e embrin e Perëndis  
dua të thërres.

-Shpëtona, o i Biri i Perë-  
ndis, Bukë e sdripur nga  
kjiellia, neve që të kë-  
dojm: Allilua.

Ant.: III-Ka të hanë të vapkj-  
it e ka të ziten.

-Kujtimi i jiti, o Krisht e Perëndia  
jinë, pruri në jetë + këtë ditë të  
festie + përse ngak Ti ata që zë-  
jën pishkjë + mësuan të faliën

Tij në bukë e në verë flijën të  
papërgjakshme + sa të bëjnë të  
hjinushmin kujtim + çë edhe na  
kremtojmë tue kënduar:lëvdi Tij,  
o i Madh'in'Zot.

ISODHOS: O TI çë jep të ngrënë  
gjithë njeriu,shpëtona,....Bukë  
e s'dripur nga kjiellia,.....

-Oh! Sa në Krisht.....

Kjinon.:Kush ha misht t'im e pi  
gjakun t'im,kjëndron tek U e U  
tek ai.Alliluia. (3 herë).

=====

PARAKLISI-LUTIE  
GJITHËSHEJTES MËMË E T'IN'ZOTI

---

I bekuar Perëndia jinë kurdoherë  
nani e për gjithëmonë e për jetë  
të jetëve.

Amin.

Ms.142 - O Zot,gjëqj parkalesin

t'ime, mirr veshë lutien t'ime  
paj të vërtetës s'ate; gjegjëme  
paj të drejtësis s'ate.

E mos hir në gjikjë me shërbë-  
torin t'ënt, se mosnjeri ndër të  
gjallët isht i drejt përpara Teje.

Se armiku ka ndjekur shpirtin  
t'im e ka shtur posht njera të  
dheu gjellëm t'ime.

Më vuri të rri në të errëtitë  
si të vdekurit e vjetrë, e  
shpirti i jim isht më helm, e  
brënda meje isht e trazuame  
zëmbra jime.

U kam kujtuar ditët e motçmë,  
kam mejtuar mbi gjithë veprat  
t'ote tue menduar të bëmat e  
duarvet t'ote.

U ndenj tek Ti duart t'ime;  
shpirti i jim isht si dhe i that.

Shpejtë gjegjëme, o Zot, m'u muar  
shpirti.

Mos priç fakjien t'ënde ngak  
u mos u t'i glas atireve që  
sdripen në gropë.

Bënëmë të njoh, o Zot, dhromin tek  
i çili ka t'jets, se tek Ti kam  
ngrëjtur shpirtin t'im.

Liromë nga armikjet e mi, o Zot,  
tek Ti u kam gjetur pështrim;  
mësomë të bënj vullimin t'ënt,  
se Ti je Perëndia jim.

Shpirti i jit ka të më helkjenjë  
te dhromi i drejt paj t'émbrit  
t'ënt, o Zot. Ti do t'më japësh  
gjellë.

Me drejtësin t'ënde Ti ndsir  
shpirtin t'im nga ngushtimet,  
e me lipisin t'ënde sos  
armikjët e mi.

E prish gjithë abà që shtrëngojnë  
shpirtin t'im, se u jam shërbëtori  
jit.

\* Perëndi isht in'Zot e na u dë-  
ftua neve; i bekuar kush vien  
në émbër të t'in Zoti.

\* Lévdoni t'en'Zonë e thërrini  
émbrin shejt të 'Tij.

+ Gjithë popujitë më kanë rrethuar,

e në embër të t'in Zoti u kam  
ruajtur nga atë.

+Këjò punë u bë pr'anë të t'in!  
Zoti e ishtë e famasëshme përpara  
sivët t'anë.

-Te Mëma e t'Lartit gjithë nani  
po të hjidemi, na fajtorë edhe të  
mjerë i për ujemi, nga thëlpit i  
zëmbres po tue thirrë Asaj në  
pendim: Zonjzë e përmallshëmë,  
na jip ndihmën t'ëndë. Shpejt se  
jemi e sbiremi për lusmën e  
mëkatëvet; mos le pa hir të  
dhënit e tu, se Tij shpresë na  
kemi të vetëmë.

Lëvdi ... Nani ...

-Kurr e po kurr do të kjetemi,  
o Mëm'e të Lartit, take rrëfier  
pushtetin t'ënt, na të pavlerëshmë,  
se në pran Ti ngë ndih neve me  
t'luturat, kush mëndë neve të na  
ruanjë nga ksisoje rrëzikje? E  
kush na ka ruajtur njera nani  
të lirë? Ngë vemi jo, o Zonjë e  
lartë ngak Ti; se nga herë shër-  
bëtorët t'atë nga çedò t'kekje  
i liròn.

-MS. 50.

Lipisi për mua paçe, o Perëndi,  
përsa e madhe isht butësia jote;  
e për sa të shumë janë mëshirët  
t'atë, Ti fshij paligjën t'ime.

Po tër më laj së paligjjet s'ime,  
e më dëlir mëkatiet s'ime.

Pse u njoh të paligjjen t'ime, e  
mëkata ime e kundra përherë mua  
përpara.

Kundra Tij vetëm u mëkatrova e  
përpara fajties s'ate u bëra të  
të kekjien, sa të daljsh i drejt  
me fialët t'ote e sa të mundësh  
kur të jesh gjikuar.

Se shih se ndë të paligjjet u u  
leva edhe ndë mëkatë më zu mëma  
ime.

Se shih se ti deshe të vërtetien  
Ti mua më sblove t'ershmat e të  
fshehurat e urtësis s'ate.

Ti më shtërpik me isopin, e u kam  
të dëlitem: më lash e u më se bora  
do t'jem sbardhur.

Bën të gjegjem fialë gëzimi e ha  
rëje e të përunjëtë eshtërat t'imë  
kamë të gëzomen.

Fshihë Ti fakjien t'ënde mëkatëshut t'ime e fshinji të gjithë të paligjëtë t'ime.

Më bën o Perëndi, një zëmbërë të dëlirë ndë mua e shpirt të drejt më përtërij brënda mua.

Mos më përziej nga fakjia jote e mos hilkj meje shpirtin t'ënt të shejt.

M'u ktheft hareja e shëndeties s'ate, e më mbafshe fort me shpirt së larti udhëtar.

Dua të mësonj udhët t'ote të paligjëvet, e kekjëbëresit kanë të priren tek Ti.

Shpëtomë mëkatëshit gjaku, o Perëndi, Perëndia i shëndeties s'ime, gluha jime ka të lëvdonjë me gëzim drejtërin t'ënde.

Përsë në dashur kishe flijë u t'e kisha dënë, por Ti nuk kënakje me olokauste.

O Zot, sbill Ti buzët t'ime, e goia jime do të rrëfienjë lëvdin t'ënde.

Flijë Perëndis isht një shpirt i grijtur tue dhëmbur: një zëmbërë

pakjësò shpirtin t'im,\* trubullimin  
shuaj e suvalat\* çë më helmojën  
fort;\* o e të Lartit Nuseja,\* se  
ngak Ti Krishti u le në jetë,\*  
ç'isht krietari i pakjies\* tërë  
e kthiellshme.

Lëvdi.....

Mirëbëresin linde\* çë na buròn  
të mirashit,\* atë pasuri të mi-  
rëbënjësë \* jipna Ti të gjithve;  
se Ti gjithkujsh mëndë\* se Ti je  
mëma e Krishtit\* ne fukji,të  
pushtetshëm\*nga in'zot,e lumëshme.

Nani.....

Nga sëmunda të rrepta\* ligështi  
ngariesh\* jam munduar kekjë,o  
Virgjëreshë,\* Ti jipëm'ndihmë mua\*  
se të shëndeties\* tersor të pa-  
sosëm e t'palodhur,\*u kam njohur  
vetëm Tij,\* o e pa-kjërtuashme.\*

+

Lirona Ti \* nga çedò rrëzikje,\*  
Ti Zonj'e Mëm'e t'Lartit,\*se të  
gjithë pas Perëndis\* tek Ti na  
po rriedhiëm,\* si në mur pa të  
çar edhe te mgrojtësia.

+



Lëvdi past....

Tij ç'linde Shelbuesin Perëndi\*  
o Virgjërë t'lutem\* nga të ke-  
kjiet t'më lirosh,\* tek Ti nani  
u rrieth e tek Ti ngrenj\* e  
shpirtin t'im edhe mendien t'ime  
bashk.

Nani....

Sëmure jam u në kurm edhe në  
shpirt; Ti bëm të jem mirë\* të  
më ruanjë siu i t'madhit Zot,\*  
e kijëmë kujdes\* o Mëm'e të  
Lartit,\* Ti e mirë çë linde të  
mirin ndër njerëzit.

### ODHA E TRETË

Si pështrim e mburonjë\* përsá  
do të rronj sgleth u Tij,Mëm'e  
t'in'Zoti Virgjëreshë;\* jipëmë  
Ti ndihmën t'vinj\* ndëpër lima-  
nib t'ënt,\* se Ti je t'mirash  
burimi\* e fukjia e të.besmëvet,  
tërë e imnuarshme.

Gjithë e shejte...

U të lutem, Virgjëreshë,\* Ti

të prerë edhe të përujurë Perëndia nuk e dishpëlkjën.

Klofshe i mirë, o Perëndi, me Sionin të pëlkimi i jit e të stisen muret e Jerusalemit.

Ashtu atë herë do t'marsh me hir flijën e drejtësis, dhuratatë olokaustetë; atë herë kanë të të bien viçëra therores s'ate.

+

## ODHA E PARË

Gjith'e shejtia Mëm'ë t'in'Zoti, shpëtoma Ti.

E shumëta e ngarievet kur më rrethon,\* u rrieth nën hjës s'ate\* e shpëtim po tek Ti kërkonj;\* o Mëmëz'e Fialës Virgjëreshë,\* nga gjithë ngushtimet e t'kekjet\* shpëtomë Ti.\*

Gjith'e shejtia.....

Sulmim'i pesimevet më tërbôn\* evshpirti jim mblonet\* plot me helm e me hjidhërim; pajtomë, o Virgjërë, me pakjien\* e Biri t'ënt Perëndi, o e pakjërtuashme.\*

Prir Ti siun t'ënt\* me mirësi;  
 e imnuarshmia Mëm'e t'Lartit,\*  
 mbi këtë të rëndë ligëshçi\* që  
 trazon shumë kurmin t'im,\* e  
 jipëmë të shpirtit t'im shëndet-  
 tën.

+

O i flakëtë ndërmietim.\* e mur  
 fort i patundëshëm,\* burim lipi-  
 sie,\* pështrim i gjithë njerë-  
 zëvet,\* na pa u lodhur thërre-  
 siëm Tij:\*Mëm'e t'Lartit Zonjë-  
 zë,pa eja shpejt,\* e nga rrëzi-  
 kjet neve ruana Ti,o e vetmia  
 që njize vien të ndihësh neve.

#### ODHA E KATRËTË

Gjithë e shejtia.....

Ti trazamin e pesimevet,\* Ti  
 që Kjivertarin na linde Zot'e  
 Rrekj,edhë valat e mëkatëvet \*  
 kjetësomë o e t'Lartit\* Mëm'e  
 Nuseja.

Gjithë e shejtia.....

Lipisin e buroshme\* mua që pa-  
 kalës,o Zonjë dhuromë Ti,\* Ti  
 që je Mëmë e të lipisiarit Zot\*

e shëlbues të gjithë neve\* që  
këndojmë Tij.

Lëvdi.....

Tue trazuar, gjithë e pastërë,\*  
na dhuratatë t'ote, të haristi-  
siëm\* e lëvdojmë Tij me gëzim të  
math\* e si Mëm'e t'Lartit\* Tij të  
njohiëm na.\*

Nani.....

Ti je shpresa e fukjia jonë,\* e  
të shpëtimit t'ënë mar i patundë-  
shëm,\* e për Tij, o Mëmë e imua-  
rshme\* nga të gjithë të kekjat\*  
liruarë jemi na.

#### ODHA E PESTË

Gjithë e shejtia.....

Mbloëmë, o e pamëkatë,\* zëmbrën  
t'ime me dëfrimin t'ënt,\* tuke më  
dhënë Ti të fjellëtën haré,\* Ti që  
të dëfrimit\* kroin na prure si  
njeri në jetë.

Gjithë e shejtia.....

Ruana Ti nani\* nga rrëzikjet, Mëm'e

t'Lartit pamëkatë,\* Ti që na  
prure shpërblimin të përjetëshëm  
\*edhë pakjetimin\* më të lartë  
se ç'do mendie.

Lëvdi.....

Fshijëmë Ti kamnen\* e mëkatëvet  
o e t'Lartit nuseja,\*me të ma-  
dhen dritë t'përshkëlqjimit  
t'ënt,\*Ti që prure n'jetë\*  
hinoren drutë të paramotshme.

Nani.....

Bënëmë mirë Ti\* të pesimevet  
sëmundien,\* prir Ti siun mbi  
mua,o e kulluashme\* edhë shën-  
detën\* jipëmë Ti me ndërmjeti-  
min t'ënt.

#### ODHA E GJASHTËTË

Gjithë shejta....

Atë që nga vdekjia e nga kal-  
bia njerëzit leftherosi \* e që  
vetëhen e 'Tij vdekjes për ne  
ja dha,\* se po vdekjia e kal-  
bimi mbi njerëzit zotëroj,\* o

Virgjërë \* Ti lute, Zotin t'ënt e  
 Bir,\* nga kekjëbëriet e armikjë-  
 vet t'ruanjë neve.

Gjith'e shejta....

Mburonjë të gjellës t'ime e rua-  
 jtie \* të patundëshme të njeh,  
 Virgjërëshë,\* ç'luzmën rrëzon të  
 gjithë ngarievët t'ona \* e çë su-  
 lmimet ndalon të të mallkuamëvet\*  
 u Tijpërherë parkales \* të ruash  
 neve nga prishia + e pesimevet.

Lëvdi...:

Si mur të ruajtëjes t'ënë t'kemi  
 na,\* e shpëtim të vetëm t'shpir-  
 travet t'anë \* se na ngushëllon  
 te koposet, o Vajzë,\* e plot-harë  
 në dr'itën t'ënde po gëzonemi.\*  
 O Zonj'e lartë, edhe nani \* nga  
 pesimet e rrëzikjet lirò neve.

Nani...:

Në shtrat jam shtur u nani të t'  
 sëmurevet,\* e te kurmi jim nëng'  
 isht më shëndetë,\* po Tij çë t'  
 ën'Zonë e Shelbuesin e jetës \*  
 edhe liruesin na linde të sëmun-  
 dievet,\* u Tij, o e mirë, parkales:  
 nga kalbësira e sëmundievet ngrë-  
 jna Ti.

Lirona Ti... (v.162)

Prir Ti.....

Mbrojtësia e gjithë të kreshterëvet, o Virgjëreshë. Ndërmjetimi te Kriuesi i patundëshëm, mos hjidhisi të të mëkatruamëvet parkalesit, po anangasu eja si e mirë gjithë, eja e neve na ndihmò, çë me besë po thërresiëm Tij; vurna fialën e mirë, e shpejt eja e lutu për ne, Ti çë nga herë ndih ata, o Mëme e t'Lartit, çë nderojën Tij.

Çë nga dialëria jime \* kam luftë me trazime t'shpirtit; po Ti vet eja e më ndihmò e shpëtomë, o Shëlbuesi jim.. (2 herë)

Ju çë mbani mbëri Sionit, \* ka t'jini të dhunuamë nga in'Zot, \* si bari pra në ziarr jini ju të djegurë e bër shkrimp.

Lëvdi...

Paj të Shpirtit Shejt \* çilido Shpirt vien në jetë, e e pastre lartësonet e ndritësonet fort nga e Trinishmia Njëni fshehurith shejtëruar.

Nani...

Paj të Shpirtit Shejt \* po buroj-  
ën të gjithë hirevet kronjet\* e  
ujitëjën tërë gjithë kriesën \*  
për t'lerit e gjellës.

Prokujmenon.

-Ka t'kujtonj embrin t'ënt në ç'  
do jini pas jinie.

-Gjekj, o Bijë, Ti e vërrej, e vur  
veshin t'ënt, e harro popullin  
t'ënt, e shpin e t'it eti, e Rregji  
do t'dishironjë bukurin t'ënde.

-Ka t'kujtonj....

## V A N G J E J I

E sa të na bënë të mirë të gje-  
gjemi Vangjejin shejt, parkalesiëm  
t'ën'Zonë Perëndin t'ënë.

-Lipisi, lipisi, lipisi, i Madh'in'Z.

DIEJA! Shtuara! Gjeggjemi Vangje-  
jin shejt. Pakje të gjithëve.

-Edhe shpirtit t'ënt.

-Piesë të Vangjejit shejt si  
shkruan Shën Luka.



-Lëvdi Tij, o i Madh'in'Zot,  
lëvdi Tij.

-Gjegjemi.

-Tek atò ditë Mëria u ngre e va-  
te nd'ata male te një kjitet të  
Judhe. E hiri te shpia e Zaharis  
e ju falë Elisabetës.

E strksi se të gjegjurit Elisa-  
beta të falat e Mëris, dialthi  
këtseu në gjì të'saj; e Elisabeta  
kle e plotë me Shpirt të shejt.  
E me zë të math thërriti e tha:  
Bekuarë Ti ndër grat e bekuarë  
pema e gjirit t'ënt. E ngaha më  
kle mua ki shërbes, sa t'më vij  
tek U Mëma e t'in'Zoti? Përse kle  
se, si zëri i të falurit t'atë  
m'arru te veshët t'imë, këtseu  
për gëzim dialthi te gjiri jim.

E lumëzë ajo që pati besë, se  
ka të siset atë që kle thënë  
asaj nga Perëndia.

E Mëria tha: Madhëron shpirti  
jim të Zotin; e frima e jime u  
gëzua te Perëndia Shelbuesi jim.

Pse Ai mori e vërrejti ujtësin  
e shërbëtores s'Tij; e shi', se që  
nani kanë të më lumërojnë gjithë  
jinit. Pse më bë mua shërbise të

mëdha i Mëndëmi e shejt isht embri m'Tij. Mëria pra kjëndroi me atë edhe si tre muaj;e u pruar te shpiza e'Saj.

-Lëvdi Tij,o i Madh'in'Zot,lëvdi Tij.Për shumë viet,o Zot.

-Lëvdi,...

-Ti me ndërmjetimet \* e Mëmës s'ate,o i dhimbëshëm,\* Ti shuajëm shumizën \* e mëkatëvet t'ime.

-Nani... T i me ndërmjetimet....

Kijëmë lipisi,o Perëndi,përsa e madhe isht lipisia jote,e përsa të shumë janë mëshirëtë t'atë;Ti fshij paligjësia t'ime.

- Mos më le të njerëzëvet \* në besim e mbrojtësi,\* gjithëshejtia Zonj'e Lartë,\* po prit mirë lutien \* e shërbëtorit t'ënt.\* Helmesh i ndridhur jam,\* ng'mëndë duronj u më \* gjithë shigjetate të t'mallkuamëvet.\* Strehë e pështrim u ngë kam \* edhe ku të ru-

hem u i mierthi! Gjithë anëshit  
i luftuar kekjë \* edhe ngushul-  
lim jashta teje ngë kam, \* Zonj'  
e larta e jetës, \* o shpresë e m-  
mbrojtësia e kuj ka besë, \* mos-  
m'e hjidhis Ti këtë lutëje, \* t'  
mirën ç'duhet bënë m'Ti.

-Shpëtò, o Perëndi, popullin t'  
ënt e bekò trashgimin t'ënt;  
vërrej jetën t'ënde me të dhë-  
mbur e lipisi; ngrëj fukjin e të  
Krështerëvet të vërtetë, e dërgò  
mbi ne të pasuratë lipisi t'ote;  
me parkalestitë e Zonjës t'ënë  
të pangarës Mëmës s'ate e povir-  
gjërës Mëri; me fukjin e të nder-  
shmes e gjellëdhënëse Krokje; me  
mbrojtëyet e Fukjivet të ndersh-  
ëme të kjielliës; me parkalesitë  
të të ndershmit, të lëvdoshëm  
Profit, Prodhrom e Pagëzos Sën'J-  
an; paj të Apostojvet të shejt,  
të lëvdoshëmë e të nomotisurë; të  
Atëravet t'anë ndër Shejtrat,  
Krieprihtëra të Mëdhenjë e Mëso-  
njës të gjithë jetës, Vasijit të

Math, Gregorit theolog, dhe Janit Gojart; të Atit t'ënë ndër Shejtrat Shën Kollit Kriepiskopë në Mirë të Likjis, të Mbrakulluashmit; të Martravet shejtë, të lëvdoshëmë dhe bukur mundësorë; të Atëravet t'anë të shejtë e theforë; të Shejtravet e të drejtë Gjishra të Perëndis Shën Jakini e Anës; të Shejtit ... çë sot kujtojmë, e të gjithë Shejtravet t'atë, të parkalesiëm Tij, o shumë i Lipisiari Zot, gjegjëna neve të mëkatruamë çë të parkalesiëm e kijna lipisi.

-Lipisi, o i Madh'in'Zot. (12 herë)

Për lipisi e zëmbërë-mirësi e dashuri të të Vetëmit Birit t'ënt me të çilin je i bekuar bashkë me gjithëshejtin e të mirë e gjellëdhënës Shpirtin t'ënt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

#### ODHA E SHTATËTË

!Gjith'e shejtës....

Kur Ti neve shpëtimin,\* o shembues Zoti i jinë,\* deshe të na

tue jardhur te këjô jetë, Ti u l  
leve nga Virgjëresha, \* çë mburo-  
një na dhe të gjithëve: \* o Perën-  
di i atëravet t'anë \* o i Madh'  
in'Zot, bekuar je.

Gjith'e shejtia.....

T'lipisis dashuronjës in\* çë na  
prure Ti, o mëme, lute, eja, o Vir-  
gjëreshë, \* nga ftesat e nga dse-  
rkjet\* e shpirtit t'ruanjë neve  
çë me besën po thërresiëm: o Perën-  
di i atëravet t'anë, \* o i Madh' in'  
Zot bekuar je.

Lëvdi.....

Si tërsor të math shpëtimi\* si  
burim të pabishies, \* turrë të  
fukjishme, e derë të pendimit\*  
dëftove Mëmën t'ënde\* gjithë ne-  
ve çë po thërresiëm: o Perëndi  
i atëravet t'anë \* o i Madh' in'  
Zot, bekuar je.

Nani.....

Tëmkurmit gjithë kurrësmët\* të  
shpirtit sëmundiet\* shëndosh t'  
atireve\* çë tek Ti me mall po  
vijën\* nëm shpagërit t'hjynushëm\*

o ti mëmë dhe Virgjërë,\* Ti që  
Shelbuesin Krisht \* për ne te  
jeta linde.

### ODHA E TETËTA

Gjith'e Shejtia.....

Ata që tue lutur ndihm'lipiënn  
Tij,\*Virgjërëshë,\* mos vërrej  
lik se ata Të këndojnë\* edhe të  
lartësojnë\* Tij,Vajzë për gjithë-  
monë.

Gjith'e Shejtia.....

Ti të jatrivet burimin derth,\*  
Virgjërëshë,\*mbi ata që Tij me  
besim këndojnë \* edhe lartësojnë\*  
të famasmen lindie t'ënde.

Lëvdi.....

Sëmundiet e shpirtit t'im s hën-  
dosh Ti,\* Virgjërëshë,\* e shëndo-  
sh edhe dhëmbiet e kurmit,\*sa të  
lëvdonj u Tij,Tij,Zonjë e Hirë-  
plota.

Nani.....

Ti nga sulmim të ngarievet,\*  
Virgjëreshë,\* e kjetëson të  
pesimevet trazimet,\* andai Tij  
t'këndojëm,\* Tij Mëme,për  
gjithëmonë.

#### ODHA E NËNDËTË

Gjith'e shejta....

Të lotëvet t'ime rriedhien \*  
mos të vërresh me sit të kekjë,\*  
Ti çë na prure Atë në jetë,\* çë  
nga fakjia \* lotët na fshijti,o  
Virgjëreshë,Krishtin të Madh'  
in'Zot.

Gjith'e shejta....

Haren e zëmbres t'ime \* mblomë,  
o Virgjëreshë,\* Ti çë të hares  
përite mirë \* Buronjësin,\* e të  
mëkatëvet lipin \* ndalove e  
shuajte.

... Lëvdi...

Me rrëzet e dritës s'ate,\*ndrit,  
o Virgjëreshë,\* tuke ndjekur të

pandëlgimit \* të erëtit, \* sa o  
Mëm'e të Lartit, me lutie \* t'  
njohiëm e të thresiëm.

Nani...

Në vend të ligështimt \* atë që  
për sëmundien \* isht i rar posht,  
o Virgjëreshë, \* shëndoshe Ti \*  
e nga sëmundia, shëndetien, \* bën  
tëv ket pametani.

-Shumë mir' isht me të vërtetë  
sa të thomi Tij të lume Zonjë,  
për gjithë monë të lumëshme dhe  
të papërlieme edhe Mëmë të t'Ma-  
dh'in'Zot.

Tij më të nderoshëme se Hjeru-  
vime të e pa të përkrahur më të  
lëvdoshme se Serafime të, që pa fa-  
re u ndotur të Lartën Fialë lin-  
de, vërteta Mëmë të Zotit po ma-  
dhërojëm na.

-Kë më lart e larta e kjiellit  
isht \* edhe më e thielletë \* se  
shkëlqimet e diellit \* kë po  
pru shpërblesën \* për ne nga në-



ma e parë,\* e gjithësis. të Zonjën  
\* nderojëm kënkashit.

-Për gjithë ata faje që vet kam  
bër \*i sëmurë ë kurmi,\*i sëmurë  
ë shpirti jim:tek Ti vinj e  
ruhem,\* tek Ti që je Hirplotë;  
\* e shpresa e të të pashpresmit,  
\* Ti mua më ndihmò.

-Zonjë që na prure kë pru shpë-  
rblim \*vëri vesh lusivet \*shër-  
bëtorësh të pa vleftë \* sa të  
jesh pajtore \* përpara Atij që  
linde;\* o Zonjë e madhe e jetës,  
\* bënu ndërmjetësë.

-Këndaze këndojëm këtë kënkë  
Tij \* të pokëndoshme \* Mëmë e  
t'Lartit me gas të math;\* Ti  
bashkë me Shën Janin \* edhe me  
radhët shejte,\* këtheu,o Mëmë  
e t'Lartit,\*kij mëshirë për në.

-Bëj të lume gojën kuj të lëv-  
don \*kuj sot i përujet \* Korës  
t'ënde të ndershme fort \* që  
kle bukur ngjierë \* nga ai i T-  
in'Zoti Apostull \*Shën Luka i

përfalur \* Zonj'Odhijitrie.

-Ëngjëjish të gjithë ju ushtri,\*  
Prinjës i t'in'Zoti,\*o Apostoj  
të dimbëdhietë,e të lumësh godhë  
\* me Mëmën e t'in'Zoti o ju ndi-  
hmë të na jipëni \*shpëtim për  
të pasur na.

TRISAJON (v.f.2)

Se jotia isht rregjëria e fukjia  
e lëvdia e Atit,e Birit edhe të  
Shpirtit Shejt,nani e për gjithë  
monë e për jetë të jetëvet.Amin.

-Ti kijna lipisi,o i Madh'in'Zot,  
\*Ti kijna lipisi;\*se tue na u  
lipsur neve kush t'na ruanjë,\*  
Tij këtë parkalesi,si Rrekj e Zot,  
\*na të mëkatruamit Tij falëjëm;\*  
Ti kijna lipisi.

Lëvdi...

-I Madh'in'Zot,Ti kijna lipisi,\*  
se po tek Ti shpresojëm na;\*mos  
u zëmbrò me ne fort kekj,\*e mos  
kujtò ftesat e paligjësit t'ona;  
\*po vërrejna edhe nani si i dhë-  
mbëshëm,\* e neve nga armikjët t'  
anë Ti shpëtò;\*se Ti je Perëndia

jinë\*e na populli jit;\* të gjithë bër nga duart t'ote,\* e shejtin embër t'ënt kemi thëritur na.

Nani...

-Të lipisis s'ate derën \* sbillëna neve Ti,\* o e bekuamia. Mëm'e t'Lartit;\* na që kemi shpresë tek Ti.\* ngë mënd'shpresojem m'kot;\* shpëtofshim na po për Tij nga kekjëndodhjet;\* se Ti je,o Mëme,shpëtimi i gjindes të t'Krështervet gjithë

DITURI'

-Bekona,o Zot.

Ju bekoft... Amin.

Gjithëshejtia Mëm'e t'in'Zoti...

-Tij më të nderoshme.....

-Lëvdi Tij,Perëndia jinë,....

Lëvdi past ...nani...Amin.Lipisi, lipisi,lipisi,o i Madh'in'Zot, bekona,o Zot.

-Krishti,Perëndia jinë,.....  
e që njeriun do mirë.

Amin.

Apostoj nga gjithë anët  
këtù bashkë të mbëjedhurë,

Të Gjetsemënit te kopshti  
varrëzommi kurmin.

E Ti Bir e Perëndia jim,  
mirrëmë shpirtin.

Të Engjëjëvet ëmbëlsia  
të helmëvet hareja;

Të krështerëvet mbrojtësia  
o Virgjërë Mëm'e t'in'Zoti,

Eja ndihëmë e liromë  
nga të pasosmitë mundime.

E Tij ndërmjetësë u kam  
të njeridashësi Perëndi;

të bëmat mos më kjërtò  
përpara Engjëjëvet;

Të parkales, o Virgjëreshë,  
sa më njize të më ndihësh.

O përgjë fër me ar  
e dimbëdhietësh mure kjitet,

O pikësh dielli thron  
kathedra Ti e Rregjit!

O famasmë që ngë ndëlgojëm  
si Ti jep sisë t'in'Zoti?

---

-Gjith'mburon, o e Mirë, sa tek Ti  
rriedhjen edhe vunen me besë \*  
nën asaj dorie plot-fukji; \*  
se ngë kemi t'jatërë \*  
na ndërmjetim në t'ën'Zonë, \*  
ndër rrëzikjet e helmet, \*  
na të mëkatruamë, \*  
ç'jemi të kurrusurë \*  
nën mëkatës ç'na rëndon, \*  
Mëmë e Perëndis t'lartësuar; \*  
t'përmisurë andai thomi na:  
ruaj \* nga gjithë kekjëndodhj-  
et shërbëtorët t'atë.

---

## P A R K A L E S I '

## S H È N

## G J E R G J I T

-Si bujar ndër martrat,\* Atholo-  
forë Gjrkjë,\* mjedhurë këtu na  
sot,+ të lartësojëm,\* se dhromin  
Ti mbarove,\* besën Ti ruajte,\*  
e nga Perëndia pate,\* kurorën e  
mundies,\* Atij lutu,\* nga prishë-  
ria e rrëzikje të lironjë,\* ata  
çë me besë lëvdojën,\* kujtimin  
t'ënt të nderuashimn.

-Me Shpëtuesin vuajte,\* e me vde-  
kjen vdekjen e'Tij,\* deshe të  
pashkjiroje,\* bashkë rregjëron  
bukurë nani,\* purpurën nga gjaku,  
\* tue veshur të shkëlqjëme;\* e  
me shkopin e luftimevet,\* i sto-  
lisur,\* e dalluar me kurorën e  
mundies,\* për jetë të pasosme,\*  
deshmor i mathë,Gjerkjë.

-Si një ill me shumë dritë,\* si  
diell i shkëlqjiem,\* te hapësirat,  
të njohiëm Tij,\*si margaritar i  
çëmuar fort,\* si gur çë jep dritë,  
\* e i zoti ndër Martrat,\* si mbu-

ronjë, \* të të besmëvet në rrë-  
zik, \* të lëvdojëm, \* tue kremtu-  
ar kujtimin t'ënt, \* Tropeoforë,  
Gjerkjë.

Te lumëritë

(Kënka VII) - Ngë isht dhe, ngë  
isht dejt, \* ngë isht kjitet  
edhe shkretirë, \* të ku vërteta-  
ni ngë burojën \* kronjet e fa-  
masmëvet t'ote, \* tue u derdhur,  
o i Shën Gjerkj, \* si ujërat e  
dejtit; \* se embri jiti i famasë-  
shëm \* isht kënduar te gjithë  
jeta.

(Kënka IX) - O i Shën Mitër, \*  
bashkë me të shkluamin Shën  
Gjerkj, \* se të di jini bujarë  
të fortë, \* mos harroni kur \*  
horën t'ënë, po ruanie për  
gjithëmonë, \* e mbani llargu  
asaj \* luzmët e ngarievet, \*  
ju të di ruenjsit t'anë.

Lëvdi...nani...

(Kënka IX) † Lëvdia, bukuria, -  
lulëzimi i të besmëvet, \* kre-  
nia e Engjëjvet, \* i jetës shpë-  
timi, \* o shumë e ndershëmia Mëma

e Krishtit Perëndi,\* ruana,o gjithëshejte,\* neve që rriedhjem \* nën pështrimin të shpëtarit t'ent.

### H J E R E T I S M I

I - Tue kujtuarë Prindrat t'anë t'Arbëreshë,çë si u pan shkelur nga Turku,u pruartën me shpres tek Ti,e të lipën ndihëm sa t'i ruaje besën e t'i 'ftoje dhromin e liris te dheu i buaj,na me mirë-njohësi,vijëm e si ata të këndojëm:

- U të falem,o i shën Gjerkj, deshmor i math.
- U të falem,Shejt-i bekuar që dhuron lume shëndetie.
- U të falem,Tij që jep shëndetën atire që t'e lipën.
- U të falem,o Burim i fortësis për shpirtat e kurmet t'atire që të thërresiën me besë.
- U të falem,dreja e Dioklezianit.
- U të falem,o i shën Gjerkj,dreja e të pa-besmëvet.
- U të falem,o Thaumaturg i math.



-U të falem, i shën Gjerkj, o ..  
ndihma e Horës t'ënë.

Ti, o i shën Gjerkj, që i mësove  
dhromin të këtire vendëve, te  
ku jerdhën e stisën këtë horë.  
Ata ngë të harruan kur, të sgl-  
odhën për mburonjës të Horës  
e të falën embrin t'ënt tue  
kënduar: Allilulia.

II - O ushtar i Krishtit, na  
këtë mbjedhurë te Klisha jote,  
që t'atërat t'anë të stisën, sa  
t'i falemi embrin t'ënt të she-  
jtëruamit, na gjithë vitin e vi-  
tit rrëjdhiëm të të nderojëm.  
Ruajna, përçë mahare të këndojmë:

-U të falem, o i shën Gjerkj, që  
je nderi i deshmorëvet të Krë-  
shterë.

-U të falem, o i shën Gjerkj, u-  
shtar i Rregjit mathë.

-U të falem, o i shën Gjerkj,  
shërbëtori i Krishtit.

-U të falem, se Ti shkele lëvdin  
e jetës sa të kishe gjellën e  
pasosme.

-U të falem, o i shën Gjerkj, se

Ti dhurove gjakun t'ent sa t'ftoje besën të Krishtit.

-U të falem,se Ti me mundimet t'atë na jep fukji shpirtravet.

-U të falem,o i shën Gjerkj,se me parkalesitë t'ote,na ruan nga sëmundiet.

-U të falem,o burimi i mirësis.

-U të falem,o burimi i fortësis.

-U të falem,i shën Gjerkj,o ndihma e Horës t'ënë.

III - Na të besmit t'atë,o i shën Gjerkj,ngë mëndë t'thomi sa të madhe janë mirësitë t'ote.Na të mëkatruamë ngë kemi fialë sa të lëvdojmë si duhet pushtetin e fukjin t'ëndë,po këndojmë:Allilulia.

Tue rrëjedhur tek Ti,pështrimi jinë,na të besmitë t'atë të lutemi e të parkalesiëm të na lirosh,o Ushtari i Krishtit nga gjalpëri i ligu i Pisës,e nga çëdo armik sa gjithë bashkë të të lëvdojmë e të të thërresiëm:

-U të falem, o shejt trim i trimave.

-U të falem, o i shën Gjerkj, luftar i Krishtit.

-U të falem, o ndihmëtar i të vapëkjëvet.

-U të falem, o i shën Gjerkj, ruanjëtar i të vejavet.

-U të falem, o mburonjës i Prindravet t'anë.

-U të falem, o i shën Gjerkj, ruanjëtar i Horës t'ënë.

-U të falem Tij që te helmet gjithëmonë na ngushullove.

-U të falem, o i shën Gjerkj, Tij që gjithëmonë more vesh ankimet t'anë.

-U të falem, o nderi i Arbëreshëve.

-U të falem, o i shën Gjerkj, o ndihma e Horës t'ënë.

Bëjë, o i shën Gjerkj, sa na të rrojëm me shejten dre e t'in'Zoti, me besë e dashuri e t'krështerëvet të vërtetë, sa të kemi pakjen e shpirtit, të mirën e kur-

mit te kjo jetë e shpresën të  
shkojëm me Tij në Parais për  
gjithëmonë,sa të këndojëm:  
Alliluia.

RRUSARI I SHËN GJERGJIT

Në embër t'Jatit.....

Paçe lipisi për mua.....

-Lëvdojëm për gjithëmonë  
Shën Gjergjin e t'ën'Zonë.  
Shejt i lumë,si ndihmë që je,  
kij kujdes të mathë për ne,  
Ti te Parraisi mos na harrò,  
kur të vdesiëm Ti kujtona.  
Na të falemi,e për dita  
të lutemi tue thënë:  
o ndihma e shpirtit t'ënë,  
o mburonja e horës t'në.

Ati jinë që jet në kjiell...  
Shën Mëria e Dhitërejes-  
parkalesë për ne.

-Ruana,o i shën Gjerkj,nga gji-  
thë armikjët që na rrethojën e  
shpirtin t'ënë kërkujën.

-Ti t'ën'Zonë parkales  
të na ket për jetë kujdes.

Lëvdi...nani...Na të falemi....

Kjò kènkë këndonet si sos

UDHA E KRIKJES

Rrij e lëngoju nën krykjit,  
ku virej Perëndia,  
pa folë e Shën Mëria,  
me të shpëderdhur krip.

E te ajo herë e zezë,  
tuke e vështruar të Birin,  
të thier e kishte gjirin  
me të pasosmin lip.

Sa i math ish helmi i 'saj,  
ngë mënt t'e die njeri;  
te jeta ng'isht kush di  
t'e përmendonjë edhe.

Shihte një bir, t'ën'Zonë,  
të vdiste n'krykj ndër nëmë!  
pa e çila, e çila mëmë  
si ajo e dulloste kle?

O Ti çë je e Parraisit  
e larta Perëndeshë,  
digjomë edhe mirr vesh  
dishirin çë po kam.

Po të kujtonj u dua  
të birit t'ënt mundimet,  
e brëngat e pesimet.

Tek u të përtërihen,  
Ti bënë, atë çë shkoi;

atò ç' ai duroi  
 të ndienj po bën më Ti.  
 Po pran te dita e sprasme  
 u Tij për ndihmë dua,  
 të jetë i but me mua  
 kur prapë të vinjë Ai.

O Krishti i jim, çë gjegje  
 kë mëmës t'ënde i truhet,  
 kur gjella e jime t'shuhet,  
 te kjo e helmuame jetë:  
 thërrit te kjielli shpirtin  
 me Tij sa të trashgonjë,  
 edhe t'mbretëronjë  
 te jëtëza e vërtetë.

-----

O çë helme shkove  
 kopose edhe kekji,  
 kij dhimë e lipisi,  
 Mëri, për mua.

Një hir prej teje dua,  
 lavos këtë zëmbër t'de,  
 me thikëzën çë ke  
 te gjiri shejt.  
 Ka mot çë ngë rronj drejt,  
 çë Birin t'ënt u ftesë;  
 Ti lip për mua ndëjesë

të lartit Dialë.

Ëm drit'e ndihmë t'gjallë,  
të njoh,e po ndë tru  
të kem helmet e tu,  
Zonjë e dullosme.

Me duart të frikosme  
te gjiri i jit,pa hir,  
ailimano,t'ët'bir  
kam shkjerrë e vrar!

U svisem tuke klar:  
të dhëmbem u ngë sosë,  
përsë më jep kopos  
mëkatia e jime.

Çaj Ti kët'zëmbër t'ime,  
ç'e that'si hekur ë;  
ngë dua t'fëjenj u më;  
vdeksha më mirë!

Me mua te lufta hirë;  
të vetëm mos më le,  
si Zonjë e mëmë edhe  
gjithë e lipisme.

Nga kjò jet'e mavrisme,  
me Tij u të trashgonj,  
të kjesh'e t'zotëronj,  
kjellmë në kjiell.

Do t'thom,kur Ti më siell,me  
gas e më hajdhi:past nder edhe  
lëvdi e Shën Mëria!

Në embër të Atit, të Birit e të  
Shpirtit Shejt. Ashtu kloft.

I - O i pamunduri i Shën Gjerkjë,  
çë tue rrijtur në mes t'luftarëvet  
të pabesme ngë u ndote kurr me  
mekatë, po me të sieghurit t'atë  
të ndershmitë nderove dhe lëvdove  
nga herë Zotin Krisht; çë tue pasur  
mbjeghë te zëmbra jote farën e më-  
simevet të Vangjejit shejt, i ndaj-  
te të vapëkjëvet gjithë kjosmët  
t'ote; Ti çë tue kërkuar vetëm të  
mirën e shpirtit t'ënt e t'atireve  
çë rrojën në errësirë, shkëlqjeve  
për urtësi mendie e për bardhësi  
zëmbërie si një diell çë ngë perë-  
ndon kurr e me shembughin t'ënt i  
dhe dritë gjithë jetës; parkales  
t'en'Zonë për ne sa t'na japënjë  
hir të të glasiëm tëmarrësia e  
zëmbres, te dashuria çë Ti pate  
për gjinden, te fortësia çë Ti dë-  
ftove kur derdhe gjakun për të  
vërtetën. Bëj Ti, o i Shjet thav-  
masor, sa edhe na të kemi fukjin të  
rrojëm në shejtëri të besës edhe  
kur ndodhemi në mes të shokëvet më  
të kekjë: të mos t'jemi kurr të  
pushtuar nga lajkat e armikut;



Perëndi, i vërtet, parkales Atë për  
 ne sa t'kemi hir të të glasiëm Tij  
 e si edhe Ti që u duke gjithëve  
 një David i ri, të skomollisiëm pu-  
 shtetin e hyjnin e t'in'Zoti më  
 shumë me të bëmat se me fialët që  
 dija herë shkojën e venë e ngë zën  
 vent te zëmbat e thata si guri.

Fëj Ti, o i Shejti thavmasor, sa  
 edhe na me një gjellë të pafajshme,  
 me një durim të veçant, me punë të  
 shejtëruara, t'i mbilliëm gojën ati-  
 reve që po shajën besën e vërtetë.  
 Bëj Ti, sa edhe na të kemi fukji  
 të mënd't'dhunonen ata që duan të  
 kjëndrojnë nën sgjedhës e të ligut  
 e të bien mbë glunjë tue lipur ndë-  
 jesë për fajet e'tire ata që kanë  
 fatin e mirë të shohiën dhromin e  
 drejt e të ndëlgojën se ngë mënd'  
 t'jet një Perëndi më i math se Pe-  
 rëndia jinë, se një i vetëm isht  
 Perëndia që bën famasmë të parrë-  
 fieshmë.

Ati jinë... Lëvdi past...

Të falemi....

III - O i pamunduri i Shën Gjerkjë,  
 që tue shtipur me kalin e mbrimur,  
 e tue vrrar gjalpërin'ë zi me shtie  
 zën e tmeruarë, përmise mbretërin

IV - O i pamunduri i shën Gjerkjë  
 që tue shtrënguar të mahkuamin të  
 skomollisiëj me gojën e 'tij se ishën  
 ishën të gënjeshtër e të rremë atë  
 statulla të falura e të përfalura  
 nga të pabesmitë; Ti që me durimin  
 e me burrërin t'ëndë, me punët të  
 bishmë e me fialën e ëmbël shtrën-  
 govë mbretëreshën Aleksandrë të  
 bënej e krështerë e të dej mortien  
 për Zotin e vërtet më mirë se gëzi-  
 met e haret e dhet, tue rruar në  
 mëkatë; Ti që tue i glar Zotit Kri-  
 sht, pate fialë të ashpra e të rrë-  
 mbieshme kundra atireve që kishën i  
 si e ngë dejën të shihiën, kishën  
 veshë e ngë dejën të gjegjeshën; po  
 u dëftove i but e i mirë me të t'  
 jerët që tue njohur tek Ti Deshmo-  
 rin e Skomollerin e të vërtetës,  
 me pagzimin shejt deshën të kishën  
 lar shpirtin sa të leheshën pameta  
 në krushkji të Perëndis; parkales  
 për ne e ruana nga çedë sëmundë të  
 shpirtit e të kurmit. Bëj Ti, o i  
 Shejti thavmasor sa edhe na të kemi  
 gëzimin të të helkjëm te vathi i të  
 sgledhurve atë që janë si dele të  
 sbierra të përitaria në pus nga ul-  
 ku mizor; edhe të vijëm pran gjithë  
 bashkë te vendi i lumëris tek u je  
 Ti, tek e drejta e të lartit, për

arruri hera jote e dishiruarë sa të mbëjidhie degën e mundies, pate kriet prerë me një shpatë; parkales për ne sa të kemi Kukji sa të durojëm paj t'in'Zoti ata pakë mundime që neve na duken të rëndë shumë, po që përpara atireve t'atëvet mëndë të thuhet se janë mosgjë fare. Bën Ti sa edhe na, pas luftavet që luftojëm për dita me tre armikjët më të mëdhenjë të shpirtit t'ënë, të dajëm fakjebardhë si edhe Ti, e të fitojëm pran për gjithëmonë atë kurorë lëvdije të pleksurë me dhafnë e me lule që ngë veshken kur.

Ati jinë... Lëvdi past...

Të falemi.....

### PARKALESI'

O i bukuri i shën Gjerkjë, kur Prindrat t'anë u pan shkelurë nga Turku, e ku' klenë në rrëzik të sbiriën besën, u pruarën tek Ti e Të lipën ndihmë.

Ti i ruajte ata trima të mjerë e i mësove dhromin e këtire vendeve teku jerdhën e stisën këtë horë.

Ata ngë të harruan kurr e të sglodhën për mburonjës e për ruanjës të horës, e të parën Klishë që stisën ja falën embrit t'ënt të

Parkalese të ndënjë dorën e 'Tij të pushtetëshmen mbi dielmët T' anë që venë luftarë sa të mbrojnë At-dheun, mbi ata që nisen\* të shërbejnë bukën me gjak e me djersë, në vende të huaja e në mes të një gjinde të panjohurë.

Parkalese të njomënjë zëmbat e njerëzëvet sa ata të duhen si vëllezër njeri me t'jatin, të japënjë dritë prindrave sa të dinë të mësojnë fëmijën ashtu si nget; të japënjë dritë të vegjëvet të marriën veshë të jatin e të jëmën e të mëdhënjëtë e më të dishmitë e gjithë ata që në këtë jetë janë në vent të t'in'Zoti.

Parkalese për ata që janë të sëmurë, për ata që ndodhen nën Ligjës e këtij dheu, për ata që vuajnë e që dergjen në hjidhi e për gjithë ata që lipiën ndihmë e që kanë besë të fukjia e të pushteti i kjielliës.

Bëj Ti sa na të rrojëm me shejten dre e t'in'zoti, me besën e dashurin e të krështerëvet, se vetëm shtu mëndë të kemi pakjen e shpirtit e të mirën e kurmit të kjo jetë e shpresën të trazhgojëm me Tij në Parrais për gjithëmonë Ashtu Kloft. ♀ e venë atëje posht e andidherash.

Nderi i t'Arbëreshëvet  
Ndihma e Horës t'ënë

Kjenkji i t'in'Zoti,çë mëkatët  
e jetës ndsier.

-Ndëjena,o i Madh'in'Zot.

Kjenkji i t'in'Zoti,çë mëkatët  
e jetës ndsier.

-Gjegjëna,o i Madh'in'Zot.

Kjenkji i t'in'Zoti,çë mëkatët  
e jetës ndsier.

-Lipisi për ne.

### A P O L I T I K J I

Si Lironjës i shkllavëvet e i të  
vapëkjëvet ndihmëtar,i të sëmur-  
ëvet jatrua,i rregjëravet nërlu-  
ftar,o flamurar i mundësis,Desh-  
mor i math,o i shën Gjerkë,lutu  
Ti Krishtit Perëndi,të na ruanjë  
shpirtrat t'anë.

### K O N T A K J I

I rritur me kujdesin e Perëndis  
u dëftove kopshtar i prëndeshëm  
i luftësis,tue mbëjedhur për Tij  
hjaravole virtutësh;se Ti tue mbi-  
ellë ndër lotë,kuar me gëzim;tue  
luftuar me gjak ke mundur me Kri-

shtinë me parkalesitë t'ote, o  
i shën Gjerkjë, Ti bën të kemi  
të gjithë, ndëjesën e mëkatëvet.

KËNKA E SHËN GJERGJIT

Të falemi i shën Gjerkjë,  
o nder i math i jetës,  
Deshmor i të vërtetës,  
i gjalpërit armik.

Të falemi e përdita  
të lutemi tue thënë:  
o ndihma e Horës t'ënë,  
mos lena në rrëzik.

Kulshedra akjë e tmeruarë  
çë Ti lavose e preve,  
la farën çë edhe neve  
të kapnjë po kërkon.

Po dilna Zot si dolle  
të mjerës Margeritë  
çë klaj e natë e ditë  
te buza e t'errëtit honë.

Si nj'ëngjëh i Parraisit  
ju duke te ajò herë;  
tue rrijtur vajza e mjerë  
e lidhurë e pa shpresë.

Ailimanò të thirri  
o trim i ri, shpëtomë!

Mos trëmbu, o vajzë e njomë,  
në Perëndi kij besë.

Si një rrufë e rrëmbieshme

mbi bishën u vërvitë  
me shtizën e godite  
të tsoftë e le në vend.

U shkund ahierna toka  
u hapën ret te kjielli  
m'i bukur shkrepi dielli,  
gjith'jeta bë gazment,

Disa nga të pabesmitë  
për Tij u krishtëruan,  
të rremen e mohuan  
zun fill të shihën dritë.

E idhujitë Ti prishe  
e gjithë atò faltore  
ku digjeshin thërore  
të ligut natë e ditë.

Më kot Diokletsiani  
të ndokji e të mundoi  
më kot ai t'argoi  
të lëje Zotin Krisht

Se një kle fiala jote:  
besonjë te Shën Trinia,  
besonjë te Perëndia  
çë n'Trish i vetëm isht.

Kështu në kjiell u hipe  
teku me nder e hjë  
trazhgen, edhe për ne  
dajtimin ngë kursen.

Ndër t'jerët  
e dijti Kastrioti,

çë n'ember të t'in'Zoti  
luftoi me turkun kjen.

Te ku gjëmoj më e kekje  
e madhia luftë e parë  
pa Trimi di luftarë  
çë prijën në fitim.

Te ata i lëvdoshmi njohu  
di mbronjësit e'Tij  
shën Mitrin edhe Tij  
kaluarë për në shpëlvim.

Ahierna ngrëjti shpatën  
e thirri: Bini trima,  
pikoni si shkrepitima,  
me në lufton in'Zot.

Sa ka ç'e thom, Arbëreshët  
mbi Turkjit u lëshuan;  
i vran e i shungulluan;  
e bëfshin edhe sot!

O i Shejti thavmasor  
Ti ndihna të kudsojëm,  
e vendin të shpëtojëm  
nga ajò kulshedhrë e shkretë.

Të jet nga gjindia e lirë  
i falur me hajdhî,  
i larti Perëndi,  
nani e për motë e jetë.



U D H A E K R I K J E S

Në embër të Atit, të Biri e të  
Shpirtit Shejt. Ashtu kloft.

Ati jinë... Lëvdi past....

Rrij e Jëma e përlotuarë  
Afër Krikjit e helmuarë  
tek'i vdiste vierre i Biri.

Bëj të kem, o e shën Mëri  
gjithë lavomët në këtë gji  
ç'in'Zot pati si njeri.

Mbeta e parë

Na të falemi, o Zoti Krisht e Të  
bekojëm - pse me shejten Krikjie  
Ti shpërbleve jetën.

Përpara sivet, o të krështerë, na  
kemi gjikatorën e Pilatit. Në  
mes t'armikjëvet që bërtasiën  
e lurijën se E duan vrrar, që e  
shajën e E nëmiën, Zoti Krisht me  
duart të lidhura me tërkuzë, rri  
tue mbajtur sit te dheu i sbet,  
i përgjakëm, pa fukji. Nga kriet  
t'shejt të shpuar me glëmba i ku-  
llon gjaku për në ballit e për në  
fakjies; mbë çëdo vend të kurmit  
ka nishët të zi e të murrët për  
shkupinjëtë që ka pasur. Disa  
të likjë e padisiën e e ngalesiën

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi vendin tek Krishtit i dhanë Krikjien t'ë kjellëj. Ai e merr mbi krahët me durim të math, megjithëse ajo është shumë e rëndë e megjithëse Ai ng'ja bëj më të rrij shtuara. Krikjia për Atë është si kujtesa e dashurisë s'Tij; si flamuri i lëndis që ka të prinjë gjithë gjinden e krështerë tek e shke- ta udhë e djellës. Ai e nglakon me gëzâm atë barrë të tmeruame dhunie, e sikurse thot: të kam përitur, të kam dishiruar, të kam dashur.

Me atë Krikjie që nglakove barrën t'ënë lehtësove;  
nga këta krahë, o Zot, e ndsore  
e mbi Tij me pakjia e more.

Zoti Krisht....

Ati i jinë... Lëvdi past...

O sa hokji e sa duroi  
sa të kekje ajo pesoi  
për të Vetëmin e 'Saj!

Bëj të kem...

### Mbeta e tretë

Na të falemi, o Zoti Krisht, e të bëkojmë - pëse me shejten Krikjie  
Ti shpërbleve jetën.

Na të falemi, o Zoti Krisht, e të bekojëm .....

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi t'ën'Zonë-çë përpikjet me të dashurën Mëmë. Ajo e mjera sheh të Birthin, Dialin çë kish'ngrohur me ahtin e gjirit t'Saj, për të çilin kish'pasur akjë dre kur Erodhi i parë e kërkoj; për të çilin kishë klar akjë kur e sbori për tri ditë në Jerusalin, e sheh e mjera ndër mes t'armikjëvet çë e kjelli-ën sa t'E vrsiën; e sheh gjithë gjak çë te kriet njera te këmbët, të përkjeshur e të nëmur nga gjithë gjindia. E Ajo ng'ishtë e zonnja t'i kjaset, t'e përkjafonjë, të e puthënjë, t'i fshinjë edhe një pikë diersish. Ahieraa ndien se një shpatë i shpon zëmbërën te një anë e nj'etrë. E vërren pa folë, kjëndron në vend si një tsopë gur e ng'i derdhet më një lotë nga sit I pa-rrëfieshëm ishtë helmi i'Saj!

Bir e Mëmë në hjidhi  
 për të nëmurin njeri;  
 tue par juve zëmbra jime,  
 zë e vajton e shtie rëkime.

Zoti Krisht....

Ati jinë....Lëvdi past...

Nga një burrë me dhëmbin  
pate ndihmë, o Zoti i jini,  
e kur këtë fat të kem  
ndihmëtar i jit të jem?

Zoti Krisht...

Ati jinë... Lëvdi past...

Kush pa lot'mënd't'kish kjëndruar  
në i kish'nar akjë t'trishtuarë  
Mëm'e Bir ndër të këkjia.

Bëj të kem...

MBETA E GJASHTË

Ná të falemi, o Zóti Krisht,...

Përpara sivet, o të Krështerë, na  
kemi atë grua me zëmbërë të mirë  
çë ndër mes t'ushtarëvet e t'Judhe-  
njëvet të tërbuarë shkon pa u trë-  
mbur megjithëse ata kërkojnë t'e  
ndalojnë e t'e përzëjnë me fialë të  
liga e me purtekata. Ajo shkon ndër  
atë shumizë e ndër atë tufë burrash  
të egërsuarë e i kjaset t'in'Zoti  
me lotët te sit e me një napë i  
fshin fakjien shejtë të ndçurdhi-  
kjurë me gjak, me djersë e me botë.  
E i Madh'in'Zot deshi të paguaj mi-  
rësin e'saj e i la te ajo napë një  
shenk të paçëruashëm dashurie, për-  
çë i la fitirën e'Tij të shejtë.

Oh çë mall e çë dalshirë!

Të prëmisëm përsëri  
 u Të shoh mbi dheun i zi;  
 shoh se t'ngrejën më shkupinjë,  
 e tue klar u pshrëtinjë.

Zoti Krisht...

Ati jinë... Lëvdi past...

Pa të dashurin të Bir  
 Kjenkjin shejt e të delir,  
 T'hjidhëruar njer çë vdikj.

Bëj të kem...

MBETA E TETËTË

Na të falemi, o Zoti Krisht,...

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi tekun in'Zot, tue harruar gjithë dullimet e T'ij, u pruar e i tha gravet e mira ç'i vejën prapa tue dënësor e tue vajtuar: mos klani për mua, po derdhëni lotë për ju e mbi bijët t'aj. Me këto fialë Zoti Krisht na mëson se ng'isht gjë më e kekje se mëkata; se mëkata isht ajo çë e e helmon më shumë; se nga ajo i vijën njeriut gjithë të ligat e se na kemi të klam e të lipëtm ndëjesë me gjithë zëmbërë kur e ftewiëm Perëndin se ndë duam të njohiëm e të ndiejëm mbërin e T'ij të kjo jetë e edhe më shumë te jetra.

Ato fialë çë Ti thua

I Zot i math i të tërës jetë  
 je si dielli brënda res;  
 po te buka ne të vërtetë,  
 u të shoh ne sit e fes.

Eja o Zot tue prur bekime,  
 te ki gji çë të thërret;  
 eja shejtë e zëmbres t'ime  
 bieri pakje edhe shëndetë.

I përmasur e pa fialë,  
 rri përpara teje o Zot,  
 në ndëjë e të klofsha falë  
 për gjithmonë ashtú si sot.

U nga Ti çëdótë mira  
 po pres o Krishti i jinë  
 bënë zëmbren e dëlirë,  
 jetën em të pa mbarin.

+ + + + +

2 Ashtú si kiasen dridhen  
 një dritë Parraisi u shoh,  
 sa i math je o Zot u njoh,  
 esa i nierë ë shpirti jim.

Eja o Krisht, eja,  
sshpejt eja, Isuthi jim.

Eja, o Zot eja,  
e shejtëro Ti shpirtin t'im.

Eja, Isuthi jim,  
i zëmbres je pshërtimi,  
i shpirtit je pastrini,  
u po tij diëshironj.

O Isuthi jim po eja,  
u Të pres te zëmbra jime,  
u po Tij thërres nga thime,  
o gjiella e shpirtit t'im.

O Bukë e Engjëvet, eja  
o Ti çë na u ke dhënë  
të gjithëve për të ngrënë  
eja, eja te ki gji.

O Buka shejte e kjiellit  
çë rri ne ne dit'e natë,  
eja, eja sonenabë  
të më tsishë ne dashuri.

Eja o Zot, e nos nënó,  
sa mirë në do dëftomë  
e gjiellën t'ine gëzomë  
ne shejtien dashuri.

. + + + + +

3 U Të falen e të lëvdonj,  
si Të kan te gjiri i jim;  
bashk me kjiellin Të këndonj  
në të bukurin këndim..

Që je i nadhi, që je i miri!  
e sa mirë nua në do!  
sa (é) dhurata akjë edhe hiri  
kloft, o Zot e ne pranó.

Edhé vet, o Zot, të dua në  
në që vetë koha shkon.  
Mos në le po rri me mua  
se po ti në lumëron.

Kur tek Ti të vinj ndë vonë,  
u Të pafsha ashtu si je,  
pa mbules e për gjith-monë  
të lëvdofsha me haré.

+ + + + +

4 Shunë e dashura Mëri,  
Ti në gas këtuku jan,  
më vërrën në dashuri,  
se t'ët Bir te zënbra kan.

Çë është e lüneja këjo herë,  
çësht e bukura këja ditë!



Zëmbra jine e shkretë e e mierë  
u bë throni i të Lartës Dritë

U tek Ti, o Mëri kan besë,  
e si biri të luten sot;  
Ti pëb mua po kij kuides  
të ken hir nga i Madh'in 'Zot.

+ + + + +

5. Të përujen Flija shejte,  
Flija e të madhes dashuri;  
Ti je i kjiellit psherëtimi,  
nderi i t'tërës njerëzi.

Të përmissen Flija shejte,  
Flija e të madhes dashuri.

Të përmissen Flija shejte,  
Flija e të lartës dashuri;  
Ti je i trinavet gëzimi,  
e të grinosurit fukji.

Të përmissen Flija shejte  
Flija e të lartës dashuri,  
Ti je i gjiallëvet shëndëti,  
Ti je shpresa në hijdhë.

Të përujen Flija shejte,  
Flija e të madhes dashuri,

klofshe e njohurë dhe e lëvduar  
ngushullini për gjithë njeri.

Të përujen Flija shejte,  
Flija e të madhes dashurí,  
u të falen Zot i fshehur,  
i pasosmi Perëndí.

+ + + + +

6 Të pasosmit Zot, të krështerë  
po me kënga t'i çojëm lëvdin;  
isht i fshehur në bukë e në verë  
e na jipet si i shpirtit ushkjin.

Ë përnistë e me fakjen te dheu  
tufa e bijëvet të falet me besë;  
për fajtorët që gjiaku shpërbleu  
kij të dhëmbur e derdhi ndëjesë.

Nën pështrimit prej gruri t'  
(përkryen,  
mbi të lartit e t'dritënin thron,  
nga gjithë Ëngjëjit mbreti i shër-  
bien, këto zëmbëra t'ona pushtón.

Perëndi që nga buka e bekuane  
për të dashur e pakje na flet,  
tek Ti shprejëm në jetë t'hölmuanë  
se pas luftës do t'kemi shëndët.

209

+ + + + +

7 Gjithë përurjeni na të ktështerë  
kësaj bukie ç'isht kurni i t'in  
Zoti  
gjith përurjeni na se këjo verë  
isht vërtetani gjaku i t'in Zoti.

Ti pshörtini i gjithë zëmbravet  
je, Flijë e gjiallë, bier pakjen  
mbi dhe.

Kur te Mesha këjo bukë e këjo  
verë,  
janë me fialën e priftit shejtu-  
ruarë, na besojën se n'kurnë te  
një herë  
e në gjak t't'in Zoti jan'ndër-  
ruarë.

+ + + + +

8 Gjithë lëvdojën, gjith bekojën  
Krishtin rrekj dhe Perëndi.  
Ngrëjën zërin e këndojnë  
se na pati lipisi.

U të falen kurdoherë  
Zoti Krisht i bër njeri,  
u Të shoh si buk'e verë  
po Të lut si Perëndi.

Ai në jetë u sdrip nga kjielli  
mori kurrë e u bë njeri:  
teku linë, ku shuhet dielli  
jes ne ne në Eukaristi.

Gjith lëvdojën, gjith bekojën  
Krishtin rregj dhe Perëndi.  
Ai për ne nos e harrojën  
jerdh'e leu si një navri.

Sa duroi për ne te jeta  
ne të madhe dashuri!  
Mos të sbireshën paneta  
jes ne ne në Eukaristi.

+ + + + +

9 Osanna t'in! Zoti! me zënbër  
na thoni,  
na flijën e pakjes në gjë dishi-  
rojën. Na bukën e kjiellit me b  
besen kërkojën  
p'ushkjin sa t'e keni të gjiel-  
lës te dhroni.

O Krisht për gjithmonë,  
si dië edhe sot  
Ti je Rregji jinë,  
Ti vetën in'Zot.

Osanna, osanna! Lëvdojën t'ën'Zonë

se kurmin e gjiakun na la për të  
ngrenë.  
Për gjiellën e spirtit, kur foli  
tue thënë  
kush ha nga kjo bukë ai rron për  
gjithëmënë.

Për gjiellën e gjithëve nga kji  
elli u sdripe  
o Flijë e për shejte, e na prure  
shëndetën.  
Ti jerde ndër gjinde e lirove  
gjithë jetën,  
nga zgjerdha e nëkatës e të ligun  
e shtipe.

+ + + + +

IO Isuth, Isuth i dashur  
pastró Ti zënbrat t'ona,  
ushkinin shejt dhurona bukën  
bukën e dashuris.

Isuth, Isuth, Isuth,  
gjiella jonë ti je!  
Ti rregjéro mbi ne.

Isuth, Isuth i mirë  
shpesë tek Ti na kemi,  
se bijët e tu na jeni,  
o Zot i lipisis.

Isuth, Isuth i tënbël  
gjithë njerëzit Të lëvdojnë,  
gjithë zogazit Të këndojnë  
me mirënjohie e gëzin.

Isuth, Isuth i shejt  
Tij vetëm shpirtin t'ënë  
Të truajën tue thënë  
me besë e me pendin.

+ + + + +

II O Rregji jinë, o Perëndi,  
e dhezurë zëmbra përdita thot:  
na Tij të duan - me dashuri  
se bij na jemi - o i madh'in' Zot.

Na Tij me besë po thërresiëm,  
Ti kijna lipisi.  
Tij vetëm duan se Ti je Tabë  
Tij vetëm duan se Ti je Rrekkj.

O Rregji jinë o Perëndi  
pa u lodur kurr Tij natë e ditë,  
për ne te buka - i fshehur rri,  
fukji na jep - shëndet e dritë.

Na Tij me besë po thërresiëm  
o rregji jinë, o Perëndi  
me besë na thomi të prënistë në dhe

Klofshe lëvduar - në Eukaristi,  
i kjiellit dhroni - klofshe për ne.

+ + + + +

I2 O t'krësterë, tek Isuthi  
shpresojëm  
Fisën mundi edhe nortien e ndri  
dhi, të të ligut Ai lidhiet na  
sghidhi.

Sa na deshi!  
Kjëndroi me ne.

E isht i gjallë, p'ftet i  
gjallë  
po i fshehur te buka!  
na me siun e këtij kurni ng'e  
shohiëm,  
po me besën e dhesurë e njohiëm.  
shpirti janë atië sheh Perëndin.

+ + + + +

I3 Përpara Tij prëniseni,  
o Zot e Perëndi,  
Të faleni e Të truheni  
se jemi në hjidhi.

Në e bukë i fshehurith  
pushtetin t'ënd dëfton,  
o i madhi shejt i shejtravet

Ti shpirtin na bekon.

Bekona o rregji i kjielliavet  
Ti kijna lipisi  
te jeta në nes të luftavet  
Ti ruana o Perëndi.

+ + + + +

I4 Përpara Flijës shejte  
ndihen i plot ne besë  
e zimbra jine dhizet  
kur Zotin Krisht u thërres.

O Isuth te buka i fshehur,  
Ti rri gjithmonë për ne  
ne besë u Tij të falen  
se rregji i kjiellit je.

O Flijë tri herë shejte,  
pakja e shpirtit t'in,  
përpara Tij përnisur  
u Të thërres ne dishirin:

O Flijë, Buka e kjiellit  
kurm e gjiaku të Krishtit Zot,  
eja, eja te këjo zënbërë  
çë t'përet ne besë e thot:



O Flijë, o shpëresa jime,  
rrekj, zot e Perëndi  
mirr veshë Ti lutien t'ime  
arthsha u në lumëri.

O Flijë, gjër i shpirtit  
Ti mua më jep fukji  
sa t'ligun u të munjë  
në dua u këtë lumëri.

+ + + + +

15 O i pasosni Perëndi,  
o i pushtetshmi i madh'in'Zot,  
u të lip lipisi,  
tuke derdhur sishit lotë.

Ndëjena, ndiena, o imadh'in'Zot.

Kur mëkatën u llojas,  
helmi zëmbra në mbionet plot;  
po n'gënjen i bushtri gas,  
e t'fëjenj, o imadh'in'Zot.

Dishironj të skomollisem;  
po ng'e gjenj u priftin sot.  
Tue shantijtur të lipisem,  
të më ndëjesh, o imadh'in'Zot.

Ligësin e gjellës t'ime  
dua t'harronj, e Tij, çë sot,  
dua të ken te zëmbra e jime,  
vetëm Tij, o i madh'in'ZOT.

Rrofsha edhe në varfëri,  
 ndër mos patsha e porosi;  
 po Ti kijën, lipisi;  
 mos më le ne faj, o Zot.

+ + + + +

16 Besë u kan se i madh'in'Zot  
 ndë tre vet'e ftira tri,  
 isht i vetën Perëndi.

Besë u kan Këtë t'vërtetë.

Besë u kanë se e Larta Fialë  
 erdh'e u bë njeripër ne,  
 e la gjellë e gjak ndë dhe.  
 Besë u kan këtë t'vërtetë.

Mbi të gjitha që do janë,  
 u dua mirë po t'ën'Zonë,  
 ç'isht i vet e nira e jonë,  
 e e dua mirë ne të vërtetë.

O Ti Zonja e shën Mëri,  
 shpirtin t'ënë shejtërona,  
 e Parrajsin pran dhurona,  
 te ajo jetëzë e vërtetë.

+ + + + +

17 Rregji i kjiellit që jerdhe  
 te jeta,  
 si njerinë mes neve Ti rrove,  
 vapkëzin edhe mortien durove,  
 sa t'na jipie shëndet e shpëtim.

Rregjëró, rregjëró nbi këtë jetë,  
rregji i rregjëravet, Krishti  
vun nãrikjê

Rregji je i dashuris po sa  
shkove! \* si kusar kleve vierr  
nbi një krikje, \* e për ne derdhe  
gjakun e vdiqje, \* e për ne dhe  
të sprashin pshërtin.

Rregji i helmëvet, krikjen  
ngacovë, \* glënbash pleksurë të  
vun një kurorë, \* e për të kjeshur  
një kallën në dorë. \* Oh sa riejte  
ne pakje e durin! \*

Rregji i pakjes i but edhe i  
nirë, \* dashurin fiala jote na p  
pruri, \* drita jote ndër njerzit  
arruri, \* rregjëria jote na pruri  
shpëtin. \*

Rregji i mendievet, sgjô besën  
t'ënë, \* Rregji i shpitravet,  
shpresën dhurona, \* Rregji i  
zëmbra vet, zëmbra flakrona, \*  
jipna, o Rrekj, të pasosmin  
trazhgin. \*

18 Gjith' l'övdojën, gjith' bekojën  
Krishtin rregj dhe Perëndi;  
ngrëjën zërin e këndojën  
se na pati lipisi.

U të falen kurdoherë  
Zoti Krisht i bër njeri;  
u të shoh si bukë e verë,  
po të lut si Perëndi.

+ + + + +

19 Na t'adhurojën, Krishti rregj!  
Na t'adhurojën, Krishti rregj!

Rreth krikjes s'ate me besën  
t'ënë\* ne dashuri, o Krisht, na  
Tij po thresiën;\* ubi gjithë  
gjindet eja, na Të presiën:\*  
o rregji i jetëvet, po Tij,  
po Tij duan na!\*

Ti mun, o Krisht, Ti mbretërona;  
o rregji i jetëvet, po Tij,  
po Tij duan na!

Po Tij osanna, rregji i jinë,

o Biri i Virgjërës, po Tij lëvdo-  
jën; \* na bashk me Ëngjëjit po  
Tij këndojnë; \* rregji i pashte-  
tëshëm, po Tij, po Tij duam na.

Me ndihmën t'ënde, o gjithi  
mirë, \* na të n't'errtit do të  
luftojmë, \* dritën e kjiellit  
na dishirojnë: \* rregji i përje-  
tëshëm, po Tij, po Tij duam na! \*

\* \* \* \* \*

20 Na duam t'ën'Zonë, Virgjër'e  
lume\* fialëvet t'ona pa vëri  
vesh; \* na të thërresiëm me besë  
o Mëmë, \* mallin e thellët ti  
bëna shesh.\*

Mëmë, po na fal uratën  
e gjegj kë Të thërret.  
Na duam t'ën'Zonë të kemi  
tatën, \* na duam t'ën'Zonë  
t'e keni rrekj.\*

Na duan t'ën'Zonë brënda te  
shpia,\* e duan në zëmbërë të  
gjithë gjëris,\* të jeni dhezurë  
nga ziarrri i flakët i Perëndis.\*

Na duan t'ën'Zon në vent të  
mësinjt,\* atij të dsëhet si të  
dsëhet ishtë Larta Fialë e  
njerëzinit\* në shejtin embër,  
të Zotit Krisht.

+ + + + +

21 Gjith'bekojën Kristin t'ënë  
çë kle vënë ngrikj për ne;  
gjith'bekojnie tue thënë:  
rregjërofshe o Zot nbi dhe.

Mos e shajën në t'ën'Zonë,  
nos e nëniën Zotin Krisht,  
se për jetë e për gjithmonë  
kush e nën i nëmur ishtë.

Gjith'bekojën të krështerë  
shpirtin shejt si Perëndi,  
gjith'bekojën na nga herë  
të pasosnen Dashuri.

Gjith'bekojën Perëndeshën  
Zonjën nënë e shën Mëri,

gjith'bekojnie Virgjëreshën  
tuke i lipur lipisi.

+ + + + +

22 Isuth,ndrit mendien t'ime,  
shkëlkjefshit drita jote brëndar  
neje;\* vetën ashtú do t'vinj u  
ndër gëzime\* tek ajó jetë hareje.

Ti drita jine je,  
Ti ndritënë, o Isuth.

Isuth,dhis zëmbrën t'ime:  
dhize me flakën t'ënde të pasos-  
me;\* vetën shtú ngö dó t'jet  
gjiella jine\* nga nëkata e pla-  
kosne.\*

Ti flaka jine je,  
flakëronë Ti, o Isuth.

Isuth,gjëkj lutien t'ime,  
kujtose gjakun derdhe të na  
shpërbleje;\* vetën ashtú do t'  
t'hipet lutia jine\* si livan  
përpara Teje.\*

Shëndeta jine je,  
Isuthi jin,Isuth.

23 Në llargu nesh Ti vete  
në t'errët mendjet t'ona, o Zot  
kjëndrojën: \* ngë kemi t'jerë  
ndër helmët e kësaj jetie, \*  
çë dhëtonin na dëftojën,  
veç Tij, o mëshirëplot.

Rri ne ne, o i nadh'in Zot.

Vetën nga shejtia krikje  
vien zëri çë nënd't'gëzonjë  
shpirtin t'ënë, \* nga druri shejt  
ku, o Zot, durove e vdikje: \*  
Ti gjiellën na ke dhënë, \*  
ashtu si dié edhe sot.

Rri ne ne, o i nadh'in Zot.

Eja Isuth, gjith'i mirë,  
dhis ne dashurin t'ënde zëmbfat  
t'ona, \* bukën e kjiellit ndaj te  
këjô errësirë, \* bekinin t'ënt  
dhurona, \* o Isuth, për jetë e motë.

Rri ne ne, o i nadh'in Zot.

Kjëroi shkon e gjiella jonet,  
po si era shkon e vete gjiella  
jonë, \* e n'dita, n'dita mortia  
po na kjaset, \* lum kush ka shpresë  
në t'ën'Zonë e ne gjith'zënbër s  
thot: \*

Rri ne ne, o i nadh'in Zot.



24 O Zëmbra e t'nadhrit Zot  
burimi i lipisis,  
me ziarr të dashurisë  
na dhis e flakëro.

Isuth, Isuth, Isuth,  
me ziarrin na thielló.

O Zëmbra e t'nadhrit Zot  
për njerëzit shëndetë,  
nga i ligu që na nget  
na ruajt e na shpëtó.

O Zëmbra e t'nadhrit Zot  
që jep fukji e durim  
kuj ndodhet në udhëtim  
te kjielli na drejtó.

O Zëmbra e t'nadhrit Zot  
që ngushëllón kë vdes,  
atë që rron ne besë  
me t'dashur përveló.

+ + + + +

25 Lipisi, o Zot, na gjithë të  
parkalesien\* të ruash nga armi-  
kjet të dashurim atdhë.\*  
Ruana edhe neve, gjegjëna, se të  
thërresien;

o i nadh'in'Zot. Shelbuesi jinë je.

O Zënbra e Isuthit, je flaka e dashuris, \* të thërresiëm nda ndër helme, burin i lipisis.

Lipisi, o Zot, për gjithë të nëkatruamit \* që ligjën t'ënde shkelin nat'e ditë; \* te droni i drejt, si bij ndër të bekuanit \* Ti thirri o Krisht, e gjithëve jipi dritë.\*

Lipisi, o Zot, gjithë nënat Tij të thonë, \* Ti jipna hir, o Zot, edhe fukji \* sa na të rrijën bijt te besa jonë, \* këtë gëzin dhurona, Zot, o Perëndi.

Lipisi, o Zot, na thoni plot ne besë! \* Lipisi, o Zot, na thërresiëm në hjidhi. \* Lipisi, o Zot, të lipiën na në shpresë, \* o i nadh'in'Zot, Ti kijna lipisi.

+ + + + +

26 O ju gjinde, o ju të krështerë, o të besën gjithë sa jini, ju te kopshti do t'vini ku derth gjakun Zoti Krisht.

Parkalesiëm edhë një orë  
parkalesiëm na t'ën'Zonë,  
çë te buka për gjithë monë  
e te vera i fshehur isht.

Vërreni t'ën'Zonë me zëmbërën e  
shkjerrë\* te kopshti i ullinjëvet  
ku duket i sbierrë,\* ku gjakuthi  
i derdhet, si kla po për ne.\*  
Aí sheh së nëkata te jeta  
sgjeronet,\* e kla për sa sbiren  
e zëmbra i helmonet\* për gjakun  
çë derdhet në kot për në dhe.\*

Pa shihni t'ën'Zonë me fakjen  
e sverdhurë!\* pa shihni sa lotë  
e sa gjak çë ka derdhur! Pa  
shihni sa helne e kopose duron!  
Kur miekullat shtronen, si ngriset  
gjithë kjielli,\* ashtú për fajto-  
rët skuriset si dielli\* e bukura  
fakje çë nëkata helmon.

Te hera në e zezë nën barrës e  
rëndë\* thot Krishti tue lutur:  
O Tate, në mëndë,\* llargonë këtë  
helne, Ti jipënë fukji.\* O ju  
ëngjëj nga kjielli, t'ën'Zonë  
ngushëlloni!\* O gjinde t'krështerë

ju Krishtin mendoni,\* te kopshti  
i ullinjëvet ndër lot e hëidhi.\*

O gjaku i t'in'Zoti që jetën  
burove,nëkatën Ti lajte,Ti  
njerëzit shpëtove,\* Ti derën e  
kjiellit na sbille panet.  
O gjaku i t'in'Zoti,përnisurë  
na thoni:\* nëkatën Ti lajna,  
gjithë zënbrat Ti njoni\* sa  
t'vijëm në gëzine te jeta e  
vërtetë.

+++++

\*K Ë N K A T E S H Ë N\*

\*\* M È R I S \*\*

I U të falen, Perëndeshë,  
çë je në ciza e jonë,  
e çë sivas t'ën'Zonë  
t'veni në kjiell.

Gaze e harë ti siell,  
kuj ndodhet në hjidhi  
e kuj në shpresë rri  
shpresë i dhurón.

Të thret e të kërkon  
këjò zënbërë e ngarrafosme  
çë ë gjith'e farnacosme  
e në skurí.

Zonja Virgjërë e shë mBrí,  
ne at'si çë të llambaris,  
gjithë jetën e lipis:  
ti vurna ré.

+ + + + +

2 Lëvdojën Mërin  
për ditë e për natë,  
\* lëvdojën Mërin,

ç'u le pa nëkatë. \* ( 2-herë )

Te kjielli në para  
u gjekj kjo lëvdi  
kur ndiejti për ne  
in'Zot lipisi.

\* Lëvdoni Mërin

ç'u le pa nëkatë \*

Ju vasha këndoni,  
lëvdoni Mërin,  
se t'shpiritit e t'kurnit  
jushon bukurin.

Ju djelm e ju trina  
të fortë e të shpëjtë,  
nga ditë thërritni  
ktë virgjërë shejtë.

Nga ditë t'i lutij,  
ju burra e ju gra,  
të vapkj e të kjosnë,  
kush kjesh e kush-klaj;

Se gjithve sa jeni  
na ndih e na gzon;  
me shkëjepin e saj  
gjith jetën pështron.

+ + + + +

3. Nga gjithë jeta e madhia Zonjë,  
lëvdi patshe për gjithmonë,  
ne Shelbuesin t'ën'Zonë,  
çë mbi de na solle Ti.

Lëvdi patshe ti ndër ne  
bashk me penën çë na dhe.

Gjithë kjëronjet për Tij flasiën  
e te tuat lëvdi këndojën;  
gjithë atë çë ke bër kujtojën,  
e të thonë: Lumia Ti.

O në e hjieshme se edhe hënza  
o në e bukurë se dielli;  
mosnjeri si Ti te kjielli  
nd'anzë i rri t'pasosnit Tatë.

Na Të truheni e Ti ruana,  
se po Tij për ndihmë kemi  
te kjo jetë,ku na jeni  
si të huaj e në nëkatë.

+ + + + +

4 Lëvdoni Mërin,  
o ju të krështerë;  
lëvdonie nga herë,  
se pruri lirin.

Lëvdoni, lëvdoni,  
lëvdoni Mërin.

Si lile dëlirë,  
o Virgjërë, u leve,  
për Tij edhe neve  
i Larti do mirë.

In'Zot të buroi  
me nder e me hië,  
të bukurit krie  
me hij të rrethoi.

O Mëmëza jonë,  
o zonja e bekuarë,  
të klofshin të truarë  
për mot e për monë.

+ + + + +

5 Po rroft Shën Mëria  
me të dashurin Bir,  
çë t'anët për hir,  
i pruri këtú.

Nga vendet e tyre  
Arbreshët-Shkjiptarë,  
të besës luftarë,  
i reshtin me 'të.



Falen, falen, falen Mëri.

Për besën e Zotit,  
të pasurat lanë,  
u nisën e vanë  
e jiken ne 'të.

Te nata, si nj'izë,  
i prijti ne dritë,  
e i solli në ditë  
si rezë, ne 'të.

Falen, falen, falen Mëri.

Shëndetin e pakjen  
dhuron kuj i duhet,  
e gjegjet kë i truhet  
këjo Perëndeshë.

Lëvdohu katunt,  
për fatin çë ke...  
se i dashur ti je  
nga nëme e vërtetë.

Falen, falen, falen Mëri.

+ + + + +

6 U të dua mirë  
o Shën-Mëri,

233

nga dashuri  
vura tek Ti.

Përkrahu Teje  
u dua të nbeten,  
dua të pöshteten,  
në në do Ti.

Parkales për ne (2 herë)  
Shën Mëriza e Dhit-rie  
parkales për ne.

Pa thuaj, o Virgjërë  
me nder e hje,  
në nall në ke,  
çë do ngak u?

Zëmbërën vetën,  
me t'nath dëshir  
edhé me hir,  
mënt të t'jap u.

+ + + + +

7 Me barë e me lule  
gjith'jeta pështronet.  
Nani të këndonet  
e jëma e t'in'Zot!

Mëri, Mëri, të falen Mëri.

E lehta puhjizë,  
i bukuri diell,  
e zogat në kjiell  
na griëjën sot.

O e dashura Mënë,  
i lum ai bir  
çë shpirt. të dëlir  
të falet e nkushton.

Arniku i t'in'Zoti  
përpara të dridhet,  
nënsohet e hidhet,  
ne t'ikur kërset.

+ + + + +

O Zonj'e madhe, falen,  
falen, o Mëri;  
Ti rregjeron nbi jetën,  
o Virgjëru Mëri.  
Tij Odhijitrie Mënëza jonë,  
thomi për gjithmënë:  
Falen, falen, falen Mbretëreshë.

+ + + + +

9 O Virgjërë e pa-fajshëne,  
si i pari rremp i diellit;  
ja-kënda dheut e kjiellit  
se ti sundon mbi 'ta.

Je mbretëresha e trimavet,  
je hieja ti e graris;  
i çuari i Perëndia  
të falet si edhe na.

Të falen kjiell e dhe,  
Mëri, çë faj ngë ke.

Me t'ënblin syy të bukurith,  
kur Birin t'ënt ti ruan,  
rrëfen te dora i shuan,  
mënin e'tij sbutsón.

Ashtú te shpirti i njerëzvet,  
nga helme i trazuar,  
nga faji i trubulluar,  
heth pakjen e e kthiellón.

Nga gjirh rrëzikjet ruana,  
te ku na ndodhet skota,  
e mos na le te skjota,  
ku gjëndeni naní.

Të bëjën na të duhurat,  
dëshirin t'ënt dhurona  
fukji të zünbfat shtona,  
e thirrna pran tek Ti.

+ + + + +

IO Zonjë e lartë, o shpresa e  
jonë, \* kij kuides të math për ne; \*  
nos harró se nënë je,  
e pajtona ne t'ën'Zonë.

Nga Parraisi kurdoherë  
sit e bukur'prir nbi ne;  
rrin pa Tij në frikë e dre,  
në Tij rritet shpresa e jonë..  
O Mëri, pajtó t'ën'Zonë.

Në na ndeshe dorën t'ënde,  
ndër rrëzikjet te ki dhe,  
një fukji vërtet të re  
do të ndienjë zëmbra e jonë.

Mos na le te hera e luftës,  
nos harrona e vurna 're;  
tek e nadhia kuturë,  
dhinësó për ne, t'ën'Zonë.

+ + + + +

II Bura be gjellën t'ine të  
falia,\* për gjithënonë, Mëris e  
të Birit.\* Bëra be! Te thellsi-  
nat e gjirit\* shkruajta fialën  
e s'mënd't'e harronj.\*  
Do t'nbeten te besa e t'in'Zoti,  
fialën t'ine ngë do t'e ndërronj.

Gjithasajtën gëzin edhe pakje,  
gjithasajtën kërkava te jeta;  
i kërkova e nosgjakun i gjeta;  
tuke rrahur u lodha në kot;  
vuajta shunë te nj'anë e te  
nj'etrë;\* tesh u prëjta e pushova  
për mot.\*

Si nj'ani ndëpër valat e dejtut,  
nga thëllini e nga dredha e për-  
zënë,\* njer më sot ndë rrëzik u  
kam klënë,\* po te bregu jarrura  
nani.\* Ti, si nj'ill, o Mëri, në  
përsolle\* te linani në thure  
edhe Ti.

+ + + + +

I2 Të parkales o Mëna jime  
të më bekosh nga kjielli  
zëmbren e shpirtin t'in.

+ + + + +

I3 Kur bie te dejti, aprapa malit  
dielli,\* e i vetën illi i par  
shkëlkjen të kjielli,\* Të thot  
kushdo i krështer, ne dashuri:  
Falen, Mëri.

Të falen o Mëri që je e dëlirë  
si drita e re, që shkrepni ndë  
errësirë;\* ndë kjiell, si kleve  
tek e poshtira botë,\* Ti je e  
hir-plotë.

Të lume nbi gjithë grat brezat  
Të thonë,\* e do të t' then të  
lume për gjithmonë,\* se deshi  
gjith-njeriu shpërblim të bij,  
In'Zot ne Tij.

N'edhe të duket kekj për bijët  
e njerë,\* që clan e psherëtijën  
kurdoherë,\* ndër helme e faje,  
tek i shkretë dhe,\*  
Iatu për ne.

+ + + + +

I4 O Mburonjë e Shkqipëris,  
Virgjëreshëz'e dëlirë,  
Mëna e lartë e Perëndis,  
që na jep keshill të mirë;

Ti që ruajte Gjyshtat t'anë,  
të nos sbiriën shejten besë,  
teku ndodhen edhe janë,  
Arbëreshvet kij kuides.

Kij kuides për ne të njerët,  
zokj të varfër jasht furrikut;  
kij kuides për ata t'jerët  
që po vuajën nën arnikut.

Sa t'i faleni t'in! Zoti  
po me gluhën që na dha;  
po si i falej Kastrioti  
e gjëria nga zbresjën na.

Sot edhe si kurdoherë  
një dëshir ka zënbra jonë;  
Arbëreshë e të Krësterë  
të kjëndrojëm për gjithëmonë;

Pran o Mënë, ne të mirë,  
lutien t'ënë ti digjô:  
mos na le ndë të vështirë,  
e kurr-kurr mos na harrô.

Se ashtu vetëm na ndë kjiell  
mënd't'vijën pa ndyshin,  
ku shkëlqjen pa -i-sosni Diell,  
që ngë bie në perëndin.



15 Zonjë e nadhe, Zonjë e dashurë,  
thesar plot ne këshill të mirë  
teku derdhi i Madh'in Zot  
gjithë urtë të e dituritë.

Yll i bukur, yll i lumtur,  
Ti na ruan e na dritëson,  
Ti na mban në udhë të shejte  
Ti na kjiell në kjiell me Tij.  
në

Ti shkëlqjen kjiell të lartë  
si yll i ndritëshëm natë e ditë  
çë llargon gjithë errësirat  
çë dëfton udhën e drejtë.

Na fatëzi, ler në nëkatë,  
ndër ndyshimet e vështirat  
të kesaj jetie të njeruame,  
ku do veni, kuj do t'priremi?

Tek Ti vetën, nëna e dashurë,  
isht mbështeturë shpresa jonë,  
tek Ti vetën, nënde t'gjejëm  
ndihmë e mbrojtje të sigurtë.

+ + + + +

16 Zonjë e sgledhurë je Ti  
Virgjëreshë, \* nuse, nënë, edhe bijë  
e t'in'Zoti, \* kjiell e dhe të

këndon Perëndeshë,\* e hir plota  
e lëvduashme je Ti.

Më se henza e se dielli  
llanbaris Ti te kjielli  
ne t'ën'Zonë për gjithmonë  
mbi gjithë grat bekuarë je Ti.

Je më bardhë se drita e nenatës,  
je më e hijeshme se lulet e fushes  
e në verrëjëm gjithë yzet e natës  
ngë janë yze në të bukurë se Ti.

Ato buzë që puthën t'ën'Zonë;  
vur më gas e përgëzona ndër helme  
se ndër helme na skon gjella jonë  
e gëzim vetëm na gjejëm tek Ti.

+ + + + +

I7 Kur arruri dita e thënë  
In'Zot ëngjëllin dërgoi:  
te Parraisi, o Mëri Të ftoi  
tek e larta lunëri.

Ç'nduhtë e mirë  
e fatmirë

Zonja e Virgjërë e Shën Mëri.

Kur nga jeta jonë u nise  
në t'ën'Zonë Ti u kjëllove

ne gjithë kurrin fluturove  
ndër këndine dhe hajdhí.

Ç'bukuri

Ç'ëmbëlsi

Zonja Virgjërë e Shën Mëri.

Nga gjithë anët e kësaj jetie  
gjithë apostojit u mbiodhën  
e rrethë shtetit t'ënt u hjojnë  
si t'ut gij ne dashurí.

O çë nënë

tër e lunë

Zonja Virgjërë e shën Mëri.

Varri e vdekia ngë të mundën  
se ti nëna e gjallës je,  
se nga tij in'Zot u le  
çë te jeta pruri liri.

Ti lirona

zëmbat t'ona

Zonja Virgjërë e shën Mëri.

Biri jit, o Zonjë e lume,  
të stolisi si një diell,  
Mbretëreshë të bë në kjiell  
të nderuane e plotë lëvdi.

Të nderojën

Të lëvdojnë

Zonja Virgjërë e shën Mëri.

Mbretëresha e gjithë jetës,  
gëzimi ndihma e shpresa jonë,  
gëzona, gëzona në t'ën'Zonë  
tek e larta lunëri.

Shpëresa jonë  
për gjithënonë  
je Ti Virgjërë e shën Mëri.

+ + + + +

I8 Te kta helme e ndër njerime  
Zonj'e madhe e nënza jonë,  
ti pajtona ne t'ën'Zonë,  
se na jeni bijt e tu.

Jipna pakjen o Shën Mëri,  
kijna, kijna lipisi.

Ç'kur na prure te kta vende  
na ke ruajtur te gjith'herët;  
tij të truhëni na të njerët,  
përposh shpagari na vu.

O ti Zonjë Odhijitrie,  
o ti ndihma e horës t'ënë,  
klofshe sot si edhe ke klënë  
për gjithë njerëzit pështrin.

+ + + + +

I9 Sa mirë të dua, o Mëri,  
o Zonja e zënbrës t'ime,  
ngak ti burojnë gzime,  
tek ti dot gjenj gzin.

Kan vatur tuke rrahur  
prapa të rrenes jetë,  
po kan gjetur u i shkretë  
glënba, dëmbine e helmë.

Tij vetën, o Virgjëreshë,  
u dua mirë nanë,  
vetën o Mëri tek ti  
kjo zëmbër gjen pushim.

U pakjen kan kërkuar  
te jeta ndër pëlqjine,  
çë shkojnë te një thrine,  
e zënbrën na lën të prerë.

Po vetën, Zonjë e nadhe,  
nduris dashuria jote  
për sa dot shkojnë mëtë,  
nëna jonë ti je.

+ + + + +

20. O Zonjë e Parraisit  
e bukura Mëri  
të lume të thonë  
në jetë gjith njeri.  
Falem Mëri, falem Mëri.

Nga fushat, nga malet,  
nga dejti, o Mëri,  
gjith jeta të falet  
me kënga e lëvdí.  
Falem Mëri, falem Mëri.

E lulet e penët,  
e dashura Mëri,  
e bari përjashta  
të japiën lëvdí.  
Falem Mëri, falem Mëri.

Nga fushat, . . . . .

E dielli me hënzën,  
edhé izet o Mëri,  
të rrin si kurorë,  
të japiën lëvdí.  
Falem Mëri, falem Mëri.

Nga fushat, . . . . .

Ndër helne, ndër gëzime,

oo Virgjërë Mëri,  
të faleni o Mënë,  
të ja piën lëvdi.  
Falen Mëri, falen Mëri.

Nga fushat, . . . .

+ + + + +

2I Një lule u deja t'isha  
si lulet o Shën Mëri,  
çë bukur rrin te klisha,  
të prëhen n'atë gji.

O lule e kjiellit Mëri,  
ti truajnë Birit t'ënt  
të jen një lunëri  
një lule t'kopshtit t'ënt.

U deja të isha drita  
sa plot me dashuri  
të dhizesha gjith'dita  
përpara teje o Mëri.

Livani u deja t'isha,,  
livani çë fluturón,  
sa gzinin u t'kisha  
të vija ku ti rron.

+ + + + +

22 Tij, o Virgjërë Odhijitrie  
o mburonjë e horës t'ënë,  
na ngë lodheni tue thënë:  
ruana besën, o Mëri.

Atë besë që patën lënë  
nga ata gjyshëra plot'ne nder,  
që si trina e si të krëshëterë  
shunë luftuan ne turkun zi.

Eja, o Mëne, o Perëndeshë,  
eja, o Zonjë e Shën Mëri,  
si të krështerë edhe si  
Arbëreshë,\* kijna  
gjithëve lipisi.\*

O ti Virgjërë Odhijitrie,  
që ke klënë ndihma jonë,  
o ti Mënë që t'ën'Zonë,  
jerdhe lindre e pa-mëkatë.

Bën ti neve të na vinjë  
drita e shpirtit lart nga kjielli  
si na shkrep edhe nga dielli  
drita e dritës nga nenatë.

Tek ti, Virgjërë Odhijitrie,  
tek ti prireni e po thomi:



Te kësaj gjellie te dhroni  
jipna dritë edhe fukji.

Na fukji e dritë kërkojëm  
sa të rrojëm te këjo jetë  
po ne besën e vërtetë  
në të Lartin Perëndi.

+ + + + +

23 Prir sit nbi jetëzën  
o e madhia Zonjë,  
se sot e gëzuane  
do t't'nderonjë;  
edhëu i gëzuarith  
thom në haré:

Shën Mëriza e Dhitrie  
parkales për ne,  
o Mëmëza jonë,  
lutu për ne.

O Mënë e t'ënböl,  
e butë, e mirë,  
Ti për gjith'njerëzit  
ke mëshërirë,  
Ti për te dashurit  
te nira ke.

Te gjalla e luftavet

gjithë kardoherë  
Tij po të truheni  
na të kështerë;  
se shpresa e gjithëve  
se ndihma je.

Zonj'e Parraisit  
Shë Mëriza jonë  
Horën e Arbëreshvet  
ruaj për gjithmonë.  
O Mën'e dashurë  
Ti vurna re.

+ + + + +

24 Zonj'e madhe Perëndeshë,  
Mëma jonë na të thoni,  
i Parraisit Ti je dhromi,  
Zonj' e lume Virgjëreshë.

Falen, falen, falen,  
Mëna e Perëndis.  
Falen, falen, falen,  
zëmbra jonë këndon.

Mëna jonë Ti ke klënë  
ndër të kekje e ndër të mira,  
Ti je shpresa edhe ënbëlsira,  
gjella e gëzimi i zëmbres t'ënë.

Parraiss ku e lune rron  
ke kujtuar se bij na jemi,  
çë tek Ti nështriniq kemi,  
e ne kjiellin na pakjëtón.

E ke jardhur disa herë  
e u ke sdripur te këjó jetë,  
e u ke parë ne të vërtetë  
ndër të vapkjë e ndër të njerë.

E në Fatinë një ditë  
tre të vëgjëve delnerë,  
djeln të vapkje edhe të mierë,  
Ti ju duke si një dritë.

+ + + + +

25 Falem, Mëri, i të njerëvet  
pështrini, \* Ti shpres'e gëzim  
i të helnuanvet je; \* Tij na të  
thërresiën, o i hirevet burini, \*  
o Mëna e Krishtit, lipisi për ne.

O Mëna jonë, ne ne të njerë  
pakjëtó t'ën'Zon, !Falem.

Falem, Mëri, çë rregjëron te  
kjielli, \* e të Krështerëvet  
Ti ndihna je; \* dritën e shpirtit

jipna Ti se je dielli,\* çë nga  
Parraisi dritë shkrep nbi ne.

Falen, Mëri, Ti fukjia jonë ke  
klënë,\* Zonja e Parraisit, dreja  
e Pisës je;\* nbajna nën shpagarit  
për gjithë nonë,\* e kurdoherë  
prir syun t'ënt nbi ne.

+ + + + +

26 O Ti Mëne e nadhia Zonjë  
Ti ngak u përret dashuri.  
Eja, aja ndë ktë gji,  
eja, o Mëne, eja o Mëne të  
rregjërsh.\* ndienj u dhezur  
zëmbërën t'ime\* e Tij vetën  
dishironj.

Mirë të dua, o Mënëza jine,  
mirë të dafsha, o Shën Mëri.

Ti si drita çë shkrep menatnet  
te këjo jetë gëzón gjithë njeri,  
si rremp dielli te ki gji,  
eja, o Mëne, eja o Mëne të në  
gëzosh.\* Sa isht gëzini i  
zëmbërës t'ime\* nga menatë të  
kujtonj.\*

Ti ndër helme e ndër kopose  
Zonja e Virgjëro e shën Mëri, ri,  
pakjen biernë e këtë gji  
eja, o Mëne, eja o Mëne t'ngushë  
llosh. \* Kur sbut zëmbren t'ime  
gjith koposet u harronj.

+ + + + +

27 Falem Mëri, e hir plota;  
in'Zot ë në Tij, bekuarë Ti  
je nbi gjithë grat e bekuar  
isht pena e gjirit t'ëntë  
Iisui.

E Shën Mëri, nëna ë t'in'Zoti  
parkales për ne të nëkatruamitë  
nani e te hera e vdekjesë t'ënë.

Ashtú kloft.

+ + + + +

+ + + + +

+ + +

+

K Ë N K A T

E

K R I S H T L I N D I E S

1  
 I Kur te jeta in'Zot u le,  
 dimbër ish'ne borë e shi,  
 kjielli e toka bën haré;  
 sosi nata e dita u gdhi;  
 zuri fill një kohë e re;  
 zu një t'jatrë mbretëri  
 e se u ngush e larta be,  
 shejtit Zef për nartiri,  
 Zoti u duk në tri llojë,  
 dialë, plak e trin i ri.

Mirë se jerdhe Ti ndër ne,  
 o i Pasosni Perëndi;  
 u,ne glunjëzit ndë dhe,  
 Të lëvdonj ashtú si di;  
 se i vërteti Zot Ti je,  
 çë na pate lipisi.  
 Për të dashur kjiellin le,  
 deshë t'bëneshe njeri  
 se të ndridhurë na pe,  
 ndë të keje zotëri.

Patshe nder ashtu si e ke,  
për gjithëmonë, o Shën Mëri,  
për të sterksurit që dhe,  
sa të kishën na liri.  
Me një fialë që ti the  
u hap kjielli përsëri.

+ + + + +

2 Te këjo herë kush ngë kla,  
shën Mërizën ng'e do nire,  
e për Zefin nall ngë ka;  
po dëftonet egërsirë.  
Brënda ata ng'i do njeri,  
bën tëtini edhe bie shi.

U ju luten për t'ën'Zonë,  
gjithve sot ashtu si di:  
të di shokëvet një angonë  
falni ju, te t'vaktat shpi;  
nos e lëni jasht këta mnorë  
se mbërdhin e reshën borë.

Virgjëreshën e nire,  
që ka t'siellnjë Zotin Krisht  
pëllumbeshën e dëlirë  
mirrni brënda dashurist;  
mirrni Zonjën shën Mëri,  
me kujdes e lipisi.

Eja, o Zonja e shën Mëri,  
me njeriun kuj kleve e truarë;  
sillmë Zotin Perëndi,  
te këjo shpi, të jet e uruarë.  
Ndsitó pran e bënmë hir,  
ktu të lehet shejti Bir.

+ + + + +

3 Punë e madhe ç'isht këjò  
edhe nata ditë u bë;  
u gëzuan gjithë zënbrat vo;  
dimbri shkoi edhe ng'isht më,  
e gjithë jeta bën harë;  
lule e penë për në dhe.

Çë shërbes i math kil  
ndër 'ta thone kjielli e dheu;  
Zoti i jinë u bë njeri,  
nga një nëmë e virgjërë leu,  
te një e ftohtë e e vrëret shpellë  
shpellë,\* prap njeriut të jap  
japënjë gjellë.

Leu përjashta e jo ndë horë  
leu ndër male e gorromina  
leu nën shiut e leu ndë borë;  
lidhur kle me di skutina;  
leu ndë kashtë e ndë sanua  
për kë i njohshin ngë u dëftua.



Posa leu te i vrëerti lekj,  
n'abë vend akjë të shkret,  
një këndin nga ljielli u gjakj  
past lëvdi Zoti i vërtet,  
e te mirët posht në dhe  
patshin pakjie edhe harë.

Virgjëresha e shën Mëri  
posa leu i madh'in'Zot,  
e shtrëngoi te i bardhi gji,  
e,ne sizit plot na lotë,  
tha:s'kan t'jetër të të nkonj,  
po këtë sisë,e t'e dhuronj.

Burri i urt i shën Jusepi,  
posa leu Perëndia,  
dhezi ziarrin,e kur shkrepj,  
mori e u pruer nga shën Mëria,  
e i tha: Jipmë një skutinë,  
të ja ngroh,se bëri tsinë.

Deshi dialin pran në duar;  
zu t'i bëj disa haidhi,  
tuke e mbajtur ndë krahruar,  
tuke i puthur ballë e si;  
tuke i thënë: Zoti i jin,  
u Të falen ne gëzin.

+ + + + +

4 Zonja e lume eshën Mëri  
u vu diallin të këndo, j,  
e i rrëfiej, me lot' në si,  
gjithë ato që kish të shkoj;  
e vërrej edhe i gëzonej,  
e në mall gjithë zënbra i mblonej.

Dox past e Shën Mëria  
nga gjithë ditë e natë  
Dox past e Shën Mëria  
çë leu pa-nëkat.

Bir i jin, o zënbra e jine,  
dialë i vogël, Zot i math,  
në Ti do t'flësh një thrine,  
u në duar të nbanj ditsath;  
pran, o Bir, kur të kjellon,  
Mëma e jote të këndon.

O ju flamura të t'in'Zot,  
Engjëj shejzera, në ças,  
të gjithë ejani këtë sot,  
sa të bëni lodrë e gas.  
Të këndojmë isht kjo herë  
se Isuthi do t'na flerë.

+ + + + +

5 Shën Mëria tue kënduar  
nerr të birin e e kjëllon;  
e n'i thot mbë të djepuar:  
flëj, o Bir, edhe bën on.

Oh sa i bukur ti në je;  
oh sa i hjëshën, biri i jim!  
Siri i jit në jep haré;  
në nblon shpirtin me gëzin.

Flëj, o i dashur, e nos klaj;  
rri ndë prëhërt; nos bën vaj.

Dialë i vogël, Zot i math,  
në çë t'shoh, në fort të dua;  
rri te gjiri i jim di-tsath,  
nos shantij, në në do mua.

Perëndi e njeri i vërtet,  
për të marririn fajtuar,  
deshe të vije te kejo jetë,  
ku do t'jesh akjë i helmuar.

Flëj, o i .....

Biri i jim, i larti Bir,  
nani flëjëmë pa mendim;  
mënës t'ënde bën këtë hir,  
se në pran s'do t'ken gëzim.

Oh sa helme do t'duronj!  
sa lavonë te ki gji!  
Thom se ahierna s'mënd'të rronj,  
kur të t'shoh te abó hjidhi.

+ + + + +

6 Kur shën Mëria,  
te e ftohta shpellë,  
ndë natë t'thellë,  
Jesuin na dha;  
Me shejtet duar,  
mbë krah e muar,  
e përgëzoi  
edhe e këndoi:

Të lut, o Bir,  
me dashuri,  
si Perëndi,  
i jetës Zot.

Çë t'math shërbes  
shoh e kan besë!  
Atë çë m'bëri  
U bëra sot.

Kush mën t'e thoshëj!  
kje faremiri  
i pa-kufiri  
te djeba rri.

Si i vogël dialë,  
çë ngë ka fialë;  
si edhe një i vapkëth,  
një Perëndi.

+ + + + +

7 Kur dimbri ish'i kekj edhe  
më i vrërët,\* u leve o Zoti i  
jim, te një kalive.\*  
Jo ndër gjinde;  
Ti jerdhe linde,  
po ndër kafsha e te një grazhd.  
O Perëndi,  
ktë punë e bëre ti për dashuri!

Përse te gjiri ji jim ngë des  
deshe të vije,\* me gjith se e  
fala Tij me besë të madhe?  
Eja u prëj;  
tesh eja flëj  
te kjo zëmbërrë, si ndë shtrat.  
O Ti ç'u dua,  
përse t'akënda të rrish  
mbi tsa sanua?

O ju të lum'o ju të lumë  
gjithmonë,\* delmerëzit, çë pat,  
te nata e madhe,\*

po si dialë  
të Lartën Fialë,  
më të bukur se një dritë,  
e me dëlirë  
ndë dhet Parraisin pat  
te kjo fitirë.

+ + + + +

8 Një ditë u vet llojasia  
për tij e thash:përsé  
e Larta Fialë,  
përsé,në thua,j,përsé,  
o i madhi Vasilé  
u bëre dialë?

I nokërrith u bëre,  
sa mënd't'hijeshpjt  
në këtë gji.  
Po zëmbren ne do,  
përsét'e narrsh e do  
me kuëeri?

Zëmbren,o Zoti i jin,  
në mos t'e dhënsha u,  
mirre pa hir;  
mirre e gjithmonë nbe,  
se Tij të nget,çë je  
Zot e Sotir.

+ + + + +

9 Gjithë e jani gjinde,  
të lusin këtë dialë;  
Pa e sosmeja Fialë  
në jetë u bë nish.

Thot: ngrëhij delnerë,  
e kjiellit përzita;  
në e bukur se dita  
kjo natë u ngris.

O natëza e bardhë,  
çë zëmbren t'ënë  
gëzon si kle thënë  
nga i Larti Profit.

O natë e bekuarë  
kur Krishti na u le,  
se Virgjërë e re  
na soli mbë dritë.

Nga fushat, nga malet,  
nga bora, nga vapa,  
nos nbahij aprapa,  
se gjithve na thëret.

Mos rrini ndër helme;  
nos kijni nbri;  
se ligjë e liri,  
u dukën në jetë.

+ + + + +

IO Nga kjielli Ti u sdripe,  
o mbreti i jinë,  
e jerdhe te një shpellë,  
ndë borë e tsinë.  
O i bekuan, o i lëvduan,  
të më dridhesh u të shoh.  
E Larta Fialë,  
përse më deshe mirë  
u bëre dialë.

I jetës je i Zoti,  
se vet e stise;  
e t'linda e ziar të lipsen,  
e më lipise.  
O i dëlir, shejti Bir,  
zieja jote zënbrën nget.  
Po mua m'akënda,  
se malli i math për njerëzit  
të pru ktu brënda.

Kur Ti te gjiri i nëmës  
duke i kjëlluar,  
ngë flë jo zënbra e jote,  
se po rri sgjuar.  
Çilini, Perëndi,  
çë mendon, pa thuajnë Ti.  
Kush mënd't'e dij!  
U thom se më përgjegjë:  
do t'vdes për Tij.



Në ti mendon të vdeç,  
o Zot për mua;  
kë t'jatër, jashta Teje,  
u kam të dua?  
Virgjëreshë, o Perëndeshë,  
në e dua pak u birin t'ent,  
nos kij mbëri,  
po duaje ti si duhet,  
ne vet ngë di.

\* \* \* \* \*

II Këndojën, këndojën  
se kjielli u sbëlli,  
gjithë bëjën haidhí,  
gjithë thomi ne gëzim.

Po rrofshit Isui,  
si rrekj e si zot,  
po rrofshit Isui  
për jetë e për mot.

O i dashuri Dialë  
nga kjielli për ne  
Ti sdripc ndë dhe  
ndër borë e tētín.

O i bukuri Dialë  
Ti pakjen dhuron

Ti zëmbtrat na gëzon  
se prure shpëtim.

O i vogëli Dialë  
i math Perëndi,  
beko gjithë njeri  
edhe shpirtin t'in.

O i hjieshni Dialë  
i Virgjörës Bir,  
Ti sizit na prir,  
o i hirit burin.

O i prituri Dialë  
o Zot i vërtet,  
o i Engjëjvet mbret,  
mirr vesh këtë këndin.

+ + + + +

I2 Rregji jim,  
Isuthi jin,  
Dialë i nokërth,  
ndër tëtini  
jerdh'e leve  
bër njeri  
te një kalive  
si mavri.

Flëj, o bir, e nos klaj;  
flëj, o zënrë, e bën on.

Mbi tsa kasht  
te një grasht  
Ti je snardhur  
skur se jasht;  
lipset ziarri  
dëshur je  
e tëtinit  
vdes për ne.

Të përzon,  
Të këndon,  
Mëna jote të kjellon,  
Nga gomari e nga një kje,  
ne aht e frimë  
ngroht je.

Nder, o Zot,  
t'japiëm sot,  
si delneri  
çë na thot:  
se vërteta je  
Perëndi  
e vërteta  
je njeri.

+ + + + +

13 Flëjëm bukur dial'i nokërth,  
flëj më duar, rri në gji,  
ng'ë për Tij diebë e stoli,  
çë ndesën jeta e kjiellia jep.  
As rrëpira, as trikjinia  
sa t't'trëmbënj ngë isht dre.  
Drita jote kjiell e dhe  
gjith fiellon e bënet shkjep.

Flëjëm, flëjën, zëmbra jine,  
mos më klaj, ti bëjënë on.

O ju dieln, o ju fënijë,  
tek in'Zot në gëzin po rridhni,  
ju këndime jetsi e sglidhni  
zëmbren jipni se Ai e do.  
Kënk'e re zëri i t'ënbël  
ka këndojën për gjithmnë  
zëmbra e zezur për t'ën'Zonë,  
jipet gjith e kurr thott jo.

Lumë fënija në gas shejt  
lunt'ata çë janë të drejt.

+ + + + +

14 O që natë ne bukurë se dita  
kle nata kur leve!  
O që dritë, o që gëzim, o që pakje  
na prure Ti neve!

Ndër hjidhi njerëzia për sa mot  
për sa vietë Tij të priti  
e Ti jerdhe ndër ne shkrepit  
gëzim bashk me illin ç'na ndriti.

Flëjëmë, flëjëmë,  
flëj, o bir, e mos klaj, kij durim  
ziarr ngë kemi e Ti ndien tëtëm.

Flëjëmë, flëjëmë,  
ipna, zot, dhizna Ti te ki gji  
si një ziarr dashuri.

Madhëro shpirti jim e lëvdó  
Perëndin t' Lartën Fialë  
çë për ne në këtë jetë  
nori kurn  
e na u le si një dialë.

Madhëro shpirti jin Zotin Krisht  
të madhin Zot njerëzuar  
bën haidhi ti, lëvdi dialit të  
ler, \* mos u loth tue kënduar.

15 E fiellët isht nata si dita,  
nga kjielli na mblen edhe drita:  
të vini, të vini, ju gjinde, të  
shihni\* këtë shpellë ku Krishti  
u le.\*

Njeri u bë për ne e Larta Fialë  
i nokërëth Ai leu si një dialë,  
i kjiëshën, i bukur e i mirë:  
gjith' rridhni, delnerë, të  
vini me gzin.

Ju bini kambanë, ju bini ju bini;  
e thrini gjith' gjinden te in' Zot.  
Ju bini kambanë, ju bini, ju bini:  
na leu Shelbuesi sot.

Din Don ( 8 herë )

Na jerdhi shpëtimi, na jerdhi,  
gjithë hiret mbi jetën i derdhi  
të vini, të vini, ju gjinde, të  
shihni\* ju rregjin e kjiellit  
mbi dhe.

Ai pakjen e shpirtit na pruri,  
e zënbrat të thata si guri  
i njomi dhe i sgjoi nga gjuni:  
gjithë rrodhën ne t'nath dishirin.

Këndoni, të krështerë, këndonj,  
t'pabesmit po trini, po thoni:  
të vini, të vini, ju gjinde të  
shihni\* të madhin t'ën'Zonë  
ndër ne.\*

Ju besën te zëmburat do t'kini  
me shpresë të madhe dot t'vini  
te gjella, te njallia, te e'fteta  
sa t'gjëni t'pabesmin trazhim.

+ + + + +

I6 Rroft, po rroft rregji ç'u le  
Perëndi e rrekj me pushtetë,  
ç'si njeri jerdhi në jetë  
e u bë i nokërth për ne.

Rroft, po rroft i pakjes nbreti  
çë ndër gjinde pështrim ngë gjeti  
po si zogzë pa folë  
te një shpellë ndër t'ftoht u lé.

Rroft, po rroft rregji ç'u le  
rregji i jetës për gjithmonë  
Zoti i math e gjella jonë  
çë shëndetën pru në dhe.

Rroft,po rroft se mbel si dielli  
rregji i jinë që vien nga kjielli  
së na duk një drubë e re  
te ajo natë që in'Zot u le.

Rroft,po rroft rregji ç'u le  
e hjynushmia e Larta Fialë  
që për njerëzit u bë dialë  
e pamet na pru harë.

Dashurin,Ti,o Zot,dëftona  
jipna ndëjesë për ftesat t'ona,  
se ti vetëm rregji je,  
rroft,po rroft rregji ç'u le.

+ + + + +



K E N K A

S H E J T R A V E T

I Shejtes Luçi

Na të falemi, o Shejtia Luçi,  
e rrethuar me dritë të hijnushme  
Ti je plot me hir të kjiellëshme  
Ti je gjoll'e gzini i zëmbresë.

Shejtia e dashur nga kjielli  
na ruaj,\* Nga armikun çë akjë  
na do lik,\* hora jonë  
u-zgjofshit e u-ndritshit\*  
të lëvdia e Shejtravët t'anë.

Ti na ndih kurdoher o Shejte,  
nga rrëzikjet çë akjë na  
rrethojën,\* na me shprës të  
madhe të thoni.\* Besën ruana  
e pakjen dhurona.

Shejtia e dashuri! . . .

+ + + + +

O ju vasha zëmbrë bardha  
 o ju djelm o ju kopile  
 lule hidhni e trundafile  
 tufa, tufa, Shejties Teres.

Gjith këndojëm tuke thënë  
 Shejties bukur plot lëvdi  
 O Teresa e but e mirë  
 Ti kto lule prit me gzim.

Lule hidni o të Krështerë  
 që te zëmbrat ju dot rrini  
 e te këmbët dot'shtini  
 tufa, tufa, Shejties Teres.

Ndër hijdhit e ndër të klarat  
 që te jeta na helmojën  
 Ti të gjithve sa durojën  
 jep pushim, o Shejtia Teres.

Ti na ndih te gjith koposet,  
 Ti je shpresa e gjellës t'ënë,  
 na ngë lodhemi tue thënë:  
 tufa lulesh Shejtes Teres.

+ + + + +

Të falemi Shën Gjon  
 shejt i math e famasor  
 Ti t'ën'Zonë parkales  
 të na ketë për jetë kujdes.

Na të falemi Shën Gjon  
 që nga ziarri na liron  
 parkales t'ën'Zonë për ne  
 se ndihma jomë Ti je.

O Shën Gjon Ti ruana  
 nga armikjët që na rrethojën  
 ata shpirtin t'ënë kërkujën  
 të e shtien ndër errësi.

O Shën Gjon Tij të truhemi  
 sa të rrojëm me të vërtetë,  
 se kushdó njeri të thurret  
 Ti e ruan te kjo jetë.

O mburonjës'i njerëzisë  
 Perëndin Ti parkales  
 të na ketë për jetë kujdes  
 ndër gëzim e ndër hjidhi.

+ + + + +

Të falemi, i shën Mitër,  
o trim i Shkqipëris,  
deshmor i Perëndis,  
luftar i shejties besë.

Te jeta e trubulluarë  
një ziarr kjëror ti kleve;  
ndër t'errëtit shkëlqjeve  
si drita në mëngjes.

Si drita e dishiruarë  
çë munt me rreze natën,  
Ti munde ashtu mëkatën  
e t'egërin armik.

Me shpatë edhë me fialë  
ng'u lodhe tue luftuar;  
më këmbë edhë kaluar  
u njhe i math kreshnik.

I but me ata të butit,  
i binde e i krështerove;  
të kekjit i pushtrove  
e i prishe me rrëmbim.

Po kë mëë të lëvduashim

se ti ka pasur dheu?  
Po kur, po kur na leu  
n'do një më i fort se Ti?

O gjak i gjakut t'ëmë,  
i trimavet i pari,  
të truhet Tij Shkjiptari  
ku ndodhet e jeton.

+ + + + +

5 Shën Janjit

I ndershëmi i shën Janj,  
vërteta i plot me hir,  
si prins i t'vetmit bir,  
të sgodhi i lartë Zot.

I math ndër të mëdhenjët,  
ndër njerëzit te dheu  
as një si Ti ngë leu,  
e s'mënt të lehet dot.

O i madhi parathënës,  
armik i ligësivët  
o mbronjës i krushkjiçvet  
të bëra ashtu si nget;

mir'e pështruan, - e u vën në  
lipë.

T Te Perëndia-u nish'e vanë;  
me lot'ndër si- muarn'e thanë.  
O Zot, O Zot, - në kishë klënë  
vdekur ng'e kishëm- vëllauthin  
t'ënë.

Fshini ato lot- pliksni ata kripi  
mos kini dre - se Lazëri flë.  
E çë na thua - o i madh'in'Zot,  
se ka katrë dit'- çë vëllau ha  
bot.

Mua kinni bes- se U jam Gjella  
U Perëndia - U i vetu'in'Zot.  
In'Zot u nis- me Apostojit ishë,  
gjindia ç'e prisiën- me dishirim.

Posa ç'arrú - nga varri u kjas  
Lazërin thirri- me një zë të math.  
O Lazër, Lazër- ngreu e rrëfiej  
çë vien në thënë- këjo mortme e  
shkretë.

Lazëri u ngre- se u ngjall pameté.  
e i tha shumë vietë- të Lartit Zot.  
E pran i tha:-o i Madh'in'Zot;  
çë farmak'i math - ç'isht ajo  
bote.

Gjith'e famasur - gjindia kjën-  
droi,  
Krishtin lëvdoi - si Perëndi.  
Këtë të vërtetë - Vangjeji e thot  
strksi në jetë- kur i jitsëj  
in'Zot.

njeriu që rron - ne shejtien  
besë,  
me gëzim vdes - e pa kopos.  
O ju që na gjegjiç,- paçit harë  
lule e pemë - për në dhe,  
(Ejani, sbillni - bierni ató ve.)

+ + + + +

Tin kjinin anástasin pro tu su  
páthus pistúmenos, ek nekròn  
íjiras ton Lázaron, Hristè o  
Theòs; óthen ke imís os i pédhes  
ta tis níkis símvolá férondes;  
Si to níkjiti tu thanátu, vooen:  
osannà en dis ipsístis.  
Evlojimenos o erhomenos en  
onomati Kjiriu.

+ + + + +  
+ + + +  
+ +

\*\* RRUSARI I SHËN MËRIS \*\*

\*\*\*\*\*

Në enbër të Jatit, të Bibit, të  
Shpirtit Shejt. Amin.

Paçe për mua lipisi, i Madh'in  
Zot! Undienj pendim, o i Larti  
Perëndi, dhëmbëm e helmonem me  
gjithë zëmbërë për gjithë  
mëkatët që kam bër te gjella e  
jime. Helmonem, se kam sbierrë  
Parraisin e në nget Pisa; po më  
shumë më dhënp zëmbra, se tue  
mëkatruar, kam ftesur Tij, i  
msdh'in'Zot, që je gjithë i miri  
e që kat të vërtetë, me ndihmën  
t'ënde, të mos t'ftes në me  
mëkatën t'ime. Vdeksha më mirë!  
Po të dafsha mirë e të shërbef-  
sha Tij o i Madh'in'Zot, i mirë  
e i ftet e klofsha me Tij për  
gjith-monë. Amin.

O Zonja Virgjërë e Shën Mëri,  
dua të thom sot rrusarin shejt,  
e të truhem fort, nos më lipset  
kurr lipisia e t'in'Zoti.



## Misteret e gëzinavet

---

(tek e hënia e tek e intia)

1- Nga Parraisi një i dërguar  
pruri fialën për të rruar  
e kur uji kriet Mëria  
te ajó zuri Perëndia.

Zonja e madhe kan haré  
përsé ti e gëzuane je.

2- Vate pran te Lisabeta  
Zonja Virgjërë, e te jeta  
ng'ish Shën Jani, po u gëzua  
e te gjiri u shejtërua.

3- Mbi tsa kashtë e te një  
shpellë,  
kur ish nata shun e thellë,  
u le Diali i krietarit  
ndërmës kaut edhe gomarit.

4- Si gjith't'ierazit fajtorë,  
Virgjëresha ndë faltore  
me të prunjur, mori e shkoi  
e t'in'Zoti ja dhuroi.

5- Kur i Larti Bir u sbuar,  
vej Shën Mëri t'ue kërkuar;  
mbi tri ditë te kjeteti  
ndër të diturit e gjeti.

\* \* \* \*

Misteret e helmëvet.

(tek e martia e tek e prëntia)

1- Brënda kopshtit parkales  
i Pavdekti e ndien se vdes;  
psherëtin t'ue diersur gjak,  
sa me atë gjith trolli u lak.

O e helnuara e Shën Mëri,  
bashk me Tij u jam ndë zi.

2- Si një kjenkjëth e rrëmbien  
e pushtijtën, e shkarzien;  
me shkupinjë e vran éeesosën  
gjith e murrën é e lavosën.

3- Mbret i falur për të kjeshur  
me një tsopë t'kukje i veshur  
i vun glëmbashë një kurorë,  
e për shkop një kallm në dorë.

4- E gjikuan si një kusar,  
si një vrasës për të vrarë,  
kush e nën e kush e rrahë,  
kush e shan me krikjen ngrahë.

5- Te ajo krikje e miera e jëmë,  
si e kjëlluarë nga një gjëmë,  
të varruar, me mishtë shkjerre,  
sheh të biriñhin të vierre.

\* \* \* \*

Misteret e lëvdivet

(tek e mërkuria, tek e shtunia,) (tek e diellia)

I- Si një trim ç'u zgjua nga gjumi,  
mbi tri dit'u ngjall i lumi.  
Vate e Prindërat liroi,  
e nga i ligu na shpëtoi.

Zonjë e lume e Shën Mëri,  
bashk me Tij u bënj haidhi.

2- Mundësor, mbi dizet ditë,  
te Parraisi Krishti u ngjip,

i përitur me lëvdë,  
me këndime e me haidhë.

3- Ndë të lutur, Shën Mëria  
rrij me Apostojit të shpia,  
Shpirti i Shejt i taksur erdhi  
e mbi atë të nirat derdhi.

4- Kur arruri dita e thënë,  
la e bekuania jetën t'ënë;  
te Parraisi in 'Zot' e ftoi,  
me gjith kurmin fluturoi.

5- Mbretëresha ajò ndë kjiell  
throni i saj shkëlqjen si diell  
isht hareja e Faremirit,  
nuse, mëmë e bijë e t'Birit.

\* \* \* \* \*

Na të faleni, o Perëndeshë, Mëmë-  
za jonë gjith-lipisi, gjella,  
ëmbëlësia, shpresa jonë. Na të  
faleni. Tij Të thëresiëm na të  
shkretit bijë t'Evës. Mbi Tij o  
Mëme, psherëtojën, tue rëkuar e  
tue klar të kjò, jetë e plotë  
me lotë. Andai Ti, e Shën Mërizë,

ndihma e jonë, prirë mbi ne sit  
t'atë me lipisi, e si sos kjò je-  
të e shkretë, Ti dëftona pemën e  
gjirit t'ënt Isuthin. Se Ti je  
e butë, e t'ëmbël, gjithë lipisi,  
o Zonja Virgjërë e Shën Mëri. A.

### PARKALESI T'IN'ZOTI

Na t'biem përmist, o i Madh'in'Zot  
e të lutemi me gjithë zëmbërë;  
Të truajëm fort Klishën shejte,  
çë Ti stise në jetë, e Papën shejt,  
çë Ti vure në vent t'ënt. Klisha  
jote katolike po klofshit mundë-  
sore mbi gjithë të ligat e mbi  
gjithë errësiatë edhe erësit.  
Mos të klofshin kurr ndajtur bi-  
jt t'atë, o i Madh'in'Zot, po klo-  
fshit pakjia jote ndër gjithë  
kombet e jetës, çë Ti shpërbleve  
me gjakun t'ënt akjë të shtrejt.  
U njomshin zëmbërat e të mëkatru-  
amëvet, e gjetshin tek Ti lipisi.

Të truajëm, o Zoti Krisht,

gjinden t'ënë arbëreshë ku do  
ndodhen edhe janë. Ti jipi  
dritën të t'njohien huret e  
bekimëvet sa të t'shërbejen, sa  
të t'den mirë.

Të truajëm gjërin t'ënë,  
mikjët, arnikjët e gjithë njeri  
çë na truhën te parkalesia.

Rrusari shejt çë jemi e thomi  
vafshit për shpirtërat çë janë  
te Purgatori.

Sa të kemi ndjesat shejte,  
parkalesiën si do Klisha shejte  
tue thënë:

Ati i jinë ..., Falem Mëri ...,  
Lëvdi past ... .

+  
+++  
+

### Litania e Shën Mëris.

Kjirie eleison

Kristë elëison

Kjirie elëison

Gjegjëna, o Zoti Krisht.

Gjegjëna, o Krisht, gjegjëna.

Ati i kjielliës in'Zot.

lipisi për ne.

Bir, shpërbles i dheut in'Zot.  
Shirti i shejt in'Zot.  
Shejtia Trini një vetëm in'Zot.

E Shën Mëri.\*\*Parkales për ne.  
Shejtia Mëna e t'in'Zoti.  
Shejtia Virgjërë e virgjëravet.  
Mëna e Krishtit.  
Mëna e të Hjinushnit Hir.  
Mëmë e Dëllirë.  
Mëmë e ndershme.  
Mëmë e pa-ngarë.  
Mëmë e pa-ftesme.  
Mëmë e dashurë.  
Mëmë famasore.  
Mëna e këshillit' mirë.  
Mëna e Stisorit.  
Mëna e Shelbuesit.  
Virgjërë e prënorene.  
Virgjërë e përfalurë.  
Virgjërë e lëvduashme.  
Virgjërë e pushtetshme.  
Virgjërë lipisiare.  
Virgjërë e besme.  
Paskira e ligjës.  
Throni i urtësis.  
Kroi i harës t'ënë.  
Puçër shpirtullor.  
Puçër i prënderni.

Puçër i ndritëm i të luturit.  
 Trundafile mistike.  
 Pirgjë e Davidhit.  
 Pirgjë e eburtë.  
 Shpia e artë.  
 Arka e Dhiatës.  
 Dera e kjielliës.  
 Illi i menatës.  
 Shëndetia e të sëmurëvet.  
 Pështrimi i të mëkatruamvet.  
 Gëzimi i të helmuaamvet.  
 Ndihma e të krështervet.  
 Perëndesha e Ëngjëjvet.  
 Perëndesha e Patriarkravet.  
 Perëndesha e Profetravet.  
 Perëndesha e Apostojvet.  
 Perëndesha e Martravet.  
 Perëndesha e Skomollerëvet.  
 Perëndesha e Virgjëravet.  
 Perëndesha e gjithë Shejtravet.  
 Perëndesha ç'u zure pa e ngarë  
 nga faj'i parë.  
 Perëndesha e Rrusarit shejt.  
 Perëndesha e pakjes.  
 Perëndesha e Ngjipurë në kjiell.  
 Shën Mëriza Odhijitrie.  
 Kjenkji i t'in'Zoti që mëkatët  
 e jetës ndzier.  
 Ndëjena, o i Madh'in'Zot.



Kjenkji i t'in'Zoti që mëkatët  
e jetës ndzier.

Gjegjëna, o i Madh'in'Zot.

Kjenkji i t'in'Zoti që mëkatët  
e jetës ndzier.

Lipisi për ne!

I Larti Perëndi, Biri i Jit i  
vetëmi jerdhi te jeta, duroi, e  
vdikj e pran u ngjall sa t'na  
shpërblej gjellën e pasosme, si  
edhë kemi kujtuar te misteret e  
rrusariit.

Ti, o i Madh'in'Zot, po dhurona  
hired shejtë të mos lëm kurr  
dhromin e Krishtit Bekuam, e të  
kemi pran të taksurën gjellë te  
Parraisi ku do t'trazhgojëm  
gjithëmonë.

O Zonja e Parraisit, na tek Ti  
vijëm e kuturisemi.

Gjithë shpresën t'ënë e kemi  
tek Ti. Ti ruana nën shpagarit  
t'ënt, o Mëmëza jonë.

\*\*\*\*\*

## Kënkë Shën Panteleimonit

Buroft'si valle rgjëndi  
nga krahërori i lumtur  
kënkë jonë e ziarrete  
si shkrep nga dashuria.  
Buroft për Deshëmorin  
çë të vet gjakun derdhi  
ni gjurmat të pa-fajshme  
çë atij shënoi Shpërbleti.

Deshmori i pa-mundur me besën  
e çelurë \* çë Zoti në zëmbërë  
i shturi së shpejt \* tuke  
lagur me gjakun ç'akoma livizet  
lurin të pa-besnit: t'ën'Zonë  
adhuró. \* Sëmundiet të rrepta si  
njek i vëlleshëm \* nga kurmet të  
dhimbshëm nzirje e largoje \* e  
si bir i denjshëm i Rregjit të  
kjielliavet \* nga zëmbërat dboje  
venerin e kekj.\*

E pra kur në nzehtë zu flaka  
hijnore\*e shpirtin të dogji  
në kurmë të çajtur\* Ti gjellën  
i kthenje fukjin e shëndetëjen,\*  
ndë shtat tuke i sgjuarë,lulzimin  
të parë. \* Isht grisur jeta më  
shumë se at'horë, \* te zëmbërat  
isht bajta, çë mendien na err.\*

O shejt akj'i bukur tek na kthen  
me besën \* na ngjall ndaj t'in'  
Zoti edhe dashurinë. \*

+ + + + +

.Kënkë Shën Ndonit.

O Shën Ndon shejt i lëvduashmë  
te gjithë jeta nga njeri  
i ka njohur gjithë famasmët  
çë Ti bën me nirisë.

Gjekj, të lutem, o shejt mir e  
afro \* e shtrëngó këtë shpirt  
bashk me Isuthin \* Ti çë  
dialthin Iesuthin një herëzë  
gjithë i luntur shtrëngove  
në gji.

O Shën Ndon shërbëtor i pa lodhur  
i t'in'Zoti çë ndë besë e pastrë  
as njeriu mbete i dijtë, e shën-  
drite \* gjith botë nrekuj pa  
numër.

Po një nrakull u vetëm të lip  
Tij, o shejt i math akjë i lëvduan

bën të kthiesh këtë shpirt  
terrëtisur,\* çë penduar Tij  
të përunjët mbë këmbët.

\*\*\*\*\*

Parkalesiëm për shpirtërat e mirë  
çë te ziarri me pakje durojën  
e çë përesiën ndër lotë me dëshir  
te Parraisi të shkojën në gëzim.

Zoti Krisht, na të thomi për ditë:  
jipi ndëjesën, Ti prëhien dhuroi;  
te ku mblen e pashuashme drita  
për gjithëmonë ata klofshin të  
lumë.

Ata shpirtra t'ën'Zonë dishirojën,  
Perëndin ata thresiën gjithëherët,  
Perëndin ata vetëm kërkujën  
te Parraisi do t'gjejën pushim.

Po sa riejën se ng'shohiën t'ën'  
Sa pshertime nga zëmbat <sup>Zonë!</sup> i dajën  
Nat'e ditë pa u lodhur po thonë:  
Shuana, o Zot, këtë të math dishi-  
rim.

Gjëri e mikjë çë te jeta po rroni  
thonë ata ndër mundimet e ziarrit.  
Motra e vëllezër mos ju të harroni  
Se na presiëm ngak ju ngushullim.

Ngushullim e dhrosi ngak na  
 nga të krështerët, nga Klisha e  
 ngushullim e dhrosi ata përesiën  
 njer të ken të pasosmin trazhgim.

\*\*\*\*\*

### ZOTIT KRISHT NË SAKRAMENT

Krishti jim, i Madh' in' Zot, që për  
 ne rri nat' e ditë i fshehur në  
 Sakrament, gjith' lipisi e dashuri,  
 tue pritur e tue thëritur gjithë  
 sa vijën të t' gjejën, u kam besë  
 se Ti je me shpirt, me kurm e me  
 hjuni te ki Sakrament, u të pros-  
 kjinis e të haristis për gjithë  
 hiret që më ke bur, e më shumë se  
 na u ke dhënë te ki Sakrament, se  
 më ke dhënë për pajtores Mëmën t'  
 ënde e Shën Mëri e se më ke thri-  
 tur te kjo klishë. U i falem sot  
 e i lutem Zëmbres t' ënde plot-  
 dashuri e haristis për këtë dhuretë  
 të madhe; u dua të t' jap ndo shpë-  
 rblim për gjithë ftesat e të sha-  
 rat e armikjëvet t' atë në Sakra-

ment e dua të t'jap proskjinin  
 çë Të nget te gjithë jeta ku  
 rri i fshehur në Sakrament i ha-  
 rruar e i pa-lutur nga njerëzit.  
 Jesui jim, u Të dua mirë me gji-  
 thë zëmbren t'ime. U ndienj pen-  
 dim të math se disa herë kam  
 ftesur mirësim t'ënde të pasos-  
 me. U bënj be se me fukjin t'ënde  
 ngë Të ftes më për sa rronj; e se  
 nani, ashtu i mier e i shkret si  
 jam, u të vuhem te duart t'ote,  
 të jap e të dhuronj gjithë vul-  
 limin t'im, gjithë ndienjat, di-  
 shirimet e shërbiset t'ime.

Çë sot e para Ti bën çëdo mbi  
 mua e mbi shërbiset t'ime. Vetëm  
 Të lip e dua dashurin t'ënde e  
 shejte, të kemë durim njera te  
 hera e sprasme e të bënjë kur-  
 doherë vullimin t'ënt shejt.

Të truanj gjithë shpirtrat çë  
 janë te Purgatori e më shumë ata  
 çë te jeta e të gjella e'tire  
 klenë më të divotshim për tri-  
 shejtin Sakrament e për gjithë  
 shejten Shën Mëri, Të truanj edhe  
 të mjerët të mëkatruamë. U vu,  
 o i Shelbuesi jim, gjithë ndëje-

njat e dashurit t'ime bashkë me  
 ndienjat e dashurit të Zëmbres  
 t'ende të përmallshme e shtu të  
 bashkuara ja fal Atit t'ent të  
 Pasosmë e e parkales në embër  
 t'ent sa, për dashurin t'ende T'i  
 presënjë mirë e t'i marrënjë  
 vesh. Amin.

### LUTIE ZOTIT KRISHT SI

#### DAJËM NGA KLISHA

Isht e kjaset nata, o i Madh'ip'  
 Zot, e të më t'errtit zë fill të  
 shtronet mbi dhe; arru hera, o Isuth  
 të ndahem ngah Ti e të të lë, o  
 i dashuri jim.

O Isuth çë bekove ditën e sotme,  
 o Isuth çë burove e më kjose me  
 hiret t'atë shpirtin t'im! Si  
 Apostojit mbi malin e Taborit u  
 deja të ngrëja këtu tendëzën  
 t'ime.

Çë shërbes i t'embël isht të  
 prënjë sizit t'imë e zëmbren t'  
 ime mbi Tabernakuklin t'ent.  
 Isht mirë shumë të parkales e  
 të kla si edhe të gëzonem këtu  
 te këmbët t'ote. Si tufat e En-  
 gjëjëvet pa u lodhur Të proshkji-  
 nisen e Të lëvdojnë, edhe shpirti

jim përsbashku me dashuri të pashuashme të lëvdon e të haristis. E j u Të dua mirë, o Perëndi, të dua fort mirë! E tue u ndajtur ngah Ti, te duart t'ote Të lë zëmbren t'ime.

Po përçë ngë jam u e vogla llëmpë çë dhizet nd'anëzë Tij gjith'natën? Përçë ngë, i glas lu levet çë mblojën me bukurë erë shpizën t'ënde, e veshken e josen dalë e dalë përpara Tij? Ëngjëj çë rrini këtu përpara, thoniji Isuthit se dishiroja sa zëmbra jime mos të tsitej kur të rrij gjith'natën sgjuarë për Atë.

Të falem o Zoti jim i dashuri, jam e vete po më përpara em bekimin t'ent, ruajem nga gjith'armikjt e shpirtit të padukurë.

Te duart t'ote, o i Mirë, u truanjë shpirtin t'im. Ruaje nani e për gjithëmonë: Amin.

\*\*\*\*\*



## INDICE = DÉFTONJËS

|                         |    |     |
|-------------------------|----|-----|
| Parkalesia e menatës    | F. | 2   |
| Mëngjesori              | "  | 6   |
| Apolitikjet e të diel-  | "  | 7   |
| liavet                  | "  | 7   |
| Polieleos (ms.135)      | "  | 9   |
| Evlojitaria anastasima  | "  | 11  |
| Doxolojia               | "  | 19  |
| - M E S H A             | "  | 22  |
| Tipikë                  | "  | 48  |
| Parkalesi për të        | "  |     |
| vdekurit                | "  | 63  |
| Trisajon                | "  | 74  |
| Mrëmësoria-Vespro       | "  | 80  |
| Parkalesi që do të tho- | "  |     |
| mi më para se sa të     | "  |     |
| vemi e flëm.            | "  | 94  |
| Antifonet të festavet   | "  | 99  |
| Kreshëmët               | "  | 124 |
| Epara e diellië e       | "  |     |
| Kreshëmëvet             | "  | 124 |
| E treta e diellië e     | "  |     |
| Kreshëmëvet             | "  | 125 |
| E diellia e Pallmievët" | "  | 127 |
| - J A V A E M A D H E   |    | 129 |

|                             |       |
|-----------------------------|-------|
| PASHKËT                     | f.140 |
| E diellia e Pent.           | " 150 |
| Kënka e S.Shejt             | " 152 |
| Të Hipurit e t'in'          |       |
| Zoti në kjiell.             | " 148 |
| Te dita e Sakramentit       | 153   |
| - PARAKLISIS                | " 154 |
| Parkalesi S.Gjergjit        | " 182 |
| Novena e S.Gjergjit         | " 192 |
| UDHA E KRIKJES              | " 200 |
| Kënka pas Udhës e K."       | 189   |
| KËNKA T'IN'ZOTI             | " 205 |
| KËNKA S.MËRIS               | " 228 |
| KËNKAT E KRISHT-<br>LINDIES | " 253 |
| KËNKA SHEJTRAVET            | " 272 |
| -Shejtes Luçi               | " 272 |
| -Shejtes Teres              | " 273 |

|  |    |     |
|--|----|-----|
| -Shën Gjonit                                   | f. | 274 |
| -Shën Janit                                    | "  | 276 |
| -Shën Mitrit                                   | "  | 275 |
| - KËNKA E LAZËRIT                              | "  | 277 |
| Rrusari i S.Mëris                              | "  | 280 |
| Parkalesi Zotit Krisht<br>në Sakrament         | "  | 293 |
| Parkalesi Zotit Krisht<br>si dajëm nga klisha" |    | 295 |

8888888888888888

\*\*\*\*\*

=====